

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE
NUMËR 375 • VITI 35 • SHKURT 2022 • XHUMADEL UHRA - REXHEB 1443 • ÇMIMI 1 €



Deklaratë e përbashkët e prijësve fetarë kundër nismës së institucioneve të vendit për ndryshimin e projektligjit për Kodin Civil

Urimi i Myftiut Tërnavë me rastin e përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës

Sot, më 17 shkurt, e gjithë Kosova, me respekt e pietet shënon katërbëdhjetë vjetorin e Pavarësisë së saj. Dita e Pavarësisë është ditë që na bënë krenarë, na bënë me dinjitet, e na bënë të barabartë në mesin e të barabartëve.

17 Shkurti na rikthen në kujtesën e në vëmendjen tonë sakrificën e brezave për ta realizuar mëvetësinë e vendit dhe popullit tonë.

Të nderuar qytetarë të Kosovës


Dita e Pavarësisë – 17 Shkurti është ngjarja më e rëndësishme për ne dhe si e tillë na bënë krenarë për të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen tonë.

Në këtë ditë feste, më lejoni që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal, t'ju drejtohem me mesazh urimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, me përgëzimet më të mira, duke lutur Zotin e Madhëruar që të na japë mbarësi në shtetin tonë të lirë e sovran.

*Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnavë*

Në këtë numër:

Editorial	4
Sabri Bajgora Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (9)	5
Dr. Ajni Sinani Premtimi hyjnor për rikthimin e Pejgamberit a.s. prej Medinës në Mekë	9
Philip Dorroll Universi në fluks – rishikimi i metafizikës dhe epistemologjisë të Mansur el-Maturidiu (2)	11
Dr. Berat Hashani Përpyqjet e para për përkthimin e domethënieve të Kuranit në gjuhën shqipe	15
Hafiza Rejhana Umer Cilat kaptina nga Kurani duhen lexuar gjatë kohës së depresionit dhe stresit?	18
Alexander Bevilacqua Kur Kurani fliste anglisht	20
Mr. Driton Arifi Kompetencat dhe detyrimet e kujdestarëve të vakëfeve	23
MSc. Abdullah Klinaku Të drejtat martesore dhe sistemet juridike të shqiptarët	26
LL.M. Argjent Xheladini Radhët e trashëgimisë sipas Ligjit për Trashëgiminë e Kosovës	29
Arben Desku “Sodomgjinitë modernë” – devijimi nga natyrshmëria njerëzore	31
Prof.Ass.Dr. Rexhep Suma Ligjërata si formë e diskursit në dave	32
Bajram Zeqiri Lutje të veçanta të Pejgamberit a.s.	35
M.sc Artan S. Mehmeti Kontributi i El-Ferganit (Alfraganus) (798 – 865) në zhvillimin e shkencës	39
Harun Shabanaj Pagëzim a vdekje (2)	42
Një Shkurti - Dita Botërore e Mbulesës	44
Sahiba Goga-Daciq Mbulesa ime, paqja ime	46
PhD (C) Melihate Zeqiri Bilinguizmi gjuhësor në Ballkan (1)	48
Deklarata përmbyllëse e Forumit të Tetë Ndërkombëtar për Promovimin e Paqes	51
Dr.Sci Agron M. Rexhepi Nevojat energjetike të organizmit (2)	55
Aktivitetet	57

**DITURIA ISLAME**

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.

Kryeredaktor:

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:

Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,
dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,
dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,
mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.

Sekretar në redaksi:

Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë

Sprova si pastrim e lartësim



“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është ngadhënjyesi, mëkatfalësi.”

(El-Mulk, 1-2)

Sprova është një nga ligjet e kësaj jete. Kjo botë e përkohshme është me halle dhe vështirësi dhe nuk është vendi i lumturisë së vazhdueshme. Zoti e krijoi jetën dhe vdekjen për t’i sprovuar njerëzit: “Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është ngadhënjyesi, mëkatfalësi.” (El-Mulk, 1-2)

Sprovat mund të jenë udhëzim, pastrim dhe lartësim. Ato e dallojnë besimtarin e singertë nga jo i singerti. “Ka nga njerëzit që e adhurojnë Allahun me mëdyshje (luhatshëm), nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet me të, por nëse e godet ndonjë e pakëndshme ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai ka humbur këtë dhe jetën tjetër e ky është ai dështimi i qartë.” (El-Haxh, 11).

Allahu xh.sh. na tregon se besimtarët do të sprovohen me të gjitha llojet e sprovave: “Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta, e edhe nga frutat, po t’i jepu përgëzim durimtarëve.” (El-Bekare, 5).

Sprovat nëse përballohen me sabër e falënderim janë në të mirë të besimtarit. Pejgamberi a.s. thotë: “Habitem me çështjen e besimtarit. Të gjitha çështjet e tij janë në të mirën e tij, dhe kjo është vetëm për besimtarin. Nëse e godet një e mirë, ai falënderon Allahun dhe kjo është në të mirën e tij. Nëse e godet ndonjë e keqe, bën durim dhe kjo është në të mirën e tij.” (Muslimi).

Sprova mund të jetë si dënim i mosbesimtarëve dhe për atë që veprojnë prej veprave të liga: “Atë dënim ua dhamë atyre, për shkak se nuk besuan, e Ne nuk dënojmë përveç mohuesit.” (Sebe, 17). Një pjesë e njerëzve në vështirësi dhe fatkeqësi vetëdijesohen dhe largohen nga e keqja: “Ne i provuam me të mira e me të këqija, në mënyrë që të tërhiqen nga e keqja.” (El-Araf, 168).

Njeriu sprovohet me vështirësi që të bëhet e qartë se sa ai është në gjendje të durojë gjatë asaj vështirësie. Ai sprovohet edhe me bollëk e të mira, që të bëhet e qartë se sa është mirënjohës dhe falënderues ndaj Allahut për të mirat që ia dhuroi: “Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen, e Ne në shenjë sprove ju sprovujmë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne.” (El-Enbija’35). Një prej sprovave që e bën një person të lartësohet shpirtërisht është edhe sëmundja. Se si të sillemi gjatë sëmundjeve na tregon ajeti: “Dhe kur të sëmurem Ai më shëron!” (Esh- Shuara, 80).

Sprovat që Zoti ua dërgon robërve të Tij, shpeshherë janë tregues i dashurisë që Ai ka për ta. Pejgamberi a.s. thotë: “Atij që Allahu ia dëshiron të mirën e sprovon.” (Buhari). Kjo, sepse Zoti dëshiron të na pastrojë që në këtë botë nga gjynahet dhe të na mbajë larg zjarrit dhe dënimit të Ahiretit. Pejgamberi a.s. thotë: “Kur Allahu i dëshiron një robi të Vet një të mirë, Ai ia shpejton dënimin në këtë botë. Ndërkaq, kur i Allahu dëshiron një robi të Vet një të keqe, Ai ia lë mëkatet e pafalura në këtë botë, ashtu që të vijë me mëkate në Ditën e Gjykimit dhe aty e gjen e keqja.” (Tirmidhi). Besimtari s’duhet t’i llogarisë sëmundjet si ndëshkim, por pastrim e lartësim nga Allahu dhe t’i kalojë ato me sabër e falënderim. Të diturit thonë se ai i cili nuk sprovohet në këtë botë ka shumë të ngjarë të jetë një njeri i prishur, sepse Allahu ia largon telashet dhe dënimin nga kjo botë, në mënyrë që ai të ringjallet me të gjitha mëkatet e tij në Ditën e Ringjalljes.

Vështirësitë dhe mundimet i pastrojnë besimtarët ashtu siç pastrohet ari me zjarr nga gjërat e pavlera. Pejgamberi a.s. thotë: “Çfarëdo që e godet myslimanin, qoftë lodhje, pikëllim, brengë, hidhërim, mundim nga ndonjë sëmundje a fatkeqësi, madje edhe të shpuarit e therës, me secilën prej këtyre Allahu ia shlyen atij mëkatet.” (Buhari dhe Muslimi).

Sprovat janë gjithashtu lartësim dhe ngritje në xhenet. Ato janë të tilla vetëm për besimtarin. Pejgamberët ishin pa mëkate, ishin më të dashurit dhe më të zgjedhurit e Allahut, por ata ishin edhe njerëzit që më së shumti u sprovuan në këtë botë. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Njerëzit me të sprovuar janë pejgamberët, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas tyre. Njeriu sprovohet sipas shkallës së besimit, nëse është i fortë në besimin e tij edhe sprovën e ka më të madhe, e nëse është i dobët në besimin e tij, do të sprovohet sa shkalla e besimit të tij. Njeriu sprovohet derisa të ecë mbi tokë pa asnjë mëkat.” (Imam Ahmed).

Ne mund të mos e kuptojmë urtësinë e sprovave dhe të ngjarjeve kur ato na ndodhin! Por besimtari e di se gjithçka që ndodh, e mirë apo e keqe, ndodh sipas caktimit të Zotit. Nënshtrimi ndaj caktimit të Allahut e largon njeriun nga hidhërimi, nga mos përmbajtja dhe mendimi i keq për Zotin e tij. Urtësia e asaj që ne mund ta kemi konsideruar fatkeqësi dhe sprovë, na shfaqet më vonë. Prandaj nuk duhet të humbim shpresën gjatë sprovave, por të durojmë gjatë vështirësive: “E sa pejgamberë pati, që së bashku me ta luftuan turma të mëdha besimtarësh, dhe për atë që i goditi në rrugën e Allahut, ata nuk u dobësuan nga ana morale, e as ajo fizike dhe as nuk u përulën. Allahu i do durimtarët.” (Ali Imran, 146)

Reagimi ndaj sprovave me hidhërim haset tek ata njerëz që janë të dobët në fe. Ndërkaq, besimtarët i pranojnë ato me durim. Një pjesë e tyre i pranojnë me kënaqësi. Kjo është më lartë se ajo me durim. Kurse pozita më e lartë është shprehja e falënderimit ndaj Zotit për sprovat, duke konsideruar se përmes tyre na ofrohen mirësi të ndryshme.

Dr. Ajni Sinani

Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (9)

Argumentet e Ringjalljes dhe urdhri për durim

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّ اللَّهَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَمْ
يَعْبُدْهُ يَخْلُقْ بِقَادِرٍ عَلَىٰ أَنْ يُخَيِّبَ الْمُؤْتِنِينَ ۗ إِنَّهُ عَلَىٰ
كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٣٣﴾ وَيَوْمَ يُعْرَضُ الَّذِينَ كَفَرُوا عَلَىٰ
النَّارِ أَلَيْسَ هَذَا بِالْحَقِّ ۗ قَالُوا بَلَىٰ وَرَبِّنَا ۗ قَالَ فَذُقُوا
الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ تَكْفُرُونَ ﴿٣٤﴾ فَاصْبِرْ كَمَا صَبَرَ أُولُو
الْعِزْمِ مِنَ الرُّسُلِ وَلَا تَسْتَعْجِلْ لَهُمْ ۗ كَأَنَّهُمْ يَوْمَ يَرَوْنَ مَا
يُوعَدُونَ لَمْ يَلْبَثُوا إِلَّا سَاعَةً مِّنْ نَّهَارٍ ۗ بَلَاغٌ ۗ فَهَلْ يُهْلَكُ
إِلَّا الْقَوْمُ الْفَاسِقُونَ ﴿٣٥﴾

“A nuk e shohin ata se Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën e nuk u lodh në krijimin e tyre, është i Plotfuqishëm që t’i ngjallë të vdekurit? Po, Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Ditën, kur ata që mohuan do të përballen me zjarrin (do t’u thuhet): “A nuk është ky (zjarr-dënim) i vërtetë?” Ata do të thonë: “Po, për Zotin tonë!” Ai do t’u thotë: “Atëherë, shijoni (vuani) dënimin për shkak të mohimit që keni bërë!” Prandaj, ti bëhu i durueshëm (o Muhamed), ashtu siç duruan të dërguarit e vendosur, dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ta! Ditën, kur të shohin atë që u është premtuar, atyre do t’u duket sikur kanë jetuar (në Tokë) vetëm një çast të ditës. Ky është kumtim i qartë. E kush tjetër do të shkatërrohet, përveç popullit të pabindur!?” – (El-Ahkaf, 33-35).

Lidhja e këtyre ajeteve më ato paraprake

Ajetet e fundit të kësaj sureje, sikur plotësojnë atë mozaikun e të gjitha tematikave të shtjelluara deri më tash. Përderisa përgjatë sures, pamë argumente të qarta për ekzistimin e Zotit të Plotfuqishëm e të Urtë, vërtetimin e profetësisë, demantimin e dyshimeve të idhujtarëve dhe qortimin e tyre për mosbesim, si dhe besimin e xhindeve, të cilët me të dëgjuar vetëm disa ajete kuranore, e përqafuan këtë besim të pastër në Zotin Një, ndërkohë që tash, në këto ajete, vjen plotësimi i këtij mozaiku imanor - vërtetimi i ringjalljes dhe përshkrimi i gjendjes së mjerë të atyre që mohuan Ditën e Gjykimit teksa ndëshkohen në zjarrin e Xhehenemit. Dhe, krejt në fund të këtyre ajeteve, me të cilët edhe përfundon kjo sure, vjen një këshillë madhështore për Pejgam-

berin a.s., që të duronte ndaj të këqijave dhe ligësive të kurejshëve, ashtu siç kishin vepruar edhe elita e të dërguarve para tij, me popujt e tyre mëkatarë.

Koment:

33. *A nuk e shohin ata se Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën e nuk u lodh në krijimin e tyre, është i Plotfuqishëm që t’i ngjallë të vdekurit? Po, Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.*

Ajetet përmbyllëse të kësaj sureje, vijnë duke qartësuar tematikat e shtjelluara më parë, ndërkohë që tash ka mbetur vetëm edhe akti i fundit i shtegtimit tonë jetësor, besimi në Ringjalljen dhe në Ditën e Gjykimit. Besimi në Ringjallje, është një prej gjashtë kushteve fundamentale të besimit islam, prandaj mohuesi i ringjalljes, hyn në grupin e atyre që e vulosën fatin e tyre si jobesimtarë dhe do të ballafaqohen me hidhërimin dhe ndëshkimin e Allahut në botën tjetër.

Ringjallja është një proces që do të ndodh me urdhrin e Allahut, pas shkatërrimit të kësaj ekzistence, ashtu siç na ka njoftuar i Lartmadhërishti në Kuranin fisnik: “Atë ditë Ne e palosin qiellin siç palosen fletët e një libri. Ashtu siç e filluam krijimin, ashtu e rikthejmë atë. Ky është premtimi Ynë dhe Ne do ta përmbushim atë!” - (El-Enbijaë, 104)

Ky ajet sqaron se në ditën e fundit të kësaj bote, vjen akti i shkatërrimit të ekzistencës, dhe kjo gjithësi do të paloset siç palosen fletët e një libri. Çdo gjë kthehet në pikën zero të para krijimit. Allahu xh.sh. na e bën me dije se pas kësaj, ky “Libër”, do të hapet e shpaloset sërish, por tash me dimensione të reja të krijimit, sepse do të jemi në Botën e amshueshme, në të cilën nuk do t’i ekspozohemi më vdekjes apo shkatërrimit.

Idhujtarët kurejshë dhe ata përreth tyre në Gadishullin arabik, ishin të bindur se nuk ka ringjallje pas vdekjes. Ata nuk mund të perceptonin dot se njeriu pasi të vdes e të jetë bërë

I Madhërishmi duke demantuar thëniet e çifutëve se Allahu pasi krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë, u lodh dhe pushoi në ditën e shtatë, tregon se Ai nuk ndjeu aspak lodhje gjatë krijimit.

hi e pluhur, mund të ringjallet sërish në formën e mëparshme. Pikërisht, për këtë arsye, Allahu xh.sh. i fton dhe njëherë këta njerëz të pabindur që të vrojtonin me kujdes krijimin e qiejve dhe të Tokës, e të meditonin për Krijuesin e tyre. Ky ajet, na rikthen edhe njëherë në fillimet e kësaj sureje, ku i Madhërishmi në ajetin e 3 të saj thotë: “Ne nuk i krijuam qiejt e Tokën dhe atë që gjendet ndërmjet tyre, përpos me qëllim dhe me një afat të caktuar...”,

ajet që shumë qartë e sqaron qëllimin e krijimit të qiejve dhe të Tokës dhe shkatërrimin e tyre në një kohë dhe afat të caktuar të cilin e di vetëm Krijuesi fuqiplotë dhe i Gjithë-dijshëm.¹ Pra, Ai që pati fuqi të krijojë tërë këtë ekzistence madhështore, pa u lodhur fare, vallë si nuk paska fuqi të ringjallë të vdekurit nga varret e tyre?! A nuk e shohin ata se Allahu që i krijoi qiejt dhe Tokën, me urdhrin e Tij: “Bëhu!”, urdhër i cili zbatohet aty për aty me nënshtim të plotë, është në gjendje t’i marrë njerëzit në llogari pas vdekjes dhe ringjalljes së tyre?!

Ky ajet, tregon se ringjallja apo rikrijimi është çështje urdhri e jo lodhjeje, por për t’ua përafuar mendjeve njerëzore të cilët vërtet i kap lodhja pas një pune të mundimshme, e ka sjellë këtë pjesë të ajetit: “e nuk u lodh në krijimin e tyre.”

Edhe në suren Kaf, ajeti 38: “Pa dyshim, Ne i krijuam qiejt e Tokën dhe gjithçka ka mes tyre në gjashtë ditë dhe nuk u lodhëm aspak!”, i Madhërishmi duke demantuar thëniet e çifutëve se Allahu pasi krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë, u lodh dhe pushoi në ditën e shtatë, tregon se Ai nuk ndjeu aspak lodhje gjatë krijimit. Pra, logjikisht, nëse Ai

nuk ndjeu lodhje gjatë krijimit të qiejve dhe të Tokës, a thua si mund të ndjejë lodhje gjatë procesit të ringjalljes së njeriut?! Sipas parametrave të perceptimit njerëzor, krijimi i qiejve dhe i Tokës, është shumë më madhështor e më i komplikuar se sa rikrijimi i njerëzve apo ringjallja e tyre nga varrezat, ashtu si ishin para vdekjes së tyre, siç ka ardhur edhe në ajetin 57 të sures Gafir: “S’ka dyshim se krijimi i qiejve dhe Tokës është më i madh se krijimi i njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e dinë”²

Për ta përforcuar konstatimin, se Ringjallja është një proces që tregon se Allahu është vërtet i gjithëfuqishëm për çdo gjë, në fund të këtij ajeti, Ai thotë: “Po, Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë”. Sipas Imam Nesefiut, fjala ‘belâ’, vërteton pa kurrfarë dyshimi se Allahu është i Plotfuqishëm dhe ka mundësi e fuqi për çdo gjë, e përveç tjerash edhe për t’i ringjallur të vdekurit.³

34. Ditën, kur ata që mohuan do të përballen me zjarrin (do t’u thuhet): “A nuk është ky (zjarr-dënim) i vërtetë?” Ata do të thonë: “Po, për Zotin tonë!” Ai do t’u thotë: “Atëherë, shijoni (vuani) dënimin për shkak të mohimit që keni bërë!”



Mirësia e cila të largon nga Ai që është burim i kësaj mirësie-Allahu xh.sh., në fakt nuk është mirësi, por sprovë, fitne dhe mallkim, kurse mirësia e vërtetë është ajo që ta rikujton Allahun xh.sh. si burim të kësaj mirësie.

(Sharavi)

Ky ajet, na dërgon në aktin e fundit të rrugëtimit njerëzor, mu në aktin e Ringjalljes dhe të Ditës së Gjykimit, ku ata që mohuan takimin e kësaj dite do të ballafaqohen me këtë dënim të tmerrshëm. Pas përfundimit të gjykimit, jobsimtarët do të tërhiqen zvarrë drejt greminave me zjarr të Xhehenemit, dhe do të ndalohen para tij e do të pyeten në formë nënçmimi e përbuzjeje: “A nuk është ky (zjarr-dënim) i vërtetë?” Kur ata e shohin fundit e tyre të mjerë, nuk u mbetet rrugë tjetër pos pranimit të fajësisë duke thënë: “Po, për Zotin tonë!”, ky është zjarri i cili na “premtohet!” E pas këtij turpërimi, atyre do t’u thuhet: shijoni pra dënimin e këtij zjarri, dhe dënimin e kësaj Dite të Gjykimit, të cilën e mohuat në jetën e dynjasë!

Ajeti i parafundit i sures, ka një ngjashmëri të dukshme me ajetin e 20 të po kësaj sureje: “Ditën, kur ata që mohuan do të përballen me zjarrin (do t’u thuhet): “Ju i shfrytëzuat gjithë të mirat në jetën e dynjasë dhe u kënaqët me to. Por sot, do të ndëshkoheni me dënim poshtëruës për shkak se ishit arrogant në tokë pa kurrfarë të drejte, dhe për shkak se mëkatuat (nuk iu bindët Zotit).”, ku shohim se në atë ditë të tmerrshme të llogarisë, në formë nënçmimi xhehe-

nemlinjve do t’u thuhet: Ju i shfrytëzuat krejt të mirat dhe kënaqësitë në jetën e dynjasë, dhe nuk latë asnjë vepër të mirë për Ahiret, prandaj, do të ndëshkoheni me dënim poshtëruës, për shkak të arrogancës dhe kufrit tuaj. Dijetari i madh bashkëkohor, Sharaviu, kur flet për mirësitë thotë se ajo mirësi e cila të largon nga Ai që është burim i kësaj mirësie-Allahu xh.sh., në fakt nuk është mirësi, por sprovë, fitne dhe mallkim, kurse mirësia e vërtetë është ajo që ta rikujton Allahun xh.sh. si burim të kësaj mirësie,⁴ dhe pikërisht për këtë arsye, i Dërguari a.s. na ka mësuar që kur ta shohim ndonjë mirësi te vetja apo te të tjerët të themi: “Ma sha Allah la kuvete il-la bil-lah”.⁵

35. Prandaj, ti bëhu i durueshëm (o Muhamed), ashtu siç duruan të dërguarit e vendosur, dhe mos kërko shpejtimin e dënimin për ta! Ditën, kur të shohin atë që u është premtuar, atyre do t’u duket sikur kanë jetuar (në Tokë) vetëm një çast të ditës. Ky është kumtim i qartë. E kush tjetër do të shkatërrohet, përveç popullit të pabindur!?”

Pas vërtetimit të Njëshmërisë, pejgamberisë dhe ringjalljes, me argumente të pakontestueshme, duke zhदारitur çdo dyshim të idhujtarëve, tash i Madhërishti, e këshillon të Dërguarin a.s. që të bënte durim ashtu siç duruan pejgamberët e mëparshëm që Allahu i veçoi me emrin “Ulul Azmi” – “Pejgamberët e vendosmërisë së lartë”, apo thënë më shkurt “Elita profetike”. Në këtë grup elitare, ndonëse ashtu siç na ka urdhëruar Allahu xh.sh. nuk bëjmë dallim në mes pejgamberëve: “Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij” – (El-Bekare, 285), megjithatë do të veçonim pesë nga ata që merituan bartjen e këtij epiteti: Nuhu a.s., Ibrahim a.s., Musai a.s., Isai a.s., dhe më madhështori prej tyre Muhamedi a.s., me të cilin u përmbyll pejgamberia, dhe i cili u dërgua mëshirë për krejt botët. Këta të pestë, janë përmendur me emra edhe në ajetin 7

të sures El-Ahzab: “Dhe (kujto) kur Ne e morëm prej pejgamberëve një premtim, siç morëm prej teje, prej Nuhut, Ibrahimit, Musait, Isait, birit të Merjemes. Ne morëm prej tyre besë të fortë.”

Mendimet e dijetarëve lidhur me atë se kush hyn në këtë grup të Ulul Azmit, janë të ndryshme. Disa kanë thënë se ky emërtim i përfshin vetëm këta të pestët të përmendur në ajet, kurse të tjerët i fusin të gjithë pejgamberët, nën këtë emërtim, me përjashtim të Junusit a.s. për të cilin Allahu xh.sh. duke e këshilluar Muhamedin a.s. në lidhje me të thotë: “Po ti, bëhu i durueshëm ndaj caktimit të Zotit tënd, dhe mos u bëj si ai peshkut (Junusi)” – (El-Kalem, 48); dhe të Ademit a.s.: në lidhje me të cilin ka zbritur: “Ne e patëm urdhëruar Ademin (të mos i afrohej pemës), po ai harroi. Ne nuk gjetëm vendosmëri tek ai.” (Ta Ha, 115)⁶

Pas porosisë dhe këshillës për durim nga ligësitë e popullit të vet, Muhamedi a.s. këshillohet që të mos kërkojë përshpejtimin e dënimin dhe shkatërrimin e tyre në këtë botë duke i mallkuar,⁷ sepse dënimi për ata që nuk besojnë, gjithsesi është i pashmangshëm në Ahiret. Ky është i vetmi ajet në Kuran, ku Allahu i Plotfuqishëm i kërkon të Dërguarit të Vet që të mos kërkonte shpejtimin e ndëshkimit për popullin e tij dhe, nga kjo kuptojmë se maltretimet e kurejshëve ndaj të Dërguarit a.s. dhe vuajtjet shpirtërore e fizike që po i përjetonte së bashku me besimtarët, tashmë kishin arritur kulmin. Megjithatë, edhe përkundër të gjitha këtyre zullumeve ndaj tij, ai e donte shumë popullin e tij dhe i digjej zemra për ta. Ai po vuante shpirtërisht pse ata ende nuk po e pranonin dritën e udhëzimit. Madje, shpesh i lutej Allahu xh.sh. me këto fjalë: “O Allah, fale popullin tim, sepse ata nuk dinë”. I Madhërishti duke e ditur se çfarë zemre të pastër kishte Muhamedi a.s., e këshillon atë që të mos ngutej me ndonjë mallkim e as përshpejtim të ndëshkimit, sepse

Krijuesi i kësaj gjithësie e kishte dërguar atë si “mëshirë për botët”.

E sa i përket çështjes së atyre që nuk deshën të përdheshin në këtë botë, tash Allahu xh.sh. na shpërfaq imazhe të Ditës së Gjykimit, kur jobesimtarët do ta shohin atë që u është premtuar nga ndëshkimi me zjarr. Vetëm atëherë, ata sikur zgjohen nga letargjia e tyre dhe do t’u duket se kanë jetuar në këtë dynja vetëm se një çast të shkurtër të një dite të saj. Ja, ky pra është Kurani, si kumtim i qartë,⁸ nëpërmjet të cilit Allahu xh. sh. ua tërhoqi vërejtjen njerëzve të pabindur dhe mohues, njerëzve të cilët nga mendjemadhësia e tyre menduan se nuk do të vdisnin e as nuk do të ketë ringjallje dhe llogari. Prandaj, i Plotfuqishmi, e përfundon këtë sure me një pyetje, e cila në fakt synon t’i zgjojë nga kllapia e kufrit të gjitha ato mendje të fjetura, për të parë të vërtetën: “E kush tjetër do të shkatërrohet, përveç popullit të pabindur!?”

Porosia e këtyre ajeteve – (33-35)

- Allahu i Madhërishëm, është Ai që krijoi ekzistencën, pa ndjerë aspak lodhjeje, sepse nocioni lodhje nuk përkon me madhësinë krijuese të Tij, e as që mund t’i përshkruhet Atij një veprim i tillë, sepse urdhri i Tij është vetëm t’i thotë një sendi “Kun-Bëhu!”, dhe ai bëhet me nënshtrim. Arsyeja pse Allahu e ka cekur këtë fjalë: “E nuk u lodh në krijimin e tyre” fillimisht është demantim i shpifjeve të çifutëve, të cilët pretendojnë marrëzisht se Allahu pasi krijoi qiejt dhe Tokën, u lodh, dhe ditën e shtunë, pushoi!!! Ndërsa në këtë rast, Allahu xh.sh. ua bën me dije edhe idhujtarëve se kur Ai krijoi qiejt dhe Tokën, pa u lodhur, atëherë, pse nuk logjikoni sipas parametrave të perceptimit tuaj njerëzor se krijimi dhe ringjallja e njerëzve është një proces shumë më “i lehtë” se sa krijimi i qiejt dhe i Tokës?!



- Allahu është i Plotfuqishëm, dhe krijon çfarë të dojë, kur të dojë dhe si të dojë, pa pasur mundësi që dikush të ndërhyjë në kompetencat dhe vullnetin e Tij hyjnor.

- Atë çka Allahu ua ka premtuar jobesimtarëve nga ndëshkimi në Ahiret, do të ndodh patjetër. Jobesimtarët do ta shohin dhe përjetojnë për së afërmi përcëllimën e zjarrit të Xhehenemit, e pastaj do të hidhen në të, për të marrë ndëshkimin e merituar.

- Sabri - durimi, është një prej cilësive më të dashura tek Allahu xh.sh.. Madje edhe një prej emrave të bukur të Tij është “Sabur”- “Durimtar”, që nënkupton se Ai nuk shpejton me dënim, por shikon, pret dhe vonon, e megjithatë ndëshkimit të Tij nuk mund t’i shmangët askush që e ka mohuar rrugën dhe udhëzimin e Tij. Fjala “sabër” – “durim” është përmendur mbi shtatëdhjetë herë në Kuran. Për këtë arsye, i Lartmadhërishmi e porositi të Dërguarin e Vet, që të ishte i durueshëm ndaj shpifjeve, fyerjeve dhe ligësive të kurejshëve, duke qëndruar stoik dhe i pathyeshëm, ashtu siç duruan në të njëjtën mënyrë edhe elita e peygamberëve para tij, që shquheshin me vendosmërinë e tyre të lartë.

- Dita kur këta mohues të Njëshmërisë do të paraqiten para Krijuesit fuqiptotë për të dhënë llogarinë e tyre përfundimtare, tmerri dhe llahtaria të cilin do ta shohin e përjetojnë, do t’i bëjë të thonë se në këtë dynja jetuan vetëm një çast të shkurtër të saj.

- Kurani famëlartë është kumtim dhe tërheqës i vërejtjes. Ai që ndjek këtë udhëzim, do të jetë i përndritur, e ai që ia kthen shpinën dhe e mohon, do të jetë i mjerë dhe në ndëshkim të pasosur.

- Fund -

1. Ale Hamim, *El-Xhathijetu-El Ahkaf, dirasetun fi esvari-l bejan*, f. 584. 2. Muhamedin el Emin bin Abdullah el Arumij el Hererij esh-Shafi’ij, *Hadaikur-r-revubi ve-r-rrejhan fi revabi Ulumi-l Kuran*, Bejrut, 2001, vëll. XXVII, f. 105. 3. Imam Nese’iu, *Medariku-t-Tenzil ve Hakaiku-t-Tevil*, Bejrut, 1998, vëll. III, f. 319. 4. Shejh Sharavi, *Havativi havle-l Kurani-l Kerim*, Kajro, 1991, vëll. XXIII, f. 14264. 5. Transmeton Taberaniu nga Ukbe bin Amir. në *El-Mu’xhemul Kebir nr. (14275)*. Kuptimi i kësaj lutjeje profetike është përafërsisht ky: “Ndodh vetëm ajo çka dëshiron Allahu; Nuk ka ndryshim e as forcë pa ndihmën e Allahut” 6. *Shih më gjerësisht: Muhamed Abdulhakk ibn Shah el Hindi el Hanefij, El-Iklil ala Medariki-t-tenzil ve hakaiki-t-tevil*, Bejrut, 2012, vëll. VI, f. 565. 7. Imam Maturidiu, *Tevilatu Ehli-s-Sunneti*, (redaktuar nga dr. Mexhdi Basel-lum), Bejrut, 2005, vëll. IX, f. 260. 8. Mendimi i shumicës dërmuese të dijetarëve është se me fjalën ‘belag’ synohet Kurani famëlartë, *Shih: Muhamed Izzet Druzeh, Et-Tefsiru-l hadith, Kajro, 2000, (botimi i dytë), vëll. V, f. 31.*

Dr. Ajni Sinani

Premtimi hyjnor për rikthimin e Pejgamberit a.s. prej Medinës në Mekë

Pejgamberi a.s., i cili qëndroi në shpellën Thevr gjatë hixhretit të tij nga Meka, kur mori lajmin se politeistët e kishin prerë shpresën për ta kapur dhe e kishin lënë kërkimin, ditën e katërt së bashku me Hz. Ebu Bekrin r.a. hipën në devetë e sjella nga udhërrëfyesi dhe u nisën për Medine. Sidoqoftë, ky udhëtim ishte një ndarje nga vendi ku kishte lindur dhe ishte rritur, prandaj kjo gjë shkaktoi hidhërim të Pejgamberit a.s. Kur arritën në zonën e quajtur Hazvere, ai e ndaloi devenë, u drejtua nga Meka dhe tha: "Te Allahu ti je më e dashura e vendbanimeve. Po të mos më nxirrnin, kurrë nuk do të kisha

dalë prej atje, nuk do të bëja vatan tjetër e të ngrija vatrë tjetër!..."¹

Pas hidhërimit, Pejgamberit a.s. i erdhi qetësimi me anë të shpalljes hyjnore. Rrugës për Medine, Muhamedit a.s. iu premtua se do të rikthehej prej Medinës në Meke: "S'ka dyshim, se Ai që ta bëri obligim Kuranin, Ai do të kthejë ty aty nga erdhe. Thuaj: "Zoti im e di më mirë kush është që solli udhëzim të drejtë dhe kush është në humbje të sigurt." (El-Kasas, 85). Ky ajat e ky premtim hyjnor i dhanë Pejgamberit a.s. sihariqin e rikthimit dhe të çlirimit të Mekës, dhe në të njëjtën kohë ia kthyen hidhërimin e zemrës në gëzim!

Vërtetimi i ëndrrës së Pejgamberit a.s. për kryerjen e Umres dhe paralajmërimi për çlirimin e Mekës

Në vitin e gjashtë në Medinë, Muhamedi a.s. kishte parë në ëndërr, se kishte hyrë në Mekë, se kishte bërë tavaf dhe se shokët e tij i rruanin dhe i shkurtonin flokët njëri-tjetrit. Këtë ëndërr ua tregoi shokëve dhe ata u gëzuan. Pejgamberi a.s., me njëmijë e katërqind shokë, ia mësyu për vizitë Qabesë. Mirëpo, kur arritën në vendin e quajtur Hudejbie, jo shumë larg Mekës, idhujtarët nuk i lejuan myslimanët të hyjnë në Qabe. Pejgamberi a.s. dërgoi Osmanin t'i lajmëronte mekasit, se dëshironin ta bënin umren - vizitë Qabesë.

Mekasit e ndaluan Osmanin, e Pejgamberit i shkoi lajmi se e kishin vrarë. Pejgamberi i thërriti shokët të jepnin besën, se do të hynin në luftë me idhujtarët e Mekës. Ata u zotuan me jetë dhe ky zotim u bë nën hijen e një druri. Kur dëgjuan mekasit për vendimin e myslimanëve u frikësuan, e lëshuan Osmanin dhe kërkuan marrëveshje. Kështu u nënshkrua marrëveshja me idhujtarët. Pejgamberi a.s. së bashku me sahabët do të ktheheshin pa hyrë në Mekë, ndërsa vitin e ardhshëm do të mund të hynin në një afat prej tre ditësh. Sapo përfundoi marrëveshja e paqes,





Pejgamberi iu afrua kurbanit të tij, e theri atë, pastaj u ul dhe e rroi kokën e vet. Kur njerëzit panë se Pejgamberi a.s. e theri kurbanin dhe e rroi kokën, edhe ata vepruan ashtu. Hipokritët thanë: as nuk hymë në Mekë, as nuk therëm brenda saj kurbanet, e as nuk u rruam, e ku është ëndrra? Rrugës mes Mekës e Medinës Pejgamberit a.s. i zbriti surja El-Feth: “Ne të dhamë ty një fitore të qartë, për të t’i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë...” (El-Feth, 1-2).

Gjithashtu në këtë sure Allahu xh.sh. thotë: “Allahu ëndrrën e të dërguarit të Vet e përbushi me të vërtetë: me vullnetin e Allahut do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të siguruar, t’i rruani flokët e kokave tuaja, t’i shkurtoni e nuk do të keni frikë! Ai e dinte atë që nuk e dinit ju dhe, veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt.” (El-Feth, 27).

Kjo i referohet ëndrrës që kishte parë Pejgamberi a.s., se në Mekë se do të hynin të sigurt, pa frikë dhe me koka të rruara dhe flokë të qethura, pa u frikësuar. Ai di atë që ju nuk dini, “...veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt.”, paqen në Hudejbije.²

Ky ajet kuranor i informoi myslimanët se ata do të hynin në xhaminë e shenjtë dhe do të kryenin ceremoninë e haxhit të vogël (umren) pa ndonjë frikë, dhe se politeistët do të pësonin disfatë, si dhe fuqia e tyre

do të zhdukej. Këto parashikime janë bërë në kohën kur askush nuk mund t’i parashikonte ngjarjet, duke marrë parasysh kushtet e vështira të myslimanëve dhe situatën e pafavorshme në të cilën gjendeshin.

Nuk ishte fuqia dhe armatimi që posedonin myslimanët ajo që i bëra ata fitues, por ishte ndihma e Zotit që iu bashkua përpjekjeve të tyre të zellshme e cila ua mundësoi arritjen e fitores. Ashtu ndodhi. Premtimi u realizua. Në vitin tjetër myslimanët hynë në Mekë dhe i kryen të gjitha ceremonitë duke iu plotësuar dëshira e tyre.³

Madje që në fillim të sures: “Ne ty të dhamë një fitore të sigurt” (El Feth, 1), Allahu xh.sh. paralajmëron për fitoret që do të pasojnë. Sipas një numri të komentuesve të Kuranit me këtë “feth”, çlirim, ka si qëllim çlirimin e Mekës. Disa komentues të tjerë, të mbështetur edhe në hadithin që shënon Buhariu, thonë: me këtë çlirim është fjala për paqen dhe marrëveshjen e Hudejbisë, në të cilën janë radhitur një mori ngjarjesh të rëndësishme siç janë: besëlidhja (Bej’atur Ridvan), kontrata që lidhi Pejgamberi a.s. me kurejshitet, pranimi i Fesë Islame nga një numër i madh njerëzish etj.⁴ “Vërtet, Allahu që i kënaqur me besimtarët, kur ata nën hijen e atij druri të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç’kishin zemrat e tyre, prandaj iu dhuroi qetësimin dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore (çlirimin e Hajberit).” (El Feth, 18).

Kurani këtu përmend zhvillimet e ardhshme, fitoren mbi Hajberin, nga ana e luftëtarëve myslimanë dhe çlirimin e kështjellës së vështirë. Goditje të rënda iu shkaktuan myslimanëve prej kështjellës së Hajberit, por në fund ushtria islame fitoi mbi atë të hebrejve, kështu që parashikimi i Kuranit u përbush tërësisht.

Pas marrëveshjes së Hudejbijes ndodhi çlirimi i Hajberit dhe i Mekës dhe çlirime të tjera. Beduinët tradhtarë u përpoqën të merrnin pjesë në prenë e luftës, por vendimi i Zotit ishte se preja e Hajberit u takon vetëm atyre që i kishin dhënë besën Pejgamberit a.s. në Hudejbi, e askujt tjetër.

A kishte qenë e mundshme që të flitej për fitoren, në kohën e dobësisë më të madhe, pa besimin e plotë në përmbajtjen e shpalljes hyjnore? A mund t’ia përshkruajmë Muhamedit a.s. këtë mendjemprehtësi dhe dituri të saktë për të ardhmen?

Pejgamberi a.s. u lajmërua, disa vjet më herët, se ai do ta çlironte Mekën, dhe lajmërimi për këtë fitore, që më vonë u bë realitet është një nga argumentet, se Muhamedi a.s. vërtet ishte i Dërguar i Zotit.

1. Ahmed, IV, 305; Tirmidhi, Menakib, 68/3925, sipas Osman Nuri Topbash, Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Mustafa, Shkodër, 2012, f. 415-16. 2. Biografia e Pejgamberit sal-Allahu alehi ve sel-lem, Sira nga Ibn Hisham, Botoi Sira, Prishtinë 2021, f. 267. 3. Kurani përkthim me komentim në gjuhën shqipe, shih komentin e H. Sherif Ahmeti në fq. 580. 4. Kurani përkthim me komentim në gjuhën shqipe, shih komentin e H. Sherif Ahmeti në fq. 577.

Philip Dorroll
Wofford College

Universi në fluks – rishikimi i metafizikës dhe epistemologjisë te Mansur el-Maturidiu (2)

Shkurtimisht, epistemologjia e Maturidiut mund të përmblihet si vijon. Feja kuptohet në lidhje me dy burime të dijes: arsyen ('aql) dhe njohurinë e raportuar nga burime në të cilat arsyeja nuk ka qasje të drejtpërdrejtë (sem'), siç është shpallja ose njohuria historike.

Maturidiu më tej e zbërthen këtë ndarje në tri mënyrat me të cilat qeniet njerëzore dinë diçka: përvoja e drejtpërdrejtë shqisore (*el-ʿiʿjan*), informacioni i raportuar që është i paarritshëm për perceptimin e drejtpërdrejtë ndijor ose reflektimin e arsyetuar (që është përmbajtja e njohurive që ka të bëjë me *sem'ū ʿl-abbar*), dhe reflektimi ose deduksioni i arsyetuar (*en-naḍhar*). Prandaj, njohuria njerëzore prodhohet mbi reflektimin e arsyetuar që sintetizon dhe interpreton informacionin ndijor dhe informacionin e raportuar nga burime (të besueshme) të jashtme. Për shkak të theksit të fortë në të dhënat shqisore dhe përvojës së drejtpërdrejtë në teologjinë e Maturidiut, ai shpesh përdor terma që lidhin njohuritë me një proces perceptimi.¹ Vetë konceptimi i arsyes te Maturidiu (e cila është përshkruar në detaje nga studiues të tillë si Alper, Özcan, Pessagno dhe Rudolph) nuk është saktësisht ajo me të cilën kemi të bëjmë këtu. Përkundrazi, kjo analizë dëshiron të nxjerrë në dritë një aspekt pak të njohur të teorisë së njohurive të Maturidiut që duket se lidhet drejtpërdrejt me të kuptuarit e tij të fluksit metafizik. Ky aspekt ka të bëjë me rolin e perceptimit dhe të perspektivës në epistemologjinë e Maturidiut. Në pika të ndryshme të tekstit të tij, Maturidiu nënkupton që perceptimi dhe perspektiva luajnë


një rol kyç në mënyrën se si njerëzit i njohin gjërat. Gjatë argumentit të tij, se si mund të thuhet se njerëzit kanë një vizion të Zotit në jetën e përditshme, por pa ndjenjën e perceptimit të drejtpërdrejtë dhe të gjithë fizikun që kjo nënkupton, Maturidiu shpjegon se Zoti nuk mund të thuhet se posedon ndonjë gjurmë aspekti fizik ose përkufizimi. Megjithatë, janë këto tipare themelore të të gjitha gjërave të tjera (përkufizimi dhe aspekti) që janë vetë baza me të cilën ato mund të njihen:

Çdo gjë ka një përkufizim (*ḥadd*) me anë të cilit perceptohet (*judraku*), si shija, ngjyra, aroma, era dhe përkufizime të tjera të tilla specifike të gjërave. Zoti ka caktuar për çdo gjë të tillë një aspekt (*vexhb*) me anë të të cilit perceptohet dhe me anë të cilit kuptohet...²

Përsëri, terminologjia e Maturidiut këtu është mjaft e fshehtë. Termat *ḥadd* dhe *vexhb* kanë rëndësi fizike dhe abstrakte. Është e vështirë të thuhet nëse Maturidiu këtu i referohet kufirit fizik dhe sipërfaqes, ose nëse ai i referohet kuptimeve thjesht abstrakte të përkufizimit dhe aspektit. Duket, në fakt, se terminologjia e tij ka për qëllim t'i bashkojë të dyja këto grupe kuptimesh. Ky është një rast ku stili gjoja i paqartë i tij duket të jetë shumë i qëllimshëm. Maturidiu i ka zgjedhur këto fjalë për të nxjerrë në pah pikën që Zoti është përtej çdo

nocioni kufizimi, kufiri apo aspekti të perceptuar, qoftë kjo në kuptimin fizik apo abstrakt. Dhe përsëri, këtu është thelbësore që ai të përdorë terminologjinë e vështirimit për të përshkruar se si njerëzit i njohin gjërat.

Një përdorim i ngjashëm i termit 'aspekt' (në një kuptim qartësisht abstrakt) gjendet në diskutimin e Maturidiut për marrëdhënien ndërmjet vullnetit të lirë të njeriut dhe plotfuqishmërisë hyjnore. Siç dihet, ai pohon fuqishëm lirinë e veprimit njerëzor duke pohuar se qeniet njerëzore zotërojnë zgjedhje të lirë (*ihitjar*) në çdo veprim që kryejnë.³ Megjithatë, Maturidiu



gjithashtu kërkon të vërtetojë se Zoti është absolutisht i gjithëfuqishëm në të gjitha gjërat dhe është krijuesi i të gjitha gjërave në univers, duke përfshirë edhe vetë veprimet njerëzore. Ai pohon se të dyja këto teza janë të vërteta dhe se mohimi i njërës prej tyre është po aq i pambështetur nga provat e shqisave dhe vetë arsyes.⁴ Megjithatë, mbajtja e të dyjave si të vërteta në të njëjtën kohë duket se rezulton në një kontradiktë. Maturidiu e zgjidh këtë kontradiktë jo duke u përpjekur t'i detyrojë ata të përshtaten së bashku në një konstrukt kompleks teorik të rendit të dytë; përkundrazi, ai thjesht i mban këto dy të vërteta (në dukje kontradiktore) së bashku në tension. Ai thekson se të dyja janë thjesht dy *aspekte* të ndryshme të të njëjtit realitet, secila e vërtetë është po aq e vërtetë sa tjetra, por secila vetëm e perceptueshme një nga një.⁵ Çdo veprim është me të vërtetë i Zotit në kuptimin që Zoti është ai që e krijon atë, dhe në të njëjtën kohë akti është me të vërtetë i qenies njerëzore në kuptimin që ajo ose ai e zgjedh atë lirisht; ose, siç shprehet ai: 'Është vërtetuar se ato (veprimet njerëzore) në kuptimin e aspektit të parë nuk janë të tyre (qenieve njerëzore), dhe në kuptimin e aspektit të dytë janë të tyre.'⁶ Maturidiu i referohet kësaj teorie si 'aspekte të veprimt'.⁷ Ai është shumë këmbëngulës në këtë pikë (dhe madje edhe në këtë frazeologji) dhe e bën atë herë pas here gjatë diskutimit të tij për këtë paradoks të vështirë teologjik.

Si me dashtë me shpjeguar qëndrimin mbi aspektin, Maturidiu përpigjet të tregojë se edhe veprimet më të qortueshme mund të shihen si të mira nga të paktën një këndvështrim. Gjatë gjithë diskutimit të tij të gjatë për aspektet e një veprimi njerëzor, ai përdor një shembull mjaft të mrekullueshëm për të ilustruar pikëpamjen e tij:

Sepse, a nuk e shihni se doktrina e mosbesimit (*kufër*) është një gënjeshtër, por se ajo është, nga këndvështrimi i saj që tregon marrëzinë e atij që e mban atë, një e vërtetë? Po kështu, ai (veprimi

Maturidiu përdor një term në veçanti gjatë gjithë veprës së tij që përmbledh më së miri teorinë metafizike të nënkuptuar në të gjitha reflektimet e mësipërme filozofike dhe teologjike.

njerëzor) është një zgjedhje e lirë për sa i përket përvetësimit (*kesb*)⁸, dhe në lidhje me krijimin (e tij) (nga Zoti) nuk është; megjithatë aspekti i krijimit nuk dëmton zgjedhjen e lirë për aq sa është vendosur (krijimi). (*Kitabu 't-Tevhid*, 321)

Ky është ndoshta një nga pasazhet më të habitshme në veprën e Maturidiut. Është një demonstrim dramatik i pohimit të tij se vetë thelbi i çdo gjëje të caktuar në univers mund të pranojë karakterizime krejtësisht kontradiktore bazuar në këndvështrimin e personit që e percepton atë. Në të vërtetë, analiza e Maturidiut për aspektet e ndryshme të një akti njerëzor tregon se ai mendon se këto aspekte kontradiktore mund të jenë disi të përfshira në një gjë të vetme në të njëjtën kohë (siç bëjnë natyrat e kundërta në objektet fizike). Megjithatë, për shkak të papajtueshmërisë së tyre logjike, qeniet njerëzore thjesht nuk janë në gjendje t'i kuptojnë menjëherë këto përmasat e shumanshme të një realiteti të vetëm. Përkundrazi, kërkohet një ndryshim në perspektivë për të kuptuar aspektet e ndryshme të një dukurie të vetme.

Një pasazh në veçanti duket se i lidh të gjitha këto reflektime mjaft të ndryshme mbi aspektin dhe perceptimin së bashku:

Qenia njerëzore përbëhet nga kufijtë (*hudud*) dhe perspektivat (*shihat*), dhe çdo perspektivë nga ai person qëndron përballë një

perspektive nga gjëja e perceptuar, dhe ai person nuk percepton me anë të asaj perspektive asgjë tjetër përveç perspektiva që qëndron drejtpërdrejt përballë tyre. Dhe nëse mangësia ndërhyr në këndvështrimin e personit me anë të së cilës ata e perceptojnë të kundërtën e saj, ose nëse një send fsheh të kundërtën e tij dhe e fsheh atë, atëherë shtrirja e asaj (pengimi) largohet nga perspektiva dhe e kundërta e saj, dhe ajo është si perceptimi (*idrak*) pa perspektivën që është ekzistuese për atë lloj perceptimi. Kështu, gjendjet e perceptimit janë tre:

1) përmbysja e perspektivës në mënyrë që asgjë të mos perceptohet fare me anë të saj;

2) vendosja e saj (perspektivës) me heqjen e të gjitha pengesave të tilla që natyra thelbësore e një gjëje të perceptohet prej saj ose;

3) një përzjerje (e dy gjendjeve të mësipërme). Perceptimi ndryshon sipas variacionit të këtyre gjendjeve. (*Kitabu 't-Tevhid*, 224)

Përsëri, këtu duket se kuptimet fizike dhe abstrakte të *shihat* mbahen së bashku dhe implikohen në përdorimin e këtij termi të vetëm: kuptimi i tij fizik si "drejtim" dhe kuptimi i tij më abstrakt si "pikvështrim" ose "aspekt". Prandaj, termi 'perspektivë' është zgjedhur këtu për të provuar dhe kapur plotësinë e përdorimit të Maturidiut. Në të njëjtën kohë, nocioni bazë i të njohurit si perceptim mbetet. Ky pasazh, kur kombinohet me pohimet më specifike teologjike të përshkuara më sipër, tregon se epistemologjia e Maturidiut përmban një teori të perceptimit intelektual që i përgjigjet natyrës shumanshme të realiteteve me të cilat përballemi në botë. Njohuritë tona për këto realitete komplekse dhe kontradiktore bazohen në këndvështrimin ose orientimin tonë individual dhe nga çdo këndvështrim mund të dallohet një aspekt i caktuar i një fenomeni.

Njohja njerëzore atëherë, për Maturidiun, është një lloj procesi kaleidoskopik, ku perceptimi ynë i fenomeneve zhvendoset në fokus me një ndryshim në këndvështrimin

Maturidiu argumenton se një gjendje e fluksit konstant karakterizon komponentët më elementare të universit material.

tonë. E vërteta është në vetvete shumanshme dhe mund të trajtohet vetëm nga këndvështrime të ndryshme. Ndërsa të vërtetat absolute (të tilla si njëshmëria e Zotit) ekzistojnë, ato shfaqin një sërë aspektesh dhe tiparësh që janë kontradiktore nga pikëpamja jonë e kufizuar, secila prej të cilave mund të perceptohet vetëm kur këndvështrimi ynë është në përputhje me aspektin e së vërtetës që po përpikemi të shquajmë. Për Maturidun, e vërteta është në fakt shumëdimensionale. Është për këtë arsye që ai përdor terminologjinë që përshkruan problemet më abstrakte filozofike në terma pothuajse fizikë, sepse sipas tij vetë natyra e së vërtetës është më e plotë dhe më komplekse sesa mund të kuptojë çdo këndvështrim i vetëm.

Ky vëzhgim i thellë epistemologjik aludon në një vizion po aq të thellë metafizik. Diskutimi i Maturidut për natyrat dhe ndryshueshmërinë e realitetit tregon për këtë vizion unik metafizik. Maturidiu përdor një term në veçanti gjatë gjithë veprës së tij që përmbledh më së miri teorinë metafizike të nënkuptuar në të gjitha reflektimet e mësipërme filozofike dhe teologjike. Ky term është *tekal-lub*, një fjalë që tregon përmbysje, ndryshim, ndryshueshmëri; ose thënë më thjesht, fluks. Maturidiu përdor këtë term për të përshkruar gjendjet vazhdimisht në ndryshim (*ahval*) të të gjitha gjërave në univers. Termi 'fluks' nënkupton procesin ku gjërat ndryshojnë vazhdimisht nga gjendja në gjendje, një fenomen që është absolutisht thelbësor për qenien e krijuar.⁹ Në të vërtetë, Maturidiu e bën të qartë se tërësia e krijimit të Zotit, tërësia e të gjitha gjërave në univers,

luhatet në këtë mënyrë, vazhdimisht nën drejtimin e Zotit.¹⁰

Në pika të shumta dhe në kontekstin e një shumëllojshmërie të gjerë argumentesh në *Kitabu 't-Tevhid*, Maturidiu argumenton se një gjendje e fluksit konstant karakterizon komponentët më elementare të universit material. Për më tepër, është kjo gjendje e vazhdueshme e fluksit që është prova më e evidente për ekzistencën e një krijuesi dhe mbështetësi të gjithëfuqishëm të botës:

Sepse ne e kemi gjetur tërësinë e asaj që është e perceptueshme në botë si të paracaktuar, të paafte për t'u organizuar, të paditur për fillimin e gjendjes së saj dhe për masën e pjesëmarrjes së saj në të gjitha gjendjet kohore ose hapësinore, brenda të cilave ajo luhatet (*jetekal-lebu*) dhe me anë të së cilës është krijuar, duke qenë brenda tij cilësitë e kundërta, natyra e të cilave është reciprokisht të përkundërta, prandaj kuptohet se universi nuk ekziston në vetvete, dhe kuptohet gjithashtu se kushdo që e urdhëroi dhe e përcaktoi atë, ka njohuri për të dhe pushtet mbi të. (*Kitabu 't-Tevhid*, 161)

Maturidiu gjithashtu përshkruan elementët më themelorë të universit fizik si "tërësia e trupave dhe aksidenteve që gjenden në vendndodhje midis të cilave ato luhaten dhe vendosen" (*po aty*, 133). Ai gjithashtu e përshkruan botën e perceptimit shqisor si "të luhatshme nga një gjendje në tjetrën". Ai e përmbledh në mënyrë poetike këtë vizion të botës në këtë mënyrë: "Tërësia e krijimit të [Zotit] luhatet (*tekal-lebe*) përmes dhuratave dhe mirësisë së Tij" (*po aty*, 301).

Termi *tekal-lub*, siç e kemi parë me terminologji të tjera më sipër, është zgjedhur shumë qëllimisht. Ai ka kuptimin e jo thjesht ndryshimit ose modifikimit, por më konkretisht tregon një zhvendosje nga një gjendje e mëparshme në tjetrën, një lloj përshkrimi metafizik shumë specifik që përputhet në mënyrë të përkryer me përshkrimin e Maturidut për lëvizjen e natyrave dhe përshkrimin e ndryshueshëm të çdo gjë e dhënë ndërsa lëviz nga gjendja në gjendje. Kështu diçka mund të jetë e mirë në një rast dhe e keqe në një tjetër. Ai bazohet në parimin metafizik që një grimcë e vetme e qenies (*xhevhar*) mund

të përmbushet në një sërë gjendjesh të mundshme që përcaktojnë përshkrimin e saj themelor si e mirë ose e keqe, e dëmshme ose e dobishme, sipas atij momenti.

Ky koncept i fluksit metafizik shpjegon gjithashtu dimensionin ndryshe të paqartë të epistemologjisë së Maturidut të diskutuar më sipër. Mënyra se si ne i perceptojmë gjërat varet nga ajo gjendje në të cilën i perceptojmë ato ekzistuese, ose për ta thënë në terma epistemologjikë, çfarë aspekti të tyre dallojmë në çdo moment të caktuar. Procesi vazhdimisht në ndryshim i dallimit të aspekteve të ndryshme (dhe madje kontradiktore) të fenomeneve është mënyra epistemologjike që përshkruan në mënyrë të përsosur se si njerëzit duhet t'i qasen intelektualisht luhateve të vazhdueshme të universit në të cilin jetojnë. Dhe më e rëndësishmja, Maturidiu e bën të qartë se ky proces nuk ndodh rastësisht ose pa drejtim: Zoti qëndron pas tij, gjithmonë mbikëqyr dhe drejton ndryshimet dhe shndërrimet e tij (*po aty*, 301). Ky vizion metafizik nënkuptohet në epistemologjinë e perspektivës së Maturidut sepse fluksi i vazhdueshëm i botës reale shpjegon pse të kuptuarit tonë për të është kaq i situatës, dhe



kështu varet nga perspektiva dhe aftësia jonë për perceptim në çdo moment të caktuar. Komplexiteti, rinovimi, ndryshimi dhe modifikimi janë ndërtuar në strukturën e universit. Kjo është pikërisht arsyeja e perspektivës sonë gjithnjë në ndryshim. Nëse bota do të ishte plotësisht e qëndrueshme dhe e parashikueshme nga këndvështrimi ynë, nuk do të kishim asnjë problem të kuptonim të gjitha kompleksitetet e saj në çdo moment. Është për shkak se vetë bota dhe proceset e saj janë subjekt i ndryshimeve dhe flukseve të pafundme që ne mund ta shikojmë atë vetëm nga një këndvështrim në të njëjtën kohë. E vërteta shfaqet para nesh, largohet prej nesh, rishfaqet, zhvendoset dhe zbehet nga pamja. Ajo ecën më shpejt se ne dhe përtej pamjes tonë, por Zoti na ka dhuruar instrumentet për ta analizuar atë megjithatë, qoftë edhe në mënyrë të papërsosur dhe me respektin e duhur për situatën tonë epistemologjike.

Shënime përfundimtare

Është një pyetje e rëndësishme nëse ky vizion metafizik u përvetësua dhe u përdor në mënyrë aktive nga pasardhësit intelektualë të Maturidiut në traditën e shkollës maturidiane. Si hap paraprak drejt përgjigjes së kësaj pyetjeje, kjo analizë do të përfundojë me një diskutim të qëndrimit të Ebu l-Mu'in En-Nesefiut (vd. 508/1115) për këto çështje në veprën e tij monumentale *Tebzirat 'ul-edil-leh*, përpjekja më me ndikim i një anëtarit të shkollës maturidiane për të sistemuar dhe zyrtarizuar doktrinat e Maturidiut.¹¹ Si i tillë, *Tebzirat 'ul-edil-leh* konsiderohet zakonisht teksti më i rëndësishëm i traditës teologjike maturidiane pas vetë *Kitabu 't-Tevhidit*.

Para së gjithash, nuk ka pothuajse asnjë diskutim në *Tebzirat l-edileh* për konceptin e natyrave të kundërta. Nesefiu pranon vetëm në një vend të tekstit se bota është e përbërë nga natyra të tilla, por nuk hyn në ndonjë hollësi të mëtejshme për këto natyra dhe nuk i përmend ato askund tjetër në veprën e tij.¹² Megjithatë, Nesafi e pranon në mënyrë eksplicite diskutimin e Maturidiut për aspektet e ndryshme të

një veprimi njerëzor dhe pajtohet qartë me të në një masë të caktuar. Sidoqoftë, diskutimi i Nesafiut nuk ka asnjë nga implikimet më të gjera metafizike ose epistemologjike që gjenden në shumë diskutime të aspektit dhe perspektivës së Maturidiut. Nesafiu e pranon se një akt ka dy aspekte, kuptimin në të cilin është krijuar nga Zoti dhe kuptimin në të cilin i përket vullnetit të lirë të qenies njerëzore, ashtu siç bën Maturidiu.¹³ Nesafiu qartë hedh poshtë çdo implikim më të gjerë epistemologjik të kësaj ideje, megjithatë, duke deklaruar në mënyrë eksplicite se ky pohim nuk nënkupton se njohja jonë për këtë akt ndodh me anë të dy këndvështrimeve të veçanta. Përkundrazi, kjo njohuri ndodh me anë të perceptimit të sendit thjesht ashtu siç është. Kjo deklaratë duket qartë se hedh poshtë llojin e epistemologjisë të nënkuptuar në diskutimet e Maturidiut.¹⁴

Në të njëjtën kohë, Nesafiu gjithashtu pranon pohimin e Maturidiut për një teori të aspekteve të një veprimi njerëzor, megjithatë pretendon se Maturidiu përdori këtë lloj gjuhe vetëm për të shpjeguar më qartë pozicionin e tij. Nesafiu pohon se, larg nga kjo teori që luan një rol në një sistem më të gjerë metafizik dhe epistemologjik, Maturidiu e përdori këtë terminologji vetëm si një ndihmë shpjeguese gjatë gjithë rrjedhës së diskutimit të tij për këtë problem teologjik.¹⁵ Përveç kësaj, megjithatë, Nesafiu kritikon ashpër të dy Eshariun dhe mutezilitet për refuzimin e vetë mundësisë së të folurit për veprat njerëzore në këtë mënyrë, pavarësisht pohimit të tij të qartë se ky diskutim i aspekteve të një veprimi nuk është thelbësor as për doktrinën e tij dhe as për doktrinën teologjike të Maturidiut.¹⁶

Marrë në tërësi, pra, duket shumë e qartë se Nesafiu është i shqetësuar qartë për të zbutur disa nga implikimet më radikale në teologjinë e Maturidiut. Ndërsa në heshtje pranoi se disa nga deklaratat e tij mund të kuptohet në këtë mënyrë, Nesafi e mohon me vendosmëri se kështu duhet të interpretohen. Madje ai lë jashtë pjesë të mëdha të vetë këtyre ideve teologjike, si çdo diskutim i thellë i natyrave ose ndonjë përmendje fare e konceptit të fluksit, i cili, me gjithë praninë e tij të kudondodhur të

Maturidiu, nuk luan asnjë rol në sistemin teologjik të Nesafiut dhe nuk përmendet askund në *Tebzirat 'ul-edil-leh*. Në teologjinë e Maturidiut, megjithatë, nocioni i fluksit kuptohet se është karakteristik në mënyrë unike për universin e krijuar. Ndryshimi i pandërprerë i universit nën drejtimin e Zotit të gjithëfuqishëm kushtëzon mënyrën se si dija njerëzore përpriqet të kuptojë botën e krijuar. Për Maturidiun, realiteti është i arritshëm, por shumë më i madh se perceptimi racional dhe fizik i njeriut: kështu ai shfaq pafundësisht aspekte të ndryshme të vetvetes në mendjen njerëzore. Fluksi i gjërave është forca destabilizuese që turbullon fiksimin e çdo lloj absoluti dhe duke e bërë këtë prodhon diversitetin madhështor që na rrethon; është gjithashtu, në të njëjtën kohë, prova më efektive për ekzistencën e një Krijuesi të përjetshëm dhe të plotfuqishëm.

Përshtati: Haki Sahitaj

1. Shih për shembull Maturidi, *Kitab et-Tevhid*, 480.
2. Maturidi, *Kitabu 't-Tevhid*, 146. 3. Për një analizë të shkëlqyer në lidhje me këtë çështje të Maturidiut shih, Pessagno, *Trada, Ihtiyar, Kudra, Kasb*. Pessagno gjithashtu tregon për këto aspekte të ndryshme të një veprimi teksa Maturidiu bënë dallimin midis "mënyrave të të folurit" brenda një kompleksi të vetëm pohimesh teologjike. Interpretimi i ofruar këtu, ndonëse nuk është në kundërshtim me analizën e Pessagno në vetvete, kërkon të nxjerrë në pah implikimet më të gjera metafizike të arsytimit teologjik të Maturidiut për këtë dhe çështje të tjera. 4. Shih për shembull Maturidi, *Kitabu 't-Tevhid*, 307, 310, 326, 378, 385, 388. 5. Po aty, 323. 6. Maturidi, *Kitab et-Tevhid*, 310. 7. Po aty, 8. Mbi kuptimin e Maturidiut për këtë term (përdoret në kalam për të treguar mënyrat në të cilat qeniet njerëzore mund të thuhet se zotërojnë ose janë moralisht përgjegjës për veprimet e tyre edhe pse këto veprime janë krijuar nga Zoti) shih Pessagno, *Trada, Ihtiyar, Kudra, Kasb*. 9. Rastet më të rëndësishme të përdorimit të këtij termi nga Maturidiu mund të gjenden në *Kitab et-Tevhid*, 133, 161, 178, 252, 254 dhe 301. 10. Po aty, 301. 11. Për përmbledhje të shkëlqyer të doktrinave dalluese të Nesafiut dhe rëndësia e tij në formimin e një sistemi teologjik maturidian, shih M. S. Yazicioğlu, *Maturidi Kelâm Ekolünün İki Bîyüik Siması: Ebü Mansûr Maturidî ve Ebü'l-Mu'in Nesefî*, Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, 27 (1985): 281-98, dhe W. Madelung, *Abü l-Mu'in al-Nasafi and Ash'ari Theology* në Carole Hillenbrand (ed.), *Studies in Honour of Clifford Edmund Bosworth. Volume II: The Sultan's Turret: Studies in Persian and Turkish Culture* (Leiden: Brill, 2000), 318-30. 12. Nesafi, *Tebziratü'l edille*, i. 20. Shih po ashtu Rudolph, *al-Maturidi*, 267. 13. Po aty, ii. 226. 14. Po aty, 15. Po aty, 260. 16. Po aty, 260-2. Bezdeviu pranon se një send ose një veprim mund të ketë aspekte të shumta kontradiktore me të cilat mund të njihet. Bezdevi gjithashtu kritikon mutezilitet për refuzimin e plotë të kësaj ideje, siç bën Nesafiu (shih U 'ul ed-din, 110, 233). Megjithatë, ashtu si me Nesafiu, këto shqetësime ndodhin shumë rrallë në punën e tij dhe nuk duket se luajnë një rol përcaktues në teologjinë e tij. Si Nesafiu edhe Bezdeviu në asnjë moment nuk e përdor terminin *al-lub*, as nuk sugjerojnë llojin e ideve metafizike që gjenden në veprën e Maturidiut.

Dr. Berat Hashani

Përpyjekjet e para për përkthimin e domethënieve të Kuranit në gjuhën shqipe

Fillet e para për përkthimin e domethënieve të Kuranit në Evropë ndodhën në shekullin XXI, më konkretisht në vitin 1143, në gjuhën latine. Nismëtar ishte një i krishterë i quajtur Abatit Pjetër, i cili kishte plotësuar përkthimin e domethënieve të Kuranit në gjuhën latine, mirëpo për shkaqe të panjohura, kjo kopje ishte fshehur nga Kisha, për një periudhë të gjatë, rreth 400 vjet.

Mirëpo më vonë, pas krejt kësaj periudhe, një person i quajtur Bibliander Theodor ishte shkaktar që kjo kopje ta shoh prapë dritën e saj, dhe kishte ndodhur kjo në vitin 1543. Më pas, nga viti 1716, fillon përkthimi i domethënieve të Kuranit edhe në gjuhë e tjera.¹

Sa i përket përkthimit të domethënieve të Kuranit fisnik në trojet shqiptare, gjejmë se kishte ndodhur krejt më vonë. Me ardhjen e Islamit në këto troje, interesimi për leximin, interpretimin dhe nxënien përmendësh të Kuranit të shenjtë ka qenë i lartë. Mirëpo shqiptarët nuk gjetën një përkthim të Kuranit të shenjtë në gjuhën shqipe. Në vend të kësaj, ata lexonin Kuranin e shenjtë në gjuhën arabe, dhe për ta kuptuar atë, iu referuan domethënieve të Kuranit në gjuhën turke, ngase e njihnin këtë gjuhë.

Këto rrethana vazhduan deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ku për herë të parë një nga figurat e shquara të letërsisë sonë shqipe, Naim Frashëri,² përktheu kuptimin e disa vargjeve të Kuranit fisnik në gjuhën


“Vërtet është për të ardhur keq, se si pas vdekjes së Naim Frashërit, shtëpitë botuese me qendër në ‘Prishtinë’, ‘Tiranë’, ‘Shkup’, larguan qëllimshëm nga botimi i librave të Naim Frashërit pjesët që përmbanin përkthimin e domethënieve të Kuranit në gjuhën shqipe...”

(Mahmud Hysa)

shqipe, dhe i botoi ato në librin e tij "Thelbi i Kuranit", në vitin 1894, në Bukuresht të Rumanisë. Naim Frashëri është i pari në historinë shqiptare që përktheu domethëniet e disa pjesëve nga Kurani i shenjtë në gjuhën shqipe.

Një nga historianët e shquar shqiptar, Mahmud Hysa, në librin e tij të quajtur "Alamiada Shqiptare II" thotë: "Vërtet është për të ardhur keq, se si pas vdekjes së Naim Frashërit, shtëpitë botuese me qendër në 'Prishtinë', 'Tiranë', 'Shkup', larguan qëllimshëm nga botimi i librave të Naim Frashërit pjesët që përmbanin përkthimin e domethënieve të Kuranit në gjuhën shqipe, me të vetmin qëllim që më pas askush mos të dijë se ai kishte përkthyer pjesë nga domethëniet e Kuranit të shenjtë."³

Ndër dijetarët e parë shqiptarë që filluan të përkthenin domethëniet e



Përkthime të pjesshme të domethënies të Kuranit fisnik u gjetën gjithashtu në revistën "Dituria Islame" në Kosovë, në revistën "Hilal" dhe "Hëna e Re" në Maqedoni, si dhe në revistën "Elif" në Mal të Zi.

disa vargjeve dhe kaptinave të Kuranit fisnik në gjuhën shqipe, interpretimin e tyre, dhe që bënë përpjekje të jashtëzakonshme që të jenë në shërbim të Islamit, ishin: Haxhi Vehbi Agolli, Haki Sharofi, hafëz Ismet Dibra, Sherif Putra, hafëz Mahmud Dashi, hafëz Ali Korca, Vexhi Demiraj, Ferid Vokopola, figura e njohur haxhi Sherif Ahmeti, dr. Feti Mehdiu, haxhi Hasan Nahi dhe shumë të tjerë.⁴

Ilo Mitkë Qafëzezi,⁵ konsiderohet si një nga të parët që përktheu kuptimet e shumë kaptinave të Kuranit të shenjtë në gjuhën shqipe, nga viti 1921. Ilo Mitkë Qafëzezi përdori përkthimin e Kuranit të shenjtë në gjuhën angleze, të Georg Sale.⁶ Më pas, gjejmë disa figura të shquara shqiptare, si: hafëz Ali Korqa, dhe hafëz Ibrahim Dalliu, të cilët përkthyen domethëniet e disa kaptinave të Kuranit të shenjtë.

Hafëz Ali Korqa filloi të përkthejë domethëniet e disa kaptinave të Kuranit të shenjtë, dhe t'i interpretojë ato. Pasi përfundoi kaptinën "En-Nas", në dhjetor të vitit 1926, ai vazhdoi të përkthejë kaptina të tjera deri në vitin 1929, dhe i botoi ato në revistën Zani i Naltë.⁷ Hafëz Ibrahim Dalliu bëri një interpretim të domethënies të Kuranit fisnik, dhe e quajti atë 'Ajka e Kuptimeve të Kurani Kerimit', i cili u botua në shtypshkronjën Ora e Shkodrës, në vitin 1929. Gjithashtu disa kaptina të Kuranit famëlartë i përktheu edhe

hafëz Abdullah Zemblaku, dhe të tjerë.

Përkthimin e domethënies të disa vargjeve të Kuranit të shenjtë e bëri edhe hafëz M. Dashi, gjatë një ligjërata që mbajti me datën 08.02.1931, në Xhaminë e Vjetër në Tiranë, ku më pas e botoi atë në revistën 'Zani i Naltë'. Hafëz M. Dashi përktheu gjithashtu domethëniet e disa vargjeve nga kaptina El-Israa, dhe e titulloi "Çfarë urdhëron Kurani", të cilën e botoi po në të njëjtën revistë, në botimin 3.

Haki Sharofi gjithashtu përktheu domethëniet e ajetit 350, të kaptinës El-Mu'minun, të titulluar "Çfarë urdhëron Kurani".⁸

Një përkthim i pjesshëm i domethënies të Kuranit fisnik u botua gjithashtu në revistën "Kultura Islame", të punuar nga disa figura të shquara shqiptare, si: Sherif Putra, Haki Sharofi, Sadik Bega, Sherif Vokopola.

Përkthimi i domethënies të disa kaptinave të Kuranit të shenjtë është botuar në vazhdimësi, në disa revista shkencore dhe arsimore në Prishtinë, e cila u themelua nga disa figura të njohura në Kosovë, si: Hajrullah Hoxha dhe haxhi Sherif Ahmeti. Përkthimi i domethënies të disa pjesëve të kaptinës "Ali-Imran" dhe "El-Bakare" u botua gjithashtu në vazhdimësi nga një grup i figurave të njohura pranë Bashkësisë Islame të Kosovës.⁹

Përkthime të pjesshme të domethënies të Kuranit fisnik u gjetën gjithashtu në revistën "Dituria Islame" në Kosovë, në revistën "Hilal" dhe "Hëna e Re" në Maqedoni, si dhe në revistën "Elif" në Mal të Zi.¹⁰

Vlen gjithashtu të cekët se dr. Feti Mehdiu përktheu të gjithë kaptinën "Esh-Shuara", të cilën e botoi në revistën "Edukata Islame", në vitin 1977. Ai përktheu gjithashtu disa kaptina të tjera dhe i botoi ato në revistën "Glasnik Vis" në Sarajevë, gjatë vitit 1983 dhe 1984.¹¹

Shkaqet që çuan në vonimin e përkthimit të domethënies të Kuranit në gjuhën shqipe

Çfarë na intereson të dimë, është se çfarë bëri që përkthimi i domethënies të Kuranit në gjuhën shqipe të vonohej?

Është interesant të cekët se, ndodhitë historike të shqiptarët ndërlidhën direkt me shkaqet që çuan deri te vonimi i përkthimit të domethënies të Kuranit në gjuhën shqipe. Lidhja e Prizrenit, në shtetin e Kosovës, ishte organizata e parë politike dhe ushtarake që punoi dhe luftoi në emër të popullit shqiptar, përgjatë viteve 1878-1881.

Nga ajo periudhë, ndërgjegjja kombëtare filloi të zgjohej, dhe nacionalizmi shqiptar filloi të populli shqiptar. Gjuha dhe kultura shqipe luanin një rol të madh në unitetin e popullit shqiptar. Gjuha shqipe ishte baza e kulturës kombëtare, por gjuha shqipe e shkruar nuk kishte ende një alfabet të përbashkët gjatë kësaj periudhe.

Pas përpjekjeve të mëdha, në Kongresin e Manastirit, udhëheqësit dhe studiuesit shqiptarë, vendosën të krijonin një alfabet të përbashkët për gjuhën shqipe, bazuar në shkronjat latine. E tëra kjo ndodhi në nëntor të vitit 1908.

Vite më vonë, Shqipëria shpalli pavarësinë e saj nga Perandoria Osmane, dhe kjo ndodhi në nëntor të vitit 1912, mirëpo disa nga tokat shqiptare u okupuan nga vendet fqinje, Kosova ra nën sundimin serb, Çamëria shqiptare nën sundimin grek. Pas këtyre ngjarjeve, shqiptarët filluan të kuptonin rrethanat politike, dhe kjo me Kongresin e Lushnjës, në vitin 1920. Gjatë këtij kongresi u hodhën themelet e shtetit të Shqipërisë, por pas kësaj periudhe kohore rrethanat politike dhe



shoqërore nuk ishin të qëndrueshme në vend.

Më pas, figura të shquara myslimane shqiptare organizuan konferencën e parë në qytetin e Tiranës, gjatë së cilës u morën disa vendime, përgjatë 24 shkurt - 12 mars, të vitit 1923. Një nga këto vendime ishte krijimi i një grupi të përbërë nga figura të shquara myslimane shqiptare në Shqipëri. Kjo ishte një ngjarje e madhe në historinë e shqiptare, ngase u ndërморën disa vendime, përfshirë botimin e një reviste, nxjerrjen në pah të disa librave fetare, si dhe përkthimin e domethëniesve të Kuranit fisnik në gjuhën shqipe.¹²

Në tetor të vitit 1923, për herë të parë u botua revista mujore "Zani i Naltë", e cila përfshinte tema të fushave të ndryshme si: fetare, patriotike, politike, morale dhe filozofike. Drejtues i kësaj reviste ishte një shqiptar i quajtur Ismail Maçi. Kjo revistë botohej në shtypshkronjën Mbrothësia e cila ishte pronë e Kristo Luarasit që jetonte në Tiranë. Më vonë, kjo revistë u botua në një shtypshkronjë tjetër, të quajtur Ora e Shkodrës, e cila i përkiste vëllezërve Djepaxhia, me qendër në qytetin e Shkodrës.

Botimi i revistës "Zani i Naltë" vazhdoi deri në prill të vitit 1939, kur shteti i Shqipërisë bije nën sundimin italian. Që nga ajo periudhë, kjo

revistë ndryshon emrin e saj në "Kultura Islame". Pavarësisht sundimit italian, vëmë re se aktivitetet e dijetarëve shqiptarë nuk u ndalën, ata botuan disa libra. Ndër këta dijetar shqiptar të cilët u dalluan gjatë asaj periudhe ishin hafëz Ali Korça, hafëz Ibrahim Dalliu, hafëz Abdullah Zemblaku, hafëz Ali Kraja dhe të tjerë.

Nga viti 1945, fillon faza e komunizmit në Shqipëri. Më vonë të gjitha aktivitetet fetare u ndaluan me ligj. Nndodhi kjo nga viti 1967, kohë gjatë së cilës Shqipëria shpallet ligjërisht vendi i parë ateist në botë.

Përpjekjet e dijetarëve shqiptarë më pas vazhduan veprimtarinë fetare dhe atdhetare jashtë vendit. Në mesin e këtyre dijetarëve që u dalluan ishin imam Vehbi Ismaili nga qyteti i Shkodrës, i cili veprroi në Detrioit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, imam Beqir Maloku, nga qyteti i Gjakovës, i cili vepronte në qytetin e Romës, në Itali, imam Mehdi Frashëri, dy djemtë e Mehdiut, Vehbiu dhe Ragibi kishin thënë se babai i tyre kishte kompletuar përkthimin e kuptimeve të Kuranit fisnik, por nuk mundi ta botonte atë.

Edhe në shtetin e Kosovës, rrethanat politike dhe shoqërore ishin shumë të vështira. Shteti i Kosovës kishte rënë nën okupimin serb, që nga tetori i vitit 1912, ku ndaloi gjithçka që lidhej me

shqiptarët dhe gjuhën shqipe. Kjo situatë vazhdoi deri në vitin 1941, kur bashkimi jugosllav u shpërbë nga Gjermania dhe Italia.¹³

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, shteti i Kosovës përsëri bije nën sundimin serb, pikërisht me datën 9 maj të vitit 1945. Mirëpo, me ndihmën e Zotit të Plotfuqishëm, shkollat shqipe që po funksiononin gjatë Luftës së Dytë Botërore ende funksiononin. Zotit Fuqiptotë i takon falënderimi për përpjekjet e hoxhallarëve, mësuesve dhe dashamirëve të vendit. Numri i këtyre shkollave rritej dhe brezat e rinj diplomonin. Shkolla e re fetare "Alauddin" filloi punën e saj, nga viti 1951-1952.

Ashtu siç u bë e qartë nga ato që shpjeguar, këto janë disa nga arsyet kryesore që çuan në vonesën e shqiptarëve në përkthimin e kuptimeve të Kuranit fisnik në gjuhën shqipe.

1. Revista "Ura", revistë kulturore-shkencore për studime orientale, Albania, Tiranë, 2010, fq.72. 2. Naim Frashëri ishte një poet dhe shkrimtar shqiptar. Ai ishte një nga personalitetet më të shquara në Shqipërinë e shekullit XIX, së bashku me dy vëllezërit e tij, Samiun dhe Abdyl Frashërin. Ai vlerësohet gjerësisht si përfaqësuesi i poetëve kombëtar të Shqipërisë, dhe është autor i 22 librave. Shih: https://en.wikipedia.org/wiki/Naim_Frash%C3%ABri, 15/09/2020. 3. Mahmud Hysa, "Alamiada Shqiptare II", Shkup - 2000, fq.39. 4. Dalliu, Hafëz Ibrahim, 'Ajka e Kuptimeve të Kur'ani Kerimit', Tiranë, LILLO - 2005, fq.7. 5. Ilo Mitkë Qafëzezi lindi në vitin 1889, në qytetin e Korçës. Ai ishte nga të parët që përktheu pjesërisht domethëniet e Kuranit të shenjtë në gjuhën shqipe, dhe e quajti atë "Recitimi". Ilo Mitkë Qafëzezi i përkiste besimit krishterë. Ishte në planin e Qafëzezit për të botuar përkthimin e domethëniesve të Kuranit të shenjtë në katër pjesë, por ai mundi të botoi vetëm pjesën e parë, e cila u botua në Rumani, në 1921. Synimi i Qafëzezit ishte t'i afrojtë dy fetë, Islamit dhe Krishterimit të shqiptarët, dhe të eliminoj urrejtjen mes tyre. Shih: Qafëzezi, Ilo Mitkë, 'Qur'ani në gjuhën Shqipe', Romania, botimi 1, pjesa 1, fq.3. 6. Shih: <http://orientalizmi.wordpress.com/2013/02/15/25-vjet-pas-perkthimit-te-pare-te-plote-te-kuranit-ne-gjuhen-shqipe>, 15/09/2020. 7. Zekaj, Ramiz, 'Zhvillimi i Kulturës Islame të Shqiptarët gjatë Shekullit XX', Tiranë, 1997, fq.205. 8. Revista "Zani i Naltë", Tiranë, 1932, no. 7-8, fq.172. 9. Revista "Edukata Islame", Prishtinë, 1985, no.43, fq.10. 10. Zekaj, Ramiz, 'Zhvillimi i kulturës islame të shqiptarët gjatë shekullit XX', p.206. 11. Shih: <http://orientalizmi.wordpress.com/2013/02/15/25-vjet-pas-perkthimit-te-pare-te-plote-te-kuranit-ne-gjuhen-shqipe>, 15/09/2020. 12. Revista "Ura", revistë kulturore-shkencore për studime orientale, fq.73. 13. Revista Ura, p.74.

Hafiza Rejhana Umer

Cilat kaptina nga Kurani duhen lexuar gjatë kohës së depresionit dhe stresit?

Disa kaptina nga Kurani janë në veçanti të vlefshme dhe të rëndësishme për t'u lexuar gjatë periudhës së anksozitetit dhe depresionit, meqë mesazhet dhe rëndësia e tyre mund t'i lehtësojnë dhe mënjanojnë gjendjet e rënda psikike me ndihmën e Zotit.

Jeta e kësaj bote nuk është e mbushur me trëndafila. Si qenie njerëzore shpesh vuajmë nga zemra e thyer, pikëllimi dhe sprovat. Secila prej këtyre situatave mund të na sjell në depresion. Mirëpo, ndonjëherë edhe nuk nevojitet shkak me qenë depresiv, por kur ndodh kjo e kemi obligim të kërkojmë ndihmë. Allahu i Madhërishtëm e ka shpallur Kuranin si udhëzim për llojin njerëzor deri në Ditën e Gjykimit, duke na bërë udhëheqës që mund të na ndihmojnë në gjendjet depresive. Ja disa nga kaptinat e Kuranit që janë posaçërisht të vlefshme dhe të rëndësishme për lexim gjatë periudhës së anksozitetit dhe depresionit, e të cilat me mesazhin dhe rëndësinë e tyre mund t'i lehtësojnë dhe mënjanojnë gjendjet e rënda psikike me lejen e Zotit.

Kaptina El-Inshirah (zemërgjerësia)

Allahu i Madhërishtëm së bashku me kaptinën Ed-Duha (paraditja) e shpalli edhe kaptinën El-Inshirah (zemërgjerësia). Në këtë kaptinë, i Lartësuar i këshillon Muhamedin a.s. për mënjanimin që Allahu ia bëri dhembjes së brendshme dhe pikëllimit, të cilin e ndiente Pejgamberi a.s., për shkak të shpalljes së Kuranit dhe vështirësive me të cilat u

Është këshillë për ne, që gjatë kohës së depresionit të përpiqemi ta mënjanojmë problemin tonë shëndetësor duke u mbështetur dhe përqendruar synimin vetëm te Zoti.

ballafaqua. Allahu i Madhëruar potencon se Ai do t'ia ngrit famën Pejgamberit a.s., e sot, përgjatë tërë rruzullit tokësor nuk kalon asnjë sekondë, e që në ndonjë pjesë të Tokës nuk dëgjohen fjalët e ezanit "Esh-hedu enne Muhameden Resulullah". Në kaptinën El-Inshirah, përmendet që pas çdo vështirësie, sado e rëndë qoftë, vjen lehtësimi dhe ai doemos vjen pas fatkeqësisë. Si këshillë e fundit, i Lartësuar i këshillon Pejgamberin a.s., që kohën e pritjes deri te arritja e lehtësisë ta shkurtojë me ibadet ndaj Zotit, por kjo është edhe këshillë për ne, që gjatë kohës së depresionit të përpi-



qemi ta mënjanojmë problemin tonë shëndetësor duke u mbështetur dhe përqendruar synimin vetëm te Zoti.

Kaptina Jusuf

Njëra prej kaptinave më të hershme, e shpallur te Pejgamberit a.s. është kaptina Jusuf. Nga kjo kaptinë unike mund të nxirren mesazhe të panumërta dhe shumë prej tyre janë të lidhura me tejkalimin e gjendjeve të rënda psikike. Le të mendojmë për mënyrën se si Jakubi a.s. dhe Jusufi a.s. luftuan me dhembjen shpirtërore dhe vuajtjet e kësaj bote dhe si Allahu i Madhërishëm të dy i lartësoi për shkak të durimit të tyre. Kjo kaptinë u shpall edhe si ngushëllim për Pejgamberin a.s., por edhe secilit nga ne mund t'i shërbejë si ilaç për depresion.

Kaptinat El-Isra, El-Kehf, Merjem, Ta Ha dhe El-Enbija

Sahabiu i nderuar, Abdullah ibën Mesudi r.a., në lidhje me kaptinat e përmendura ka thënë: “Këto janë në mesin e kaptinave të para të shpallura dhe këto janë thesari im.” Imam Bejhekiu në komentin e kësaj

Kaptinat Isra, Kehf, Merjem, Ta Ha dhe Enbija përmbajnë shumë rrëfime për pejgamberët, popujt e lashtë e në veçanti për Benu Israilët. Secila prej këtyre rrëfimeve mund të ndihmojë në shërimin e depresionit dhe anksozitetit dhe ndihmojnë që ta ndiejmë fuqinë dhe madhësinë e Allahut të Madhërishëm.

thënie ka thënë: “Ibën Mesudi flet për superioritetin e këtyre kaptinave për shkak se këto përmbajnë rrëfime për pejgamberët dhe popujt e tyre. Këto janë shpallur në fillim të Islamit, në periudhën mekase dhe renditen në pjesët e para të Kuranit që janë lexuar dhe mësuar përmendësh.”

Kaptinat Isra, Kehf, Merjem, Ta Ha dhe Enbija përmbajnë shumë rrëfime për pejgamberët, popujt e lashtë e në veçanti për Benu Israilët. Secila prej këtyre rrëfimeve mund të ndihmojë në shërimin e depresionit dhe anksozitetit dhe ndihmojnë që ta ndiejmë fuqinë dhe madhësinë e Allahut të Madhërishëm.

Kaptina Er-Rrahman (Mëshiruesi)

Kjo kaptinë përmban mbase përshkrimin më të bukur dhe më elokuent të Xhenetit. Krahas kësaj, kjo kaptinë flet edhe për Xhehenemin. Kjo flet për shumë begati që na ka dhuruar Allahu, është qetësi për vesh, ilaç për zemër dhe ushqim për shpirt. Duke falënderuar me imazhet e saj të bukura dhe përshkrimin mahnitës të Xhenetit, si dhe me përmendjen e begative të Zotit tonë, kaptina Er-Rrahman është ilaç madhështor për depresion.

Kaptina En-Nas (njerëzit)

Shpeshherë shkakua kryesor i depresionit është vetëvlerësimi i dobët dhe dyshimi në aftësitë personale. Shumë nga këto gjëra janë të stërmadhuara falë pëshpëritjeve të shejtanit, ndërsa ai është betuar që do të përpiket ta humb çdo njeri në Tokë. Mirëpo, Allahu është më Mëshiruesi ndaj robërve dhe nuk i lë vetëm. Në mesin e kaptinave që janë shpallur si ilaç për cytjet e shejtanit përmendet kaptina En-Nas. Leximi i shpeshtë i kësaj kaptine mund të na ndihmojë që t'i mënjanojmë dyshimet dhe pëshpëritjet e shejtanit, me ndihmën e Zotit, ngase kemi të bëjmë me kaptinën e cila thërret mbrojtjen e Allahut.

Burimi: www.saff.ba

Përktheu dhe përshtati:

Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi



Alexander Bevilacqua¹

Kur Kurani fliste anglisht

Përkthimi më i hershëm i drejtpërdrejtë i librit të shenjtë në gjuhën angleze është një dëshmi e shkathtësisë së përkthyesit të tij.

Kurani dikur në pronësi të Thomas Jefferson dhe i përdorur nga republikani Keith Ellison, D-Minn., myslimani i parë i zgjedhur në Kongres, gjatë betimit të tij në ceremoninë në Kapitol të SHBA, shfaqet në Bibliotekën e Kongresit, 4 janar 2007, në Uashington. (Haraz N. Ghanbari/AP).

Keith Ellison, anëtari i parë mysliman i Kongresit mori detyrën në janar të vitit 2007. Për ceremoninë e tij të betimit, zgjodhi të betohej në Kuran. Kopja që ai përdori që huazuar përkohësisht nga Biblioteka e Kongresit për këtë rast, kopje që dikur i përkiste Thomas Jeffersonit.

Pse Jeffersoni zotëronte një kopje të Kuranit?

Presidenti i tretë ishte i interesuar për Islamin për shumë arsye, siç shpjegon Denise A. Spellberg në librin e saj “Kurani i Thomas Jefferson-it.” Ai, fillimisht ishte në gjendje të lexonte librin e shenjtë të Islamit, duke iu falënderuar një përkthimi të fundit, i pari i drejtpërdrejtë nga arabishtja në anglisht, një kopje të të cilit e bleu si student i juridikut në 1765. Ai përkthim, i një avokati të ri anglez, i quajtur George Sale, do të dëshmonte se kishte një rol të madh në studimin dhe kuptimin perëndimor të Kuranit.

Keith Ellison, anëtari i parë mysliman i Kongresit mori detyrën në janar të vitit 2007. Për ceremoninë e tij të betimit, zgjodhi të betohej në Kuran. Kopja që ai përdori që huazuar përkohësisht nga Biblioteka e Kongresit për këtë rast, kopje që dikur i përkiste Thomas Jeffersonit.

Interesi evropian për Islamin

Shumë kohë para se evropianët të qeverisnin kolonitë myslimane, interesi për Islamin dhe kulturën e tij u rrit në Evropë. Një pjesë e arsyes, ishte politike. Tri perandori myslimane dominuan pjesë të mëdha të Azisë: Osmanët në Anadoll, Mesdhe dhe Arabi; Safavidët në Persi; dhe Mughals në Indi. Këto dinasti myslimane nuk ishin vetëm të fuqishme, por gjithashtu admiro-

heshin për artet dhe kulturën e tyre të rafinuar - muzikën, poezinë, kopshtet, qeramikën dhe tekstilet. Për më tepër, librat në gjuhën arabe ofruan njohuri për shumë fusha, për ata që mësuan gjuhën. Jo vetëm shkencat dhe filozofia, por edhe letërsia arabe tërhoqi përkthyesit evropianë. Kështu, më 1704, një francez përktheu për herë të parë “1001 net”, tregimet e të cilit së shpejti u bënë një literaturë e qëndrueshme evropiane, sikurse në atë arabe.

Mbi të gjitha, feja islame në vetvete dukej një fushë kërkimi, veçanërisht bindëse për një serë studiuesish dhe mendimtarësh evropianë. Si kishin dalë një grusht myslimanësh nga Gadishulli Arabik në shekullin e shtatë për të pushtuar kaq shumë nga bota e njohur? Kjo ishte një nga pyetjet më të mëdha të historisë botërore, për çka u pajtuan si filozofi ilimunist francez Volteri, ashtu edhe historiani anglez Edward Gibbon. Për më tepër, filozofët dhe të krishterët mendimplotë e konsideruan parimin qendror të Islamit: Unitetin e Zotit, më racional se misteri i Trinitetit të krishterë. Kështu, shumë evropianë të ndryshëm i kushtuan rëndësi të veçantë Islamit dhe gjuhës së shpalljes së tij, arabishtes.

Puna e një përkthimi

Në nëntor të vitit 1733, përkthimi i parë i Kuranit nga arabishtja në anglisht u shfaq në Londër, një kopje

të së cilës do ta blinte Jefferson. Përkthyesi i saj, Sale, kishte mësuar arabishten në kohën e tij të lirë dhe nuk kishte vizituar kurrë një vend mysliman (arab folës). Ai dikur shkroi: “Unë jam shumë i ndjeshëm ndaj disavantazheve, si një person që nuk është as vendas, as nuk ka qenë kurrë në vend (të gj arabë), duhet të qëndrojë nën të, duke luajtur kritikun në një gjuhë aq të vështirë sa arabishtja.” Për të përkthyer librin e shenjtë, Sale përdori kryesisht vëllime në bibliotekën e tij, duke përfshirë një përkthim të fundit latin që ishte botuar në kundër reformimi i Romës. Ky Kuran latin, i punuar për përdorimin e misionarëve katolikë, përmbante një mori informacionesh të pa përkthyer më parë.

Sale gjithashtu huazoi një kopje të dorëshkrimit të Kuranit nga Kisha Holandeze në Londër. Libri ishte kopjuar në fund të shekullit XVI në Stamboll, kryeqyteti i Perandorisë Osmane, dhe më 1633, një tregtar holandez ia dhuroi atë kishës së

Ajo që arriti Sale ishte një tekst jashtëzakonisht i rrjedhshëm, elegant dhe i saktë. Ai admiroi bukurinë e Kuranit, por, duke u bërë modest, pohoi “nuk duhet të supozohet se përkthimi vjen deri në dinjitetin e origjinalit”.


Londrës. Ajo u vendos në bibliotekë për gati një shekull, derisa Sale e përdori atë. Ne nuk e dimë pse kjo kopje e veçantë u mor dhe u soll në

Londër, por dihet se kopjet e Kuranit ishin materiale prestigjioze në sytë e Evropës. Libri i shenjtë i Islamit ishte ndoshta libri më i shpeshtë arab i mbledhur, i blerë shpesh nga koleksionistët që nuk mund ta lexonin. Edhe sot, studiuesit perëndimorë konsultohen me ‘Kuranin’ e tij. Historiani Michael Cook e ka quajtur atë ‘një përkthim i vjetër i cili është përdorur shumë mirë.’

Megjithëse Sale nuk e përmendi, ai u mbështet drejtpërdrejt në këtë kopje të veçantë për të realizuar përkthimin e tij, siç zbulova kur ekzaminova dorëshkrimin në Londër më 2012, gjatë kërkimit tim mbi njohuritë evropiane të Islamit në epokën e Iluminizmit. Ky Kuran i Stambollit paraqet disa variante të rralla të fjalëve (temave) të caktuara, të cilat gjithashtu shfaqen në përkthimin e Sale, duke dëshmuar kështu lidhjen me të. Teksti shoqërohet me një koment që ishte ndër më të njohurit në Perandorinë Osmane. Duke e përdorur atë, në përkthimin dhe shënimet e tij, Sale mundi të ofrojë një interpretim që kryesisht pasqyrore kuptimin e zakonshëm osman të Kuranit.

Vetëm një version i mëparshëm anglez ishte shfaqur, më 1649, por ai ishte i bazuar në një përkthim të lirë në frëngjisht dhe, siç e tha Sale, “shtoi një numër gabimesh të reja” në origjinalin e tij francez. Në të kundërt, ajo që arriti Sale ishte një tekst jashtëzakonisht i rrjedhshëm, elegant dhe i saktë. Ai admiroi bukurinë e Kuranit, por, duke u bërë modest, pohoi “nuk duhet të supozohet se përkthimi vjen deri në dinjitetin e origjinalit”. Edhe kështu, proza (poetika) e tij vazhdon të jehojë edhe sot, siç duket qartë në rreshtat e parë të versetit të tij, “vargut të fronit” të famshëm:

“ZOTI! nuk ka Zot tjetër përveç tij; i gjalli, ai që mbijeton: as kotja e as gjumi nuk e kap; atij i përket gjithçka që është në qiell dhe në tokë.”



Një trashëgimi intelektuale

Përkthimi i Sales nuk ishte vetëm një arritje letrare e një kalibri të lartë, por edhe një kontribut në njohuri. Ai përfshiu një parathënie të gjatë në të cilën ai shpjegoi shumë aspekte historike, teologjike dhe rituale të Islamit. Para (përkthimit të) “Kuranit” të tij, informacioni më i mirë për Islamit në dispozicion për anglezët ishte në gjuhën latine.

Përpjekjet e Sales nënvlerësuan nocionet paragykuese që kishin qarkulluar që nga kohët mesjetare

Sale për shembull, rrëfeu jetën e Profetit Muhamed pa përmendur historitë legjendare dhe polemike aq shpesh të treguara në Evropë që nga Mesjeta. Ai punoi në vazhdim të një përpjekjeje të përtërirë evropiane për të mësuar arabisht dhe për të studiuar traditat islame, dhe ai, natyrisht se përfitoi nga puna e paraardhësve të tij. Megjithatë, ai gjithashtu i solli çështjes (lëndës) një aftësi kritike perceptuese. Ky kombinim i njohurive të sakta dhe gatishmërisë për të kuptuar një fe të huaj e bën “Kuranin” e Sales një arritje të jashtëzakonshme, dhe atë të një rëndësie të qëndrueshme.

Në të vërtetë, përkthimi mbeti versioni standard anglez (deri) në mesin e shekullit XX. Kështu, ai ndërmjetësoi njohjen e Kuranit dhe Islamit jo vetëm për bashkëkohësit e Sales, por për shumë breza britanikësh dhe amerikanë. Edhe sot, studiuesit perëndimorë konsultohen me “Kuranin” e tij, veçanërisht për shënimet e tij të bollshme; historiani Michael Cook e ka quajtur atë “një përkthim i vjetër që është përdorur shumë mirë”.

Në epokën tonë, shumë përkthime të Kuranit janë në dispozicion. Nëse shekulli XVIII, pa vetëm një përkthim në anglisht, dhe shekulli XIX, dy, në shekullin XX kishte të paktën 16, gjysma e të cilave u botuan në çerekun e fundit të shekullit. Megjithatë, një perëndimor mesatar di pak për Islamit, pavarësisht takimeve gjithnjë e më shumë

në rritje midis myslimanëve dhe jomyslimanëve, qoftë përmes emigracionit, tregtisë apo turizmit. Njohuria dhe simpatia për shumë popuj të botës, duke përfshirë varietetet e shumta të myslimanëve, nuk kanë ecur sa duhet me udhëtimin ajror, TV satelitor apo lidhjet në internet. Ndoshta historia e George Sale dhe përkthimi i tij i Kuranit – në një kohë tjetër, pa ndihmën e internetit duhet të shërbejë si frymëzim. Popujt perëndimorë kanë studiuar për shekuj Islamit dhe kulturat e tij. Duke përkthyer tekstet e tij më të rëndësishme, ata kanë kërkuar të korrin frytet e shumë traditave letrare dhe intelektuale që ka frymëzuar kjo fe.

(Pikëpamjet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politiken editoriale të Al Jazeera America.)

Biografi e autorit

Alexander Bevilacqua është profesor asistent i historisë në Kolegjin Williams, në Williamstown, Massachusetts. Ai është autor i *The Republic of Arabic Letters: Islam and the European enlightenment* (Cambridge, Mass.: Belknap Press, 2018; me letra 2020), i cili u zgjodh nga *Times Literary Supplement* si Libri i vitit dhe u vlerësua me Herbert Baxter Çmimi Adams nga Shoat Historike Amerikane. Ai është gjithashtu bashkëredaktor me Frederic Clark i “Të menduarit në kohën e kaluar: Tetë biseda (Chicago: University of Chicago Press, 2019)”.

Puna e tij është mbështetur nga një sërë organizatash, duke përfshirë Këshillin Amerikan të Shoqërive të Mësuar, Shoqatën Historike Amerikane dhe Shoqërinë Filozofike Amerikane. Ai ka mbajtur ligjërata në Harvard Society of Fellows, Bibliotekën Huntington, Institutin Warburg dhe në Wissenschaftskolleg në Berlin. Në vitin 2022, ai u bë anëtar i Kluge në Bibliotekën e Kongresit. Projekti i tij më i fundit, i mbështetur nga Instituti Folger, shqyrton racën në oborrin princëror të Brandenburg-Prusisë.

Në shekujt e shtatëmbëdhjetë dhe të tetëmbëdhjetë, një komunitet nismëtar i dijetarëve të krishterë hodhi themelet për kuptimin modern perëndimor të qytetërimit islam. Këta njerëz realizuan përkthimin e parë të saktë të Kuranit në një gjuhë evropiane (George Sale), shënuan degët e arteve dhe shkencave islamike, dhe shkruan historinë myslimane duke përdorur burime arabe. Në *The republic of Arabic letters*, Bevilacqua, rindërton këtë proces, duke zbuluar ndikimin e intelektualëve katolikë dhe protestantë në kuptimin laik të iluminizmit të Islamit dhe traditave të saj të shkruara.

Duke u mbështetur në burimet arabe, angleze, frënge, gjermane, italiane dhe latine, historia e pasur intelektuale e Aleksandrit Bevilacqua rishikon rrugët mendore dhe fizike, që dijetarët e krishterë udhëtuan për të marrë, studiuar dhe kuptuar dorëshkrimet arabe. Dituria që ata gjeneruan ishte thellësisht e borxhit (obligative) për traditat myslimane vendase, veçanërisht ato osmane.

Përfundimisht, përkthimet, shkrimet dhe historitë që botuan arritën në mendje të ndritura, të tillë si Voltaire dhe Edward Gibbon, të cilët jo vetëm që përvetësonin përmbajtjen faktike të këtyre publikimeve, por vazhdonin interpretimet e tyre në strukturën e mendimit të iluminizmit.

Në botimet e tij, Bevilacqua, tregon përpjekjet perëndimore për të mësuar rreth Islamit dhe traditave të saj fetare dhe intelektuale të realizuara, jo nga një agjendë laike, por nga angazhimet shkencore të një grupi të zgjedhur të të krishterëve. Këta autorë hodhën mënjanë pikëpamjet e trashëguara dhe kanë sjellë një kuptim të ri të Islamit në Perëndimin modern.

Përgatiti: Elez Osmani, shkurt 2020, Nju Jork

1. Alexander Bevilacqua ka përfunduar doktoraturën e tij në histori në Universitetin Princeton. Hulumtimi i tij beton shkëmbimet kulturore dhe intelektuale midis të krishterëve dhe myslimanëve para epokës koloniale.

Mr. Driton Arifi

Kompetencat dhe detyrimet e kujdestarëve të vakëfeve

Shikuar në fisnikërinë e misionit të tyre, kujdestarët e vakëfeve, janë njerëz që Zoti i gradoi me një privilegj të veçantë, por në të njëjtën kohë, edhe mbi ta rëndon një barrë goxha e rëndë dhe tejet specifike.

Duke qenë kujdestaria e vakëfeve një mision fisnik, për kryerjen e të cilit kërkohen virtyte të larta, aftësi menaxhuese si dhe një organizim i gjerë institucional, ka kohë që në shoqëritë e ndryshme islame nuk kryhet më nga individët apo të ashtuquajturit persona fizikë.

Këtë detyrë, në disa vende e kanë marrë përsipër gjykatat islame, diku ministrinë e vakëfeve, e diku tjetër bashkësitë e komunitetet fetare islame, siç është rasti në vendet tona ballkanike. Natyrisht se kjo edhe mund të ketë përjashtime, por ky është rendi dominues i sotshëm në shoqëritë myslimane.

Shikuar në fisnikërinë e misionit të tyre, kujdestarët e vakëfeve, janë njerëz që Zoti i gradoi me një privilegj të veçantë, por në të njëjtën kohë, edhe mbi ta rëndon një barrë goxha

e rëndë dhe tejet specifike. Atyre u janë besuar dhe u janë lënë amanet një pjesë e të mirave dhe pasurive më të çmueshme të njerëzve-vakëfet.

Allahu i madhërishtëm për peshën e misionit të ruajtjes së amaneteve, në një ajet kuranor thotë: “Allahu ju urdhëron që t’u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejt mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni.” (En Nisa, 58). E vakëfet, pa asnjë dilemë konsiderohen amanete, dhe ne kemi urdhër hyjnor nga Zoti ynë, që ato t’i shprijmë në vend, meqë si të tilla, ato u janë besuar kujdestarëve të tyre.

Kujdestari i vakëfit, i ashtuquajtur në literaturën juridike islame si: “nadhîr el vakf” ose “el mutevel-lîj”, është ai që kujdeset për ruajtjen e pasurisë së vakëfit, mirëmbajtjen,

zhvillimin si dhe shpërndarjen e të ardhurave të tij, deri te personat fizikë ose juridikë që e meritojnë atë ose që iu është dedikuar atyre nga dhuruesi i vakëfeve.

Detyrimet e kujdestarit të vakëfeve

Shikuar në formën gjeneralë, detyrë primare e kujdestarit të vakëfeve, është që ai të veprojë me vakëfet vetëm ato veprime që është i bindur se do të jenë në dobi të asaj pasurie vakëfnore. Kujdestari, është njeri i autorizuar që të menaxhojë me një pasuri të huaj, andaj duhet që të ketë parasysh gjithnjë hadithin autentik të Muhamedit s.a.v.s. ku ai ka thënë: “Cilitdo njeri (rob) që Allahu ia ka dhënë përgjegjësi mbi dikë (apo diçka), e pastaj ai vdes duke e tradhtuar amanetin karshi atyre që kishte përgjegjësi, Allahu të tillit ia ka ndaluar Xhenetin.”¹

Ky hadith, pos autenticitetit të tij dhe saktësisë së pa kontestuar, veçohet edhe me qartësinë e kuptimisë së tij, dhe si i tillë flet për të gjitha nivelet e përgjegjësisë, pa asnjë përjashtim.

Por, nëse dëshirojmë që të bëjmë specifikimin e detyrave të kujdestarit të vakëfeve, qoftë ai person fizik apo juridik, atëherë të tillat themi se janë:

a) Mirëmbajtja, renovimi dhe përkujdesja ndaj vakëfit që të mos shkatërrohet apo të dëmtohet në tërësi, sa që do të pamundësohej pas-



taj edhe përfitimi prej të ardhurave të tij. Natyrisht se kjo mirëmbajtje e asaj pasurie vakëfnore do të duhej të bëhej me të ardhurat që i sjell po e njëjta pasuri vakëfnore, nëse ajo është e tillë që sjellë të mira materiale.

b) Realizimi i kushtëzimeve dhe kujdesi ndaj destinimeve të vakëflënësit. Madje një rregull i njohur juridik në kapitullin e vakëfeve thotë: “Kushtëzimi i vakëflënësit është sikurse teksti i Ligjvënësit - Zotit të Madhërishtëm.” Megjithatë, ky rregull nuk duhet kuptuar vetëm në anën literale të tij, sepse ai në aspektin esencial ligjor, nuk nënkupton se kushtëzimet e vakëflënësit janë të një vlere juridike në kuptim të obligueshmërisë së veprimit me to, sikurse tekstet e Ligjvënësit. Ky rregull, sipas juristëve islamë, më shumë vihet në funksion në aspekt të domethënies apo kuptimit të tekstualitetit të atyre kushtëzimeve që i ka vënë vakëflënësi. Pra, nëse kushtëzimi-fjalë e vakëflënësit është e specifikuar dhe e detajuar (sikur nëse thotë: unë po e lë vakëf këtë pasuri për imamët e kësaj krahine apo komune), duhet që të ardhurat e tij t’i dedikohen vetëm kategorisë së specifikuar, sepse kjo fjalë nuk përmban mundësinë e interpretimit, meqë ajo në vetvete është specifikuese, ashtu siç nuk do të kishin nevojë për interpretime të ngjashme as tekstet e Ligjvënësit - ajetet e hadithet, por të ishin të kësaj natyre të qarta e specifikuese.² Porse, ka nga kushtëzimet e vëna nga vakëflënësi, që ndonjëherë edhe ndalohet zbatimi i tyre, sikur nëse ai ka kushtëzuar që pasuria e tij vakëfnore nuk bënë të shfrytëzohet brenda 10 viteve fare, ose ka specifikuar që pasuria e tij t’iu dedikohet dikujt që me të kryen vepra të ndaluara sipas Islamit. Të tillat kushtëzime janë pa vlerë dhe pa peshë juridike për kujdestarin e vakëfeve dhe rrjedhimisht nuk zbatohen fare.

Thënë ndryshe, duhet kujdes i veçantë e maksimal për realizimin e atyre dedikimeve e specifikimeve të vakëflënësit, por edhe të jemi

Nëse vakëflënësi ka dedikuar pasurinë e vakëfit për xhami, ose për sponsorizim të nxënësve të dijeve islame, ose ushqim të të varfërve, atëherë të kujdesemi që të ardhurat e vakëfeve të tij të shkojnë në atë që vakëflënësi e ka synuar dhe në atë që ai e ka dedikuar.

vigilentë ndaj kushtëzimeve të tyre e të mos i nëpërkëmbim ato, sepse ne, në të vërtetë jemi ngarkuar me këtë detyrë dhe të tillat na mbesin amanet mbi supet tona. Kështu, nëse vakëflënësi ka dedikuar pasurinë e vakëfit për xhami, ose për sponsorizim të nxënësve të dijeve islame, ose ushqim të të varfërve, atëherë të kujdesemi që të ardhurat e vakëfeve të tij të shkojnë në atë që ai e ka dedikuar. E nëse vakëflënësi nuk ka përcaktuar personat, grupet e targetuara prej tij, ose nuk ka specifikuar institucionet që do të përfitojnë nga vakëflënia e tij, atëherë kujdestari i vakëfit (institucioni gjegjës në këtë rast) është ai që duhet të bëjë shpërndarjen apo distribuimin e të ardhurave të atij vakëfi në atë fushë veprimtari që është më e dobishme për interesin e përgjithshëm të atij komuniteti mysliman. Por, kjo nuk nënkupton asnjëherë që ai mundet të shpërdorojë me pasurinë e vakëfit gjatë asaj shpërndarjeje, e as ta përdorë atë për interesin personal të tij apo të ndonjërit nga individët e tjerë - kujdestarë të atij vakëfi.³

Kushtëzimeve dhe dedikimeve të vakëflënësit nuk iu përmbahet kujdestari i vakëfeve vetëm nëse ato

kanë sugjeruar apo specifikuar diç që bie ndesh me dispozitat fetare islame.

c) Mbrojtja e të drejtave juridike të asaj pasurie vakëfnore në kontestet e ndryshme gjyqësore. Mund të ketë përpjekje të ndonjë personi të papërgjegjshëm që ta përvetësojë ose uzurpojë pasuritë vakëfnore, kështu që kujdestari i pasurisë vakëfnore e ka për detyrë ta mbrojë atë pasuri nga humbja apo asgjësimi. Sigurisht se në shumë shtete, e edhe te ne, në disa periudha të errëta të historisë (sikur ishte sistemi monist) kishte përpjekje tendencioze nga qarqet e sistemeve të atëhershme që të tkurrej pasuria vakëfnore, nëse jo të asgjësohej në tërësi. Ato pasuri shpeshherë u janë marrë me dredhi gjyqësore e politike, e me dokumente të sajura nga duart e institucioneve përgjegjëse e kujdestare të tyre, herë nën pretekstin e nacionalizimit të pronës, e herë për shkak të “interesave të përgjithshme të komunitetit” siç i kanë quajtur ndonjëherë ata justifikimet e tyre të kamufluara.

Sidoqoftë, dhe për cilado arsye të jenë hequr prej dorës së njerëzve të denjë ato pasuri me vlerë, kujdestarët e vakëfeve duhet bërë çmos, e të derdhin mundin maksimal, dhe të lëvizin çdo gurë, në mënyrë që ato pasuri të kthehen në pronësi të titullarëve të tyre të vërtetë. Ky, tek e fundit është një amanet, që mbetet detyrë e çdo brezi kujdestar për t’u realizuar.

Ndërrimi i destinimit të vakëfit, ose transformimi i tij në një pronë a pasuri tjetër

(El Ibdal - El Istibdal)

Si njëra prej çështjeve më të ndjeshme në kapitullin e vakëfeve, respektivisht që bën pjesë të të drejtat e pasurisë vakëfnore, dhe njëherësh hyn edhe te kompetencat e kujdestarit të vakëfeve (nadhir el

vakf), e që shkollarët islamë e kanë diskutuar deri në detajet më të vogla, është edhe çështja e mundësisë ose jo, të ndërrimit të pasurisë së vakëfeve, respektivisht shndërrimit të saj në një pronë apo pasuri tjetër. Këtu është për qëllim shtjellimi juridik i normës së shitjes ose ndërrimit të një pasurie vakëfnore, e që pastaj me ato të holla të blihet një pasuri e ngjashme vakëfnore, në vend të asaj që është shitur.

Pika e parë në këtë rrafsh për të cilën pothuajse janë pajtuar të gjithë dijetarët është se nëse pasuria vakëfnore është objekt i xhamisë, ai nuk lejohet në asnjë rrethanë të ndërrohet me ndonjë pronë tjetër e as të shitet. Madje Imam Ebu Hanifeja dhe nxënësi i tij Ebu Jusufi, mendonin se edhe nëse një xhami shkatërrohet në tërësi nga vjetërsia, ajo e ruan statusin e saj prej xhamie dhe nuk mund t'i ndërrohet destinacioni asnjëherë. Ata shkojnë edhe më larg se kjo dhe theksojnë situatën hipotetike se edhe nëse një xhami ka qenë e ngritur në një vendbanim i cili pastaj është braktisur nga banorët e tij, nuk lejohet që ajo xhami e atij vendbanimi të ndërrohet me asnjë pasuri vakëfnore tjetër, për shkak të shenjtërisë së xhamisë dhe për shkak të mundësisë që ajo prapë të kthehet në vendfalje. Kjo, ngase pas disa viteve do të mund të kthehej prapë dikush prej banorëve në të njëjtin vendbanim. Kjo nënkupton se nëse ajo xhami shkatërrohet, gjithsesi duhet të ndërtohet në të njëjtin vend një xhami tjetër, e jo të destinohet e njëjta tokë për destinime të tjera.⁴ Këtë mendim e kanë shumica absolute e juristëve të katër shkollave juridike islame.

Ndërsa pasuritë e tjera vakëfnore, pos xhamive, në parim dhe rrethana normale, as ato nuk lejohet të shiten e as të transformohen në ndonjë pasuri tjetër nga ajo që e kishte destinuar vakëflënësi. Kjo vlen kështu, sa herë që të njëjtat janë duke sjellë përfitime e dobi solide për komunitetin të cilit i janë dedikuar.

Megjithatë, ka situata e rrethana kur vakëfet humbin edhe vlerën e vet, ose shkatërrohen në tërësi nga vjetërsia apo mungesa e mirëmbajtjes së denjë për to, nëse të tillat kanë qëlluar të jenë objekte a ndërtesa (lokale të destinuar për komercialitet, zejtari, banesa e të ngjashme). Por, mundet që ato pasuri vakëfnore ta humbin vlerën e vet, edhe kur të njëjtat janë parcela toke, apo troje që janë lënë në shërbim të komunitetit.

Në situata të tilla, për të ruajtur dobinë e përgjithshme dhe interesin e myslimanëve, juristët islamë e kanë lejuar shitjen e atyre pasurive vakëfnore, me qëllim që me ato para të blihet po ashtu një vakëf - pasuri tjetër e paluajtshme, e cila do të ishte e barasvlershme ose mundësisht më me vlerë se sa ajo e shitura. Njashtu ata kanë lejuar në situatat e njëjta edhe ndërrimin e këtyre pasurive vakëfnore me ndonjë pasuri tjetër vakëfnore të të njëjtit lloj. E gjithë kjo duhet të bëhet vetëm me kushte dhe kritere specifike. Ato kushte janë:

a) Që pasuria vakëfnore që synohet shitja e saj, të jetë e tillë që nuk sjellë më dobi e as përfitim për komunitetin e dedikuar;

b) Që mos të ketë mundësi renovimi apo mirëmbajtja e asaj pasurie që po shitet apo ndërrohet;

c) Që shitja e saj të mos bëhet me ndonjë çmim më të vogël se sa që është çmimi i tregut për të tillat pasuri;

ç) Që ai i cili e mbikëqyrë këtë shitje e ndërrim të pasurisë vakëfnore, të jetë person i besueshëm në fe, e i denjë për të bërë një akt - marrëveshje të tillë;

d) Që me ato para të blihet një pasuri e paluajtshme gjithashtu si vakëf (tokë, truall, lokale afaristë) e jo pasuri e luajtshme. Pra kurrsesi të mos shndërrohet pasuria vakëfnore e paluajtshme në pasuri të luajtshme (para të holla, ari e argjend a të ngjashme) sepse kjo nuk lejohet.⁵

Këto kritere, në fakt tregojnë kujdesin e lartë të juristëve islamë që pasuritë vakëfnore të mos mbesin rrënoja objektesh të pavlera, apo

thjesht monumente historike, shfrytëzimi i të mirave të të cilave bëhet i pamundur. Në një analizë më të thellë, në vërejmë se këto kritere e kushte, vërejmë se kanë për qëllim që pasurisë vakëfnore t'i ruhet destinimi, të sigurohet përfitimi i pandërprerë prej saj, si dhe të garantohet vazhdimësia e mbijetesa e saj nëpër shumë gjenerata. Kështu, natyrisht se edhe parandalohet çdo lloj trajtimi e menaxhimi jo i dinjitetshëm për një pasuri aq të çmueshme e fisnike, e cila përgjatë shekujve kishte rol esencial në zhvillimin dhe përparimin e shoqërive islame gjithandej nëpër botë.

Duhet vënë theksin se duke vërejtur në disa periudha kohore që në shumë shtete islame kishte nëpërkëmbje të kushteve të transformimit të pasurive vakëfnore, shumë pronarë që lanë pasuritë e tyre vakëfe, e kushtëzuan në aktin e vakëflënies, që ajo pasuri të mos shitet, e as të mos transformohet në ndonjë pasuri tjetër. Kjo bëhej si masë preventive për të mbyllur rrugën e atyre që ishin të shkujdesur ndaj shenjtërisë së pasurisë së vakëfit.⁶

Ndërsa në anën tjetër, kudo që në shoqëritë myslimane shohim vakëfe të rikthyera në destinimin e tyre të parë, apo të tjera të rindërtuara e të rimëkëmbura, konstatojmë se në ato vende dijetarët islamë dhe kujdestarët e vendeve të tilla kanë qenë tejet vigjilentë dhe kanë vepruar konform një të koncepti të mirëfilltë që ata kishin rreth normave juridike islame.

1. Muttefaq alejbi, *Buhariu* (2614), *Muslimi* (1/125).

2. *Ibën Nuxhejm el Hanefij, El Babr Err Rraik Sherh Kenz Ed Dekatik, (5/255), Bot. i dytë, Pa vit dhe vend botimi.* 3. *Dr. Elmaed el Haaddad, Min Fikh El Vakf (fq.324). Bot. i dytë, Islamic Affairs Charitable Activities Departments. Dubai, 2014.* 4. *El Kadij el Kasimij, El Vakf - Bubuh Mubtavar (fq.157), Bot. i parë. Daru el Kutub el Ilmijje, Bejrut, 2001.* 5. *Vehbetu ez Zubejli, El Fikh El Islamij ve Edil-letuhu (10/7672), Bot. i katërt, Daru el Fikr, Damask, 2004.*

6. *Shih. Ibën Abidin, Redd el Muhtar (4/359), Bot. i dytë, Daru el Kutub el Ilmijje, Bejrut, 2002. Pastaj: Muhamed Ebu Zehre, Muhaderat fi el Vakf (fq.160), Bot. i parë, Daru el Fikr el Arabij, Kajro, 1971.*

MSc. Abdullah Klinaku

Të drejtat martesore dhe sistemet juridike te shqiptarët

Institucioni i martesës si dhe të drejtat dhe obligimet e dyanshme që ndërliken me këtë institucion janë ndër pjesët më të rëndësishme të së drejtës familjare. E drejta që rregullon martesën, në të njëjtën kohë paracakton edhe të drejtat dhe obligimet e palëve në martesë. Rëndësia e njohjes së kësaj teme konsiston në definimin e qartë dhe dallimin ndërmjet së drejtës zakonore, shariatit dhe të drejtës laike sa i përket të drejtave dhe obligimeve të qiftit në martesë dhe gjatë saj. Në mungesë të njohurive për sistemet juridike nëpër të cilat ka kaluar e drejta martesore te shqiptarët, shpeshherë e drejta islame akuzohet për cenim të lirive dhe të drejtave të gruas, duke e përzier me të drejtën zakonore apo edhe kanonike. Po ashtu, në mungesë të njohurive shpeshherë cenohen vlerat islame që burojnë nga juridiksioni islam sa i përket kësaj çështje në krahasim me të drejtën laike. Për të pasur një pamje sa më të qartë të pozitës së gruas në martesë te shoqëria jonë, duhet mirëfilli të studiohen sistemet juridike që rregullojnë këtë materie në shoqërinë tonë, si në aspektin material ashtu edhe atë historik.

Sistemet juridike që kanë rregulluar martesën te shqiptarët

Në territoret e banuara nga shqiptarët, marrëdhëniet martesore janë rregulluar për shumë shekuj radhazi, nga normat e së drejtës zakonore, e cila është zbatuar deri vonë te shqiptarët, pastaj kjo materie

është rregulluar sipas së drejtës osmane dhe në fund sipas të drejtës laike.

E drejta zakonore shqiptare

E drejta zakonore shqiptare, si e drejtë e pa shkruar ka rregulluar raportet midis subjekteve para të drejtës së shariatit dhe para të drejtave të tjera të shkruara. E drejta zakonore shqiptare përkufizohet si një e drejtë popullore e pashkruar, e transmetuar brez pas brezi nga tradita gojore që shërben për rregullimin e marrëdhënieve juridike gjatë shekujve në vendin tonë.¹

E drejta zakonore është zbatuar në territoret shqiptare edhe gjatë kohës së Perandorisë Osmane si burim i veçantë për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile, në ato hapësira dhe ndërmjet personave ku nuk arriti të imponohet, në tërësi ose pjesërisht e drejta osmane, për shkak se nuk donin ta respektonin ose nuk

kishin mjaftueshëm dijeni për të drejtën e shkruar osmane.²

KLD në kohën e sundimit osman në Shqipëri, ka pasur vlerë juridike dhe ka qenë i njohur si akt juridik për male të mbi Shkodrës dhe në Dukagjin. Madje ka të dhëna që edhe vetë perandoria kishte ngritur një zyrë në Shkodër e cila merrej me interpretimin e KLD dhe quhej Xhibalin.³

Për rregullimin e marrëdhënieve familjare për popullsinë katolike dhe atë ortodokse, zbatohesh me ndërveprim si e drejta zakonore ashtu dhe normat kanonike të rritit ortodoks⁴ apo katolik⁵ përfshirë edhe kohën gjatë Perandorisë Osmane.

E drejta osmane

Trojet shqiptare ranë nën sundimin definitiv të Perandorisë Osmane në vitin 1455.⁶ Mund të konstatohet saktësisht se Sheriati dhe ligjet osmane së pari u zbatuan në lëmin e së drejtës penale, familjare, sepse pushteti u bëri thirrje popullit shqiptar që për këto çështje të



Gjatë sundimit osman, marrëdhëniet familjare për pjesën më të madhe të popullsisë së besimit fetar mysliman vazhduan të rregulloheshin nga e drejta zakonore, ndërsa e drejta myslimane (Sheriati) u zbatua vetëm për një pjesë të shqiptarëve myslimanë, të cilët banonin në qytete ose në fshatra afër qyteteve.

respektohet e drejta e shariatit dhe ligjet osmane.⁷ Marrëdhëniet juridiko-civile dhe ato familjare si pjesë përbërëse e tyre, në kohën e sundimit osman, në territoret e banuara nga shqiptarët, janë rregulluar mbi bazën e përkatësisë fetare të bashkëshortëve, bazuar në bashkekzistencën e disa rendeve juridike si:

- a) rendit juridik osman, i cili nga ana e tij përbëhet nga sheriati (e drejta zakonore myslimane) dhe e drejta statusore e Perandorisë Osmane;
- b) e drejta zakonore shqiptare; si dhe
- c) e drejta kanonike (kristare) e ritit katolik dhe atij ortodoks.

Përgjithësisht, edhe gjatë sundimit osman, marrëdhëniet familjare për pjesën më të madhe të popullsisë së besimit fetar mysliman vazhduan të rregulloheshin nga e drejta zakonore, ndërsa e drejta myslimane (Sheriati) u zbatua vetëm për një pjesë të shqiptarëve myslimanë, të cilët banonin në qytete ose në fshatra afër qyteteve.⁸

Ndikimin në rregullimin juridik në vendin tonë gjatë periudhës osman kishte Kodi Civil Osman

(Mexhele), të cilët bazat e tyre i kishin nga Sheriati.⁹ Kodi Civil Osman (Mexhele), i cili u nxor pjesë-pjesë, nga viti 1869 deri në vitin 1876, pati rëndësi të madhe, sepse për herë të parë marrëdhëniet juridiko-civile, në Perandorinë Osmane, rregulloheshin nga një kod modern, me orientim perëndimor.¹⁰ Ky kod dhe kanunametë janë zbatuar në Shqipëri, për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile, rrjedhimisht familjare dhe martesore deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil të Mbretërisë Shqiptare, më 1 prill të vitit 1929.

E drejta laike

Në territorin e Shqipërisë të njohur në kufijtë e vitit 1913, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (28 nëntor 1912) deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil të Zogut, marrëdhëniet martesore vazhduan të rregulloheshin mbi bazën e normave të së drejtës zakonore dhe normave fetare, në përputhje me përkatësinë e besimit fetar të secilit bashkëshort.¹¹

Kodi gjeti zbatim të paktë¹² për shkak të ndikimeve të mëdha të së drejtës zakonore dhe normave fetare. Bazuar në kontekstin historik dhe në marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore të shoqërisë shqiptare dhe të kohës së miratimit, duhet vlerësuar fakti që Kodi Civil i Zogut solli përmirësimin e pozitës shoqërore të gruas.¹³

Në legjislacionin laik gjatë kohës së regjimit socialist, martesat dhe marrëdhëniet pasurore të krijuara gjatë martesës ishin të ndikuara nga ideologjia socialiste e komuniste dhe ishin në pajtim me parimet ekonomik-shoqërore të shtetit të ri socialist.¹⁴ Hap i madh në plotësimin e normativës juridike u bë gjatë kohës së demokracisë, me theks të posaçëm me nxjerrjen e Kodit të ri për familjen i Republikës së Shqipërisë nr. 90/62, i datës 08.05.2003.

Sa i përket shqiptarëve të Kosovës, gjendja ka qenë më ndryshe. Kosova në vitin 1912 u ri-okupua nga Serbia. Kështu që dispozitat osmane që u zbatuan shekuj me radhë ua lëshuan

vendin ligjeve, respektivisht dekreteve të shumta të Serbisë së asaj kohe, e cila këto territore i trajtonte si Serbi e vjetër dhe insistoi që legjislacioni ekzistues i mbështetur në Kodin Civil të Mbretërisë serbe të vitit 1844¹⁵ të zbatohet në territorin e Kosovës.

Gjatë periudhës së luftërave ballkanike pas pushtimit të Kosovës nga Austria dhe Bullgaria, secila prej tyre vendosën sistemin e tyre juridik në vendin tonë.¹⁶ Gjatë kësaj periudhe kohore, e deri në luftën e dytë botërore, për shkak të imponimit të sistemeve juridike nga okupatorët, shqiptarët, vijuan që marrëdhëniet e brendshme t'i zgjidhnin në mënyrën tradicionale.¹⁷ E drejta zakonore shërbeu si burim i së drejtës për rregullimin e marrëdhënieve civile – juridike në Kosovë midis dy luftërave botërore,¹⁸ rrjedhimisht edhe burim i së drejtës familjare. Gjatë luftës së dytë botërore, Kosova e okupuar ishte e ndarë nën sundimin gjerman, italian dhe bullgar, të cilët vendosën të drejtën e vet në zonat e administruara në Kosovë, edhe pse respektonin të drejtën ekzistuese, duke u përpjekur që e drejta e imponuar të jetë sa më afërt për popullsinë e Kosovës.¹⁹ Ndërsa pas luftës së dytë botërore, te shqiptarët e Kosovës, akti juridik i cili ka qenë i detyrueshëm të zbatohet në vendin tonë për shkak të statusit politik, e i cili e ka vendos parimin e laicitetit duke mënjanuar ndikimin e organizatave fetare në marrëdhëniet martesore e familjare pas luftës së dytë botërore është Kushtetuta e RFPJ-së, e vitit 1946.²⁰

Rregullimi juridik i institucionit të martesës në Kosovë, ka vazhduar të rregullohet me Ligjin e Martesës dhe Marrëdhënieve Familjare.²¹ Pastaj është nxjerr Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, i botuar në gazetën zyrtare me datën 01.09.2006, përmes së cilës janë shfuqizuar ligjet e mëhershme që kanë rregulluar këtë fushë.

Të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve

E drejta pozitive, kanunore dhe ajo e sheriatit në mënyrën e tyre, secila ka përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve në martesë. Midis tyre vërehen dallime si në të drejta ashtu edhe në obligime. Për aspektin krahasimtar të të drejtave dhe obligimeve do t'ju referohemi dispozitave që dalin nga burimet në të cilat bazohet këto tri të drejta respektive.

Në të drejtën kanunore, organizimi i jetës martesore është kryesisht patriarkal. Madje me ndikim dhe kompetencë monopoliste nga burri. Sipas një dispozite të KLD-së, gruaja shihet si objekt, e cila ka vetëm detyra, ndërsa burri ka vetëm të drejta. Citimi i KLD-së se: burri ka të drejta e gruaja ka detyra. Kjo reflekton rolin e fuqishëm patriarkal të mashkullit ndaj gruas, duke e përcaktuar të parin me të drejta e të dytën vetëm me detyrime. Burri sipas Kanunit ka detyrë me e mësuar dhe me e qortuar gruan kur bën gabime e nuk i shkon për fjalë, e nuk i bënë punët që i përkasin. Kur gruaja ja përbuz fjalën burrit, kur i banë faj e dhunë, burri ka të drejtë me e dënuar gruan. Por, burri s'ka të drejtë me akuzuar punë e pa punë si rob i nxanë. Neni 58 i Kanunit përcakton se: "burri ka tagër, më këshillua e me qortue gruen, me rrahë e me lidhë gruen e vet, kur të mbërrijë me ia përbuzë fjalën e urdhnit."²² Edhe pse sipas këtij neni kjo sjellje e burrit është e kushtëzuar nga sjellja jo e mirë e gruas, prapë se prapë, ky kushtëzim në një sistem të ashpër patriarkal është plotësisht i pa rëndësishëm dhe jo relevant. Megjithatë, KLD i njeh disa obligime që i ka burri ndaj gruas, ku përcakton se: "detyrë e burrit është me u përkujdes për veshmbathje dhe për çdo gjë që është e nevojshme për jetën, me ja ruajta nderin gruas dhe me ja plotësua nevojat që mos të ankohet."²³

Për dallim prej të drejtës kanunore, e drejta islame, detyrimet dhe të drejtat e bashkëshortëve i sheh si obligime të përbashkëta, ndërsa burrit i cakton disa detyrime të posaçme. Pra, të kundërtën e asaj që thotë Kanuni, se burri ka të

drejta e gruaja detyrime. Sipas së drejtës islame burri ndaj gruas ka detyrë: t'i plotësojë plotësisht të drejtat e saj morale dhe materiale, t'ia japë gruas mehrin e plotë, ta mbrojë atë për të jetuar me të në një mënyrë të mirë dhe të rregullt, ta ushqejë, të shpenzojë për veshmbathje, barna, si dhe t'i sigurojë vendbanim dhe gjithçka tjetër që ia kërkon, e që nuk bie ndesh me parimet islame. Burri ka të drejtë dhe obligim me këshillua gruan me fjalë të mira dhe edukuese. Në rast se gruaja është mos mirënjohëse ndaj burrit, atëherë lejohet të marrë masa ndaj saj në pajtim me parimet islame. Sipas shumë juristëve islamë, e drejta islame në organizimin e jetës martesore, nuk ndërtohet mbi konceptin e barazisë midis bashkëshortëve në raport me detyrimet, por mbi konceptin e drejtësisë midis tyre.²⁴

E drejta pozitive ka specifikat e saj në rregullimin e raporteve në kuptim të të drejtave dhe obligimeve që bashkëshortët kanë mes vete. E drejta pozitive është kundër çdo lloj diskriminimi dhe dhune ndaj gruas. Barazinë midis bashkëshortëve e trajton si në kuptim juridik po ashtu edhe në kuptimin moral dhe respektit reciprok. Sipas KFSH-së, martesë përcaktohet: si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit."²⁵ Dispozitat ligjore në fuqi, të cilat rregullojnë çështjen e të drejtave dhe obligimeve të bashkëshortëve janë gjithëpërfshirëse. Ato rregullojnë barazinë ligjore midis bashkëshortëve që nga momenti i lidhjes së martesës, jetës martesore po edhe zgjidhjes së martesës. LFK përcakton se: "mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj."²⁶

Përfundim

Duke ju referuar thirrjeve normative në të cilat bazohen këto të drejta në çështjen e të drejtave dhe detyrimeve

midis bashkëshortëve, ka dallim shumë të theksuar ndërmjet së drejtës kanunore dhe të drejtës islame, madje edhe të drejtës laike. Dallimi konsiston në trajtimin e gruas, pozitës së gruas në familje, rolit të saj, të drejtave që ajo duhet t'i posedojë. Vërehet trajtim tërësisht ndryshe i gruas, burrit dhe relacionit midis tyre. Ndërsa dallimi bazik ndërmjet së drejtës islame dhe asaj pozitive është koncepti i drejtësisë midis bashkëshortëve në relacion me detyrimet dhe koncepti i barazisë midis bashkëshortëve në raport me të drejtat. E drejta islame detyrimet midis bashkëshortëve i trajton përmes konceptit të drejtësisë, ndërsa të drejtat i trajton përmes konceptit të barazisë, gjë që në të drejtën pozitive një dallim i tillë nuk njihet. Madje e drejta islame, për dallim prej të drejtës kanunore dhe asaj laike e mbron dhe ka mekanizma mbrojtës për gruan. Në veçanti në kohën kur gruaja i ekspozohet rrezikut të vazhdueshëm për keqpërdorim vizual dhe familja i ekspozohet rrezikut nga legjitimi i të martesave midis gjinive të njëjta.

Islami në kontekstin aktual si besim dhe vlerë, gruan e avancon, e mbron dhe e ruan nga rreziqet që e kanosin dhe nga tendenca klasike për nënshtrimin e saj.

1. Grup autorësh, "Historia e shteti dhe së drejtës në Shqipëri", vepra e cituar, fq. 229. 2. Aliu A., "E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme", vepra e cituar, fq. 139. 3. Hoxha A., Maksutaj R., "E drejta zakonore shqiptare", Sh.B. "Faik Konica", Prishtinë, 2017, fq. 30. 4. Zaçe V., "Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar", vepra e cituar, fq. 15. 5. Po aty, fq. 16. 6. Aliu A. "E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme", vepra e cituar, fq. 125. 7. Po aty, fq. 134. 8. Zaçe V., "Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar", vepra e cituar, fq. 32-33. 9. Qarri E., "Kontrata martesore – disertacion i doktoratës", Universiteti i Tiranës, 2014, fq. 45. 10. Aliu A. "E drejta Civile. Pjesa e përgjithshme", vepra e cituar, fq. 144-146. 11. Zaçe V., "Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar", vepra e cituar, fq. 224. 12. Zaka, "Regjimet pasurore, jurisprudencë shqiptare dhe disa sisteme krabasuese" fq. 6. 13. Qarri E., "Kontrata martesore", vepra e cituar, fq. 55. 14. Qarri E., "Kontrata martesore", vepra e cituar, fq. 56. 15. Aliu A., "E drejta Civile "Pjesa e përgjithshme", vepra e cituar, fq. 152. 16. Po aty. 17. Po aty, fq. 153. 18. Po aty, fq. 156. 19. Po aty, fq. 162. 20. Ligjërata të autorizuara nga Kolegji AAB në linkun në vijim të qasur me datën 03.12.2018, <https://dspace.aab.edu.net/bitstream/handle/123456789/722/20173110-bd61-4aa4-9ad5-a095d9231870.pdf?sequence=4&isAllowed=y>. 21. Ligjin e Martesës dhe Marrëdhënieve Familjare ("Gaz. zyrt. e KSAK", nr. 10/28 mars 1984), i cili ka filluar të zbatohet nga 1 shtatori 1984 (LMMF). 22. Kamuni i Lekë Dukagjinit, vepra e cituar, fq. 21. 23. Po aty. 24. Ali Es-Sajib Muhamed, "Historia e legjislacionit dhe jurisprudencës islame", Sh.B. "LOGO-A" Shkup, 2013, fq. 30. 25. Kodi i familjes i Republikës së Shqipërisë nr. 90/62, datë: 08.05.2003, Neni 1. 26. LFK, Nr. 2004/32, 2006, neni 14.

LL.M. Argjent Xheladini

Radhët e trashëgimisë sipas Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës

Trashëgimia me ligj, nga një përjashtim sipas ligjit zbatohet vetëm në ato raste kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament ose testamenti është tërësisht apo pjesërisht i pavlefshëm. Në bazë të trashëgimisë ligjore qëndron marrëdhënia familjare ndërmjet trashëgimlënësit dhe trashëgimtarëve, duke përfshirë të afërmit më të ngushtë deri në shkallë të gjashtë, në mungesë të tyre, trashëgimtar bëhet shteti. Në vendin tonë, shumicën e rasteve njerëzit vdesin pa bërë testament, atëherë trashëgimia ligjore përbënë llojin kryesor të trashëgimisë.

Trashëgimia në bazë të ligjit nënkupton trashëgiminë në bazë të fakteve të caktuara, të cilat i parasheh ligji, në rastet kur nga këto fakte nuk ka mundur të vijë deri të trashëgimia në bazë të testamentit.¹

Deri të trashëgimia në bazë të ligjit vjen në rastet kur:

a. kur trashëgimlënësi nuk ka lënë asnjë testament apo kur testamenti është revokuar, apo kur trashëgimlënësi me testament nuk ka përfshirë gjithë pasurinë e tij;

b. kur trashëgimtar i testamentar ka vdekur para trashëgimlënësit.²

1. Rrethi i trashëgimtarëve

Ligji i Trashëgimisë i Kosovës, njeh tri radhë të trashëgimit. Mirëpo, nëse trashëgimlënësi nuk ka trashëgimtar të cilët do të trashëgonin në bazë të ligjit, autoritetet publike, gjegjësisht komuna do të paraqitej si trashëgimtar ligjor i radhës së fundit.

2. Radhët e trashëgimisë

Sipas ligjit, radhët e trashëgimisë janë të përcaktuara varësisht nga shkallët e gjinisë së trashëgimtarëve të mundur ligjorë me trashëgimlënësin. Duhet theksuar se, trashëgimtarët e radhës më të afërt i përjashtojnë nga trashëgimia personat e radhës më të largët.³

a) Radhën e parë të trashëgimisë e përbejnë bashkëshorti dhe pasardhësit e trashëgimlënësit. Pra, trashëgimlënësin para të gjithëve e trashëgojnë bashkëshorti dhe fëmijët e tij,⁴ këta trashëgojnë në pjesë të barabarta.⁵

Në të drejtën trashëgimore, si fëmijë që kanë të drejtë të trashëgojnë konsiderohen fëmijët e lindur në martesë ose jashtë martese, si dhe fëmijët e adoptuar nga trashëgim-

lënësi.⁶ Bashkëshorti mund të trashëgojë trashëgimtarin sipas ligjit të trashëgimisë vetëm në qoftë se martesa është lidhur sipas ligjit, përkatësisht në qoftë se martesa në aspektin juridik është e plotfuqishme.⁷

E drejta e përfaqësimit

Në mungesë të një trashëgimtar, i cili ka vdekur para trashëgimlënësit, deklarohet i padenjë për të trashëguar, heq dorë nga trashëgimia apo përjashtohet nga e drejta për të trashëguar, në vend të tij, në shkallë të njëjtë dhe me të drejta të njëjta futet një trashëgimtar tjetër. Shembull: Trashëgimlënësi Hasani pas vdekjes së tij ka lënë bashkëshorten Yllken, fëmijët Besën, Arbërin, ndërsa fëmija i tretë Arbeni ka vdekur para trashëgimlënësit dhe ka



lënë djalin Drenin. Në këtë rast, bashkëshortja trashëgon $\frac{1}{4}$, Besa $\frac{1}{4}$, Arbëri $\frac{1}{4}$ dhe Dreni me të drejtë të përfaqësimit trashëgon $\frac{1}{4}$ e pasurisë trashëgimore, e cila pasuri do t'i takonte të atit të tij. Kjo e drejtë njihet me emrin e drejta në përfaqësim. Këta persona të cilët zëvendësojnë trashëgimtarin i cili do të duhej të trashëgonte, trashëgojnë në pjesë të barabarta me trashëgimtarët e tjerë.⁸

b 1) Radhën e dytë të trashëgimisë e përbejnë: prindërit dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit. Në këtë rast, trashëgimlënësin i cili nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti pasjetues, i cili zbret nga radha e parë në të dytë dhe trashëgon së bashku me trashëgimtarët e radhës së dytë, por jo më pak se $\frac{1}{2}$ e pasurisë trashëgimore.⁹ Gjysmën e pasurisë e trashëgojnë prindërit në pjesë të barabarta. Në rastet kur trashëgimlënësi nuk lënë pasardhës e as bashkëshortë pasjetues, në pjesë të barabarta me nga $\frac{1}{2}$ e tërë pasurisë së trashëgimlënësit e trashëgojnë prindërit e tij.¹⁰

b 2) Gjithashtu në radhën e dytë të trashëgimisë hyjnë edhe vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre së bashku me bashkëshortin e trashëgimlënësit.¹¹ Një gjë e tillë ndodhë në rastin kur njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën trashëgimore që do t'i takonte atij, e trashëgojnë fëmijët e tij, konkretisht (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), sipas dispozitave të këtij ligji që vlejnjë për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe pasardhësit e tjerë të tij.¹² Në rastin konkretë, duhet pasur parasysh se (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre), trashëgojnë në pjesë të barabarta me prindin tjetër.¹³

b 3) Pjesët trashëgimore të cilat do t'u takonin prindërve të trashëgimlënësit (sikurse të ish-in gjallë), të cilët kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe atë $\frac{1}{2}$ e trashëgojnë pasardhësit e tyre, në rastin konkret vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 15 të LTK, ndërsa pjesën tjetër prej $\frac{1}{2}$ e trashëgon bashkë-

shorti pasjetues, me kusht që trashëgimlënësi të mos ketë lënë pasardhës.

b 4) në rast se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, e nuk ka lënë asnjë pasardhës, pjesën e tij do ta trashëgonte prindi tjetër, e në qoftë se edhe ky ka vdekur para trashëgimlënësit, pasardhësit e tij, të cilët ka mundur t'i ketë nga ndonjë martesë tjetër e tij apo jashtë-martesorë, do të trashëgonin pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'u takonin të dy prindërve.

c) Në radhën e tretë të trashëgimit hyjnë gjyshi dhe gjyshja e trashëgimlënësit. Gjyshi dhe gjyshja e të njëjtit trung trashëgojnë në pjesë të barabarta. Pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit, i cili nuk ka lënë pasardhës, bashkëshort, prindër dhe pasardhës të tyre, e trashëgojnë gjyshërit dhe gjyshet e tij. Gjysmën e pasurisë trashëgimore apo $\frac{1}{2}$, në pjesë të barabarta e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja nga ana e të atit, ndërsa gjysmën tjetër apo $\frac{1}{2}$, të pasurisë trashëgimore, në pjesë të barabarta e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja nga ana e nënës.¹⁴

Është karakteristike për radhën e tretë të trashëgimit se si trashëgimtarë, konkurrojnë në trashëgimi vetëm trashëgimtarët ligjorë të thirrur në trashëgim sipas faktit të gjinisë së gjakut. Kjo nuk ishte karakteristikë për dy radhët e tjera të trashëgimisë, sepse aty konkurronin trashëgimtarë edhe sipas faktit të gjinisë civile (birësimit) edhe sipas faktit të lidhjes së martesës (bashkëshorti).¹⁵

ç) Sipas LTK, si trashëgimtar i radhës së fundit paraqitet Komuna. Pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit i cili nuk ka lënë as trashëgimtar testamentar e as trashëgimtar ligjor, i takon Komunës në të cilin trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin e tij të fundit.¹⁶

Kur Komuna, respektivisht Kosova, e fiton të drejtën për trashëgim, pozita e tyre është thujse e njëjtë me pozitën e trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit, me përjashtim se ato nuk mund të heqin dorë nga e drejta në trashëgimi. Për borxhet e trashëgimlënësit, Komuna, përkatësisht Kosova, kanë të njëjtat

përgjegjësi sikurse edhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë.¹⁷

Konkluzion

Edhe pse në Kosovë ekziston ligji për trashëgiminë që u mundëson qytetarëve ta gëzojnë trashëgiminë e pasurisë familjare, ky ligj në praktikë nuk zbatohet plotësisht, posaçërisht kur bëhet fjalë për femrat. Kjo është traditë më tepër në vendet rurale, si pasojë e traditave të vjetra shqiptare, edhe pse e drejta e trashëgimisë ju takon të gjithë anëtarëve të familjes pa marrë parasysh gjinisë. Edhe pse të barabartë para ligjit, si rezultat i mentalitetit tradicional, shumë gra në Kosovë nuk trashëgojnë pronën që ju takon duke ua lënë mundësinë që këtë ta gëzojnë anëtarët e tjerë të familjes.

Nga ana tjetër, konfliktet gjyqësore po bëhen gjithnjë e më shumë pjesë e pa ndarë dhe e rëndësishme e punës së gjyqtarëve dhe avokatëve, çka tregon edhe për vlerën gjithnjë më të madhe që po merr ky institut i së drejtës në praktikën gjyqësore. Të gjitha këto tregojnë se ky institut dhe marrja e njohurive në këtë fushë është një nga kërkesat më themelore për formimin e juristëve të ardhshëm.

Për të qenë e mundshme që të gjithë të jenë të barabartë në trashëgimi, institucionet shtetërore duhet të respektojnë në maksimum ligjet ekzistuese dhe të ndërmarrin hapat e duhur për parandalimin dhe zhdukjen e malverzimeve nga personat e pa ndërgjegjshëm, si dhe t'i zbatojnë ligjet me paanshmëri dhe përgjegjësi maksimale.

Literatura: Bedri Babirri, Asllan Bilalli, "E drejta trashëgimore", Prishtinë, 2021. Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2015. Hamdi Podvorica, "E drejta trashëgimore", Prishtinë, 2010. Ligji nr. 2004/26, për Trashëgiminë i Kosovës. 1. Hamdi Podvorica, "E drejta trashëgimore", Prishtinë, 2010, fq. 33. 2. Neni 9 i Ligjit Nr. 2004/26, për Trashëgiminë i Kosovës. 3. Neni 11 paragraf. 4 i LTK-së. 4. Neni 12 paragraf. 1 i LTK-së. 5. Neni 12 paragraf. 2 i LTK-së. 6. Bedri Babirri, Asllan Bilalli, "E drejta trashëgimore", Prishtinë, 2021, fq. 84. 7. Ibid. 8. Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq. 464. 9. Neni 14 paragraf. 1 i LTK-së. 10. Neni 14 paragraf. 3 i LTK-së. 11. Neni 15 i LTK-së. 12. Neni 15 paragraf. 1 i LTK-së. 13. Neni 14 paragraf. 2 i LTK-së. 14. Nenet 17-19 të LTK-së. 15. Hamdi Podvorica, op.cit., fq. 58. 16. Neni 21 i LTK-së. 17. Hamdi Podvorica, op.cit., fq. 61.

Arben Desku

“Sodomgjinjtë modernë” – devijimi nga natyrshmëria njerëzore

Shoqëria njerëzore është përballur gjithmonë me prapësia (devijime morale njerëzore), por këto prapësia kanë qenë të një fushe të caktuar dhe në të shumtën e rasteve të izoluar brenda popujve të ndryshëm. Por, sot, është fakt që në shoqërinë e kësaj kohe mund të gjesh të gjitha llojet e prapësive të popujve të mëhershëm, të pakufizuara në popuj të caktuar. Degjenerimi po përhapet anë e kënd, dhe aroma e tij po na mundon të gjithëve. Homoseksualizmi me degët e tij (biseksualizmi, ndërrimi i gjinisë, neutralizmi seksual) janë degjenerimet më madhore që e kanë goditur tashmë ashpër njerëzimin. Ka pak nga grupet e njerëzve që i kundërvihen këtij degjenerimi dhe ata përballen me kundërshtimin që populli i Sodoms i bënte Lutit a.s.: *“Ata thanë: “A nuk të kemi ndaluar që të mos na përzihesh në njerëzit (që ne i mësyjmë)?”* (El-Hixhr, 70)

Shumë nga njerëzit e shoqëritë e tëra i janë nënshtruar këtyre fjalëve të prapa të «Sodomgjinjve». Sado që në brendi e ndjejnë që është diçka tmerrsisht e gabuar, prapë heshtin ose bëhen përkrahës të degjenerimit të tyre në një mënyrë apo tjetrën. Ai që e bën dhe ai që e përkrahë degjenerimin janë të një vije të njëjtë. Heshtja ndaj një devijimi të tillë moral është një lloj pranimit. Ne nuk duhet të heshtim! Ne nuk guxojmë të heshtim kur familja, fëmijët tanë janë të rrezikuar. Këta “Sodomgjinj” sot kërkojnë liri të praktikimit të degjenerimit të tyre publikisht. Nesër

Ata e kamuflojnë prishjen e tyre morale me të drejtën e të qenët i/e lirë në zgjedhje personale, por harrojnë që zgjedhja e tyre nuk është një zgjedhje normale, është një devijim nga natyrshmëria njerëzore. Është tjetërsim.

çfarë do kërkojnë më shumë? Të adaptojnë fëmijë? Kjo nuk guxon të ndodhë. Prandaj duhet ndaluar këtë prishje morale me kohë.

“Sodomgjinjtë” nuk e konsiderojnë gjendjen e tyre sëmundje. Zaten edhe sëmundje nuk mund të quhet, sepse Zoti e arsyeton të sëmurin. Gjendja e tyre nuk është gjë tjetër pos lajthitje morale, prishje dhe degjenerim i skajshëm, dhe si e tillë duhet trajtuar. Ata e kamuflojnë prishjen e tyre morale me të drejtën e të qenët i/e lirë në zgjedhje personale, por harrojnë që zgjedhja e tyre nuk është një zgjedhje normale, është një devijim nga natyrshmëria njerëzore. Është tjetërsim. Është tentim për të qenë gjini që nuk je, dhe që asnjë operacion, veshje, apo makijazh nuk mund ta ndryshoj. Ti je burrë ose grua, i/e tillë ke lindur dhe i/e tillë do vdesësh. Asgjë në botë

nuk mund ta ndryshoj këtë. Dhe si i/e tillë do dalësh para Zotit.

Liria e degjenerimit, do të thotë prishje e normave morale. Degjenerimi nuk është liri. Degjenerimi i dëmton themelet bazë të lirisë. Mos të harrojmë së nga degjenerimi lindin vetëm fatkeqësi (shumica e sëmundjeve seksuale të transmetuara kanë lindur nga homoseksualizmi dhe degët e tij). Dhe askush nuk ka të drejtë ta rrezikoj jetën e shumicës së njerëzve për shkak të obsesioneve të degjeneruara fizike personale. Ata mund të bëjnë ligje. Ne do i refuzojmë ligjet e tyre. Ata do i rrezikojnë fëmijët tanë. Ne do i mbrojmë duke ua mësuar moralin, të drejtën dhe të gabuarën, derisa e gabuara të tretet e të humbet. Sepse e gabuara është e keqe, dhe e keqja nuk mund të triumfojë kurrë mbi të mirën.



Prof.Ass.Dr. Rexhep Suma

Ligjërata si formë e diskursit në dave

Thirrësi kur të mbajë ndonjë ligjëratë nuk duhet të flasë verbërisht, por ai duhet që gjatë ligjëratës së tij të sjellë shembuj emocionues kur i përmend të vërtetat islame dhe konceptet e besimit. Ky veprim emocional duhet të konsolidohet mbi bazën e ringjalljes së emocioneve dhe koncepteve të besimit që ekzistojnë në shpirtin e njeriut.

Secili individ dallon nga tjetri dhe ka specifikat dhe karakteristikat e tij. Mbi këtë fakt, thirrësi duhet ta ndryshoj edhe stilin e ligjërimit në mënyrë që t'iu përshtatet çfarëdo situatë. Misioni i ligjërimit islam ndër mjedisin tonë shqiptar është i një rëndësie jetike. Misioni i ligjërimit islam konsiston në përqendrimin e energjisë islame bashkëkohore për të faktorizuar sistemin e vlerave islame për kurimin e problemeve të shoqërisë shqiptare përmes edukimit të brezit të ri, dhe jo vetëm, me cilësitë e domosdoshme islame dhe humane që e bëjnë këtë brez të denjë dhe të aftë për të realizuar me sukses këtë lloj roli. Pyetja madhore, që duhet t'i përgjigjet veprimtaria islame në mjedisin tonë shqiptar, është: sa është i aftë produkti i kësaj veprimtarie për përmirësimin e gjendjes së shoqërisë shqiptare?! Kjo pyetje mund të shtrohet ndryshe: sa është e aftë veprimtaria islame për t'i shpëtuar fenomenit të “akuariumit brenda në oqean” dhe për t'u shndërruar në një shiringë që injekton produktin e saj brenda në damarë të shoqërisë, si një ilaç të aftë për të kuruar ashtu siç duhet sëmundjet e kësaj shoqërie?! Për të pasur një produkt të tillë, duhet domosdoshmërisht, të ngrihet në nivelin e sfidës dhe qëllimit vetë procesi prodhues i këtij produkti, që është mënyra e prezantimit të Islamit, pra veprimtaria islame.¹

Me ligjëratë shpjegohen tema shkencore-fetare të veçanta në mënyrë të hollësishme dhe duke përmendur gjithë atë që është thënë dhe thuhet për atë tematikë se cila janë mendimet e sakta për atë tematikë. Ligjërata e suksesshme është ajo që synon një cak të caktuar dhe ky synim del në shesh kur bëhet shpjegimi i qartë dhe bindës. Ligjëruesi duhet të jetë i përpiktë në atë që flet, të mos flasë verbërisht dhe të mos përdorë shumë shprehje emocionale, ngase këto shprehje parimisht i takojnë fushës së hytbes, e nuk janë pjesë thelbësore të ligjëratës.

Tjetra është se dëgjuesit duhet t'i bashkëngjiten ligjëruesit në atë se çfarë synon ai, ligjëruesi duhet t'ua

shpjegojë rezultatet që i ka arritur gjatë gjurmimit të tij dhe po që se ky arrin t'i bindë ata në atë që ua shpjegon, atëherë arritja e dëgjueseve deri të rezultati do të jetë e lehtë. Po ashtu, ligjëruesi e ka për obligim dhe duhet të ofrojë një lloj hyrjeje se çfarë synon të arrijë duke i shpjeguar çështjet e njohura në mënyrë të qartë dhe të largohet prej çështjeve që janë shumë të detajuara dhe konfuze dhe për të cilat ka mospajtime apo janë çështje që kanë nevojë për t'u vërtetuar si çështje, të tilla janë çështjet e njohura filozofike. Kur ligjëruesi dëshiron të prezantojë ndonjë të vërtetë të fesë se a ka të bëjë me bazat e koncepteve të besimit islam, si p.sh. ringjallja pas vdekjes,



në këtë rast është e mjaftueshme që t'ua tërheqë vëmendjen e atyre për ato gjëra që ne i dëshmojmë me sytë tonë në raste të vdekjes dhe ringjalljes në botën shtazore e bimore dhe që të ofrohen shembuj nga fusha e tillë me qëllim që e vërteta për ringjalljen të jetë më afër mendjeve. Këtë mënyrë të shpjegimit e ka ofruar vetë Kurani fisnik: “Nga argumentet e Tij është edhe toka që ti e sheh atë të thatë (shkretëtirë), e kur Ne ia lëshojmë asaj shiun, ajo gjallërohet e shtohet. E s'ka dyshim se Ai që e ngjalli atë do t'i ngjallë të vdekurit sepse Ai ka mundet për çdo gjë.” (Fussilet, 39).

Jeta pas vdekjes është një çështje e dëshmuar konkretisht, toka pasi thahet dhe nuk mbin asgjë prej saj dhe më nuk ka jetë në të, Allahu e zbret shiun dhe më pas ajo fillon të gjallërohet e të shtohet me bimë e ushqime të llojllojshme. Prandaj, Allahu, i Cili e ngjall tokën pasi ajo thahet, Ai është që u jep jetë të vdekurve, pasi që i ka krijuar ata prej një pike sperme e që ne e dëshmojmë me sytë tanë, andaj rikthimi dihet se është më i lehtë se krijimi prej fillimit. Allahu i Lartësuar ka thënë: “Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur? Thuaj: I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim.” (Jasin, 78-79).

Pra, thirrësi kur të mbajë ligjëratën, nuk duhet të flasë verbërisht, por ai duhet që gjatë ligjëratës së tij të sjellë shembuj emocionues kur i përmend të vërtetat islame dhe konceptet e besimit. Ky veprim emocional duhet të konsolidohet mbi bazën e ringjalljes së emocioneve dhe koncepteve të besimit që ekzistojnë në shpirtin e njeriut.²

Duke u mbështetur në faktin se njerëzit dallojnë në formën e kuptimit dhe ligjërimit të teksteve, qenësorë në formimin e personalitetit të thirrësit është të ketë formën e ligjërimit të atillë që



të jetë i këndshëm dhe jo i bezdisshëm për të gjithë audiencën. Në vijim do të paraqesim mënyrat dhe format e ligjërimit.

Mënyra e parë - Ligjërimit i pandërprerë

Kjo do të thotë që thirrësi të mbajë një fjalim të pashkëputur dhe të mos ketë ndërhyrje të njerëzve, qoftë me pyetje apo me argumente. Kjo praktikë zbatohet ditën e xhuma gjatë hytbes dhe është e përshtatshme kur mbahen ligjërime publike.

Mënyra e dytë - Bashkëbisedimi, pyetje-përgjigje

Kjo do të thotë që thirrësi të zhvillojë dialog me njerëzit nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve, për të mbërritur aty ku do.

Mënyra e tretë - Prezantimi i një problemi

Në këtë rast, thirrësi paraqet një problem dijeje para nxënësve, për të marrë përgjigje për zgjidhjen e saj. Qëllimi nëpërmjet kësaj është të bëhen pjesëmarrës edhe të tjerët dhe të vihen në lëvizje bashkë me predikuesin. Dy mënyrat e fundit janë më të përshtatshme nëpërmjet mesimdhënie, madje ndonjëherë edhe në ligjëratë e këshilla të ndryshme, me përjashtim të hytbes së xhumasë. Nëse thirrësi arrin të manovrojë mirë në këto dy mënyra, mund të vërë në lëvizje bashkëbiseduesit dhe ta largojë prej tyre mëzinë e lodhjen. Nuk është aspak

e mençur që thirrësi të përdorë vetëm një mënyrë dhe një stil komunikimi, duke mos iu larguar e hequr dorë prej saj. Kjo gjë i shtyn njerëzit të lodhen, të mërziten dhe të mos aktivizohen. Kështu, edhe informacioni nuk memorizohet dhe të kuptuarit mbetet i paktë.

Një xhami diku në një zonë industriale kishte një xhema, i cili nuk ulej të dëgjonte këshillat dhe mësimet. Njëherë një thirrës filloi duke thënë: “Nëse bashkia fillon të ndajë tokat në filan vend, si do t'i ndajë ato?!” Të gjithë u ulën të dëgjonin, madje edhe ata që dolën, u kthyen për të dëgjuar.! Të gjithë u përqendruan te thirrësi se çfarë po thoshte. Pasi ra qetësia tek të pranishmit, thirrësi tha: “Bashkia qenka më e rëndësishme për ne sesa Allahu dhe i dërguari Tij..?! Tokat e kësaj bote kalimtare qenkan më të shtrenjta sesa toka e Xhenetit?!” Pas kësaj here, kur ai fliste, ata nuk ngriheshin më.

Shembuj të larmisë së ligjërimit në Kuran dhe Sunet

Ai që lexon Kuranin, e sheh qartë dhe shpesh këtë kalim, diçka rreth saj e kemi përmendur edhe më parë. Po kështu edhe në traditën profetike gjejmë të Dërguarin e Allahut t'i përdorë të tria mënyrat që përmendëm. Nganjëherë stilin e tij e gjejmë në trajtën e një ligjërimit frikësues, sikur ai të lajmëron për armikun që

Natyra njerëzore është gatuar e tillë, që nëse dëgjon një ligjërim të zgjatur, të mërzitet, të bezdiset, të humbasë vëmendjen nëse tema për të cilën flitet, degëzohet shumë

ndodhet pas portës. Xhabir bin Abdullahi ka thënë: “Kur i Dërguari i Allahut mbante hytbe, i skuqeshin sytë, ngrinte zërin dhe nxehej mjaft, sikur të ishte duke urdhëruar një ushtri. Ai thoshte: “U gdhi këtu te ju, u ngrys këtu te ju.” (ka për qëllim që armiku mbërriti në të gdhirë ose në të ngrysur (sqarim) dhe thoshte: “Unë jam dërguar me Kiametin, kështu si këto të dyja” dhe bashkonte gishtin tregues me atë të mesit.”³

Një nga gjërat më interesante që vëmë re në komunikimin e Profetit a.s., është edhe përdorimi i asaj që sot në pedagogji quhet si ngacmimi i një problemi dhe më pas aktivizimi i nxënësve për zgjidhjen e tij. Njëherë Profeti a.s. u tha shokëve të tij: “Do të hyjnë në Xhenet prej ymetit tim një grup prej shtatëdhjetëmijë vetash, pa llogari dhe pa ndëshkim...” Pastaj hyri në shtëpinë e tij dhe nuk u shpjegoi se cilët ishin ata. Pa dyshim që një mënyrë e tillë komunikimi krijon një ngacmim të madh në mendjen e nxënësve, të cilët presin me padurim të dinë se kush janë këta shtatëdhjetëmijë veta, që edhe ata të jenë prej tyre. Kjo mënyrë, tërheq vëmendjen, vë në punë mendimin dhe bën që informacioni të ruhet më mirë. Kjo mënyrë është më



efektive dhe më mbresëlënëse se sa t'u thuhej: ata janë këta e ata. Për këtë, edhe nxënësit, që në këtë rast ishin shokët e Profetit, u vunë në lëvizje për ta zgjidhur... Dikush tha: Ata jemi ne, të cilët i besuam Allahut dhe ndoqëm të Dërguarin e Tij. Të tjerë thanë: Ata janë fëmijët tanë, të cilët kanë lindur në Islam. Thanë ...dhe thanë...Profeti a.s. e mori vesh, doli nga shtëpia dhe tha: “Janë ata, të cilët nuk kërkojnë rukje, nuk ndikohen nga oguret, nuk mjekohen duke u djegur dhe i janë mbështetur Zotit të tyre.”⁴

Edhe në pyetjen që Profeti a.s. drejtoi për pemën që i shëmbëllente myslimanit, në hadithin e mëparshëm, përdoret metoda e ngacmimit dhe pyetje-përgjigjes. Tradita profetike është e mbushur me të tilla mënyra mësimdhënëse, predikuese dhe edukuese. Sa nevojë kemi sot për to.⁵ Po ashtu, me rëndësi mbetet që gjatë ligjërimit hyn edhe mos zgjatja e ligjërimit, mos përsëritja e fjalëve dhe mendimeve dhe mos përdorimi qëllimisht i rimës. Natyra njerëzore është gatuar e tillë, që nëse dëgjon një ligjërim të zgjatur, të mërzitet, të bezdiset, të humbasë vëmendjen nëse tema për të cilën flitet, degëzohet shumë, ta urrejë sforcon, dhe shpërndarjen në të folur. Për këtë, ligjërimi i thirrësit duhet të mos jetë i gjatë, i mërzitshëm, i sforcuar dhe i padurueshëm, sepse i bën të lodhen dëgjuesit dhe të jenë të padëshiruar. Natyrisht kjo është humbje për të gjithë, në kohë dhe në energji.

Të zgjatësh në të folur, diçka që kuptohet, masa e saj varet nga

nevoja që kanë njerëzit dhe se sa ata mbajnë.

Përsëritja e ideve, përsëritja e panevojshme e asaj që është thënë, me fjalë të tepërta. Ndërsa patosi dhe pompoziteti, të folurit me zjarr dhe madhështi, të sforcuarit për të thënë fjalë të mëdha, për të treguar oratori dhe për t'u dukur para njerëzve si elokuent që flet bukur.

Rima, përputhja e fjalëve me rrokje të njëjta si në një vjershë ose përputhje e plotë e rrokjeve të fundit të dy a më shumë vargjeve, duke filluar nga zanorja e theksuar.

Qëndrimi i traditës profetike ndaj këtyre gjërave është se i Dërguari i Allahut a.s. i ka ndaluar të gjitha këto, si zgjatjen, pompozitetin..., por i pëlqenin fjalët përmbledhëse. Ai thoshte: “...Më janë dhuruar fjalët e përmbledhura...”

Kjo do të thotë se fliste me pak fjalë të goditura, të shprehura mirë dhe që përmbanin kuptime të gjera. Një fjalë e urtë arabe thotë: “Fjalët më të mira janë ato të paktat dhe të saktat, ato që nuk zgjaten dhe nuk të bezdisin.” Një thirrës i mençur është ai që flet pak dhe lë gjurmë të thella në mendjet e njerëzve. Profeti a.s. ka thënë: “Namazi i gjatë i një njeriu dhe shkurtimi i hytbes është tregues i mençurisë së të kuptuarit të tij.”⁶

1. Sabahudin Jashari, *Hartë e ligjërimit islam bashkëkohor tek shqiptarët, Ardhmëria, botim i parë, Tiranë, 2020, f.38.* 2. Abdulkërim Zejdani, *Usulu-d-ave, Muesesetu errisale, botimi i IX, Bejrut, 1999, f.576-567.* 3. Sahihul Buhari 11/ 347 bashkë me “Çeljen e Krijuesit”. 4. Buhariu, 5705. 5. Adnan al Araur, *Menhesh ed-dave fi dev'i el vaki el muasir, Traditua, Tiranë, 2009, f.223-224.* 6. Muslimi, 869.

Bajram Zeqiri

Lutje të veçanta të Pejgamberit a.s.

“E kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet...” (El-Bekare, 186)

“Më thirrni Mua,
Unë do t’ju
përgjigjem”

Po që se e shqyrtojmë me vëmendje çështjen e lutjes, na duket se ajo nuk është më shumë se një kërkesë e të paafitit për ndihmë nga i afti. Në fakt, lutja është të treguarit e dobësisë, nevojës dhe përlësisë nga ana e robit të varfër, i cili nuk mund t’i ndihmojë vetes dhe të kërkuarit e tij ndihmë nga Allahu i Madhëruar, i Cili është në gjendje t’i ofrojë gjithçka që është e dobishme dhe t’ia largojë çdo gjë që është e dëmshme.¹ Për këtë, Zoti ka thënë: “Zoti juaj ka thënë: “Më thirrni mua, Unë do t’ju përgjigjem.” (Gafir, 60).

Nga bujaria dhe mëshira e pasur e Allahut, Ai kërkoi nga ne që t’i lutemi Atij, ngase ne jemi nevojtarë dhe të varfër kundrejt Allahut: “O njerëz! Ju jeni të varfër dhe nevojtarë për Allahun, kurse Allahu është i Pasuri që s’ka nevojë

**Allahu me
mëshirën e Vet
edhe kërkesat e
robërve të Tij dhe
kryerjen e tyre i ka
shndërruar në
ibadet.**

për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd.” (Fatir, 15).

Edhe vetë Pejgamberi ynë i dashur në një hadith ka thënë: “Nuk ka gjë më të vlefshme tek Allahu sesa duaja.”²

Allahu xh.sh. na ka mësuar përmes Kuranit që t’i bëjmë lutje Atij gjithmonë dhe pa u ndalur, mëngjes e mbrëmje, ditën dhe natën, duke qenë në shtëpi dhe në udhëtim, duke qenë në shëndosh e i sëmur, duke qenë në gjendje rehatie e në vështirësi etj..

Allahu i Madhëruar do që robërit e Tij t’i mbulojë me të mira, por

njëkohësisht Ai kërkon nga ta, që të jenë të përlurur ndaj Tij dhe që kërkesat e tyre t’ia paraqesin vetëm Atij, madje jo vetëm që ka urdhëruar t’i kërkojmë Atij, por në rastin kur nuk dëshirojmë t’i kërkojmë, na ka qortuar ashpër, duke e quajtur këtë edhe një mendjemadhësi. Në këtë kontekst, transmetohet nga Ebu Hurejra r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Allahu zemërohet me atë që nuk kërkon asgjë prej Tij.”³

Lutja është litari që e bashkon robin me Zotin e Tij, por përkundër kësaj, shumë njerëz, ashtu siç e përshkruan Kurani nuk e ndiejnë nevojën për t’u lutur, përveç në rastet kur gjenden në vështirësi: “Kur hipin në anije, ata i luten Allahut me devotshmëri të sinqertë.” (El-Ankebut, 65). Allahu me mëshirën e Vet edhe kërkesat e robërve të Tij dhe kryerjen e tyre i ka shndërruar në ibadet. Sa i përket shndërrimit të lutjeve në ibadet, duhet ta kuptojmë një gjë se ibadeti nuk kuptohet vetëm me namaz, ndonëse ai e përfshinë atë. Namazi dhe lutja janë ibadet.⁴ Pejgamberi a.s. ka thënë: “Duaja është ibadet.”⁵

Duke qenë duaja një ibadet në vete, njeriu atë mund ta bëjë në çdo kohë dhe në çdo vend, por janë disa kohë të rekomanduara kur kërkohet nga ne që të bëjmë dua e ato janë:⁶ ka edhe kohën në ifar, kur njeriu është agjërueshëm, në Natën e Kadrit, në mes ezanit dhe ikametit, në natën e xhuma, në pjesën e tretë të natës, herët në agim etj..



Lutu me zemër e i bindur në pranimin prej Allahut xh.sh.

Lutja në Islam zë një vend tejet të rëndësishëm në jetën e besimtarëve. Ajo konsiderohet si një nga ibadetet më të rëndësishme, ngase shfaq nevojën e njeriut për Zotin e Tij. Sikundër që çdo ibadet kërkon rregullat që kanë të bëjnë me të, edhe lutja njashtu ka disa kushte dhe rregulla, në mënyrë që ajo të plotësohet dhe të mos refuzohet.⁷

Nijeti i mirë – çdo punë vlerësohet sipas nijetit/qëllimit. Omer ibën Hatabi transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Veprat shpërblehen sipas qëllimit.”⁸ Besimtari me lutjen e tij duhet të ketë për qëllim adhurimin e Allahut.

Të lutemi sa më shumë

Lutja është ibadet, andaj besimtari duhet të lutet sa më shumë, ngase kjo konsiderohet ibadeti më i ndershëm dhe më i vërteti. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk ka gjë më të ndershme tek Allahu se lutja.”⁹

Lutja të bëhet me duar të ngritura lart. Ashtu si për çdo ibadet, edhe për lutjen kërkohet nga ne që të jemi të pastër. Pejgamberi a.s. na ka mësuar që kur të lutemi t'i ngremë duart lart me ngritjen e brendësisë së tyre. Ai ka thënë: “Kur t'i luteni Allahut, atëherë lutuni me brendinë e shuplakave, e mos e luteni me të jashtmen e tyre.”¹⁰

Fillo me falënderim të Allahut e me salavate për Pejgamberin a.s.

Çdo besimtar lutjen e tij duhet ta fillojë me falënderimin dhe madhërimin e Allahut. Në Ditën e Gjykimit, i Dërguari i Allahut do të bie në sexhde pranë Arshit të Allahut dhe do ta falënderojë Allahun e Madhëruar me lavdërimin më të madh, derisa Allahu do t'i thotë: “O Muhamed! Çoje kokën tënde dhe fol se do të dëgjohesh, kërko se do të jepet, ndërmjetëso se do të pranohet ndërmjetësimi.”¹¹ Ndër shkaqet e refuzimit të lutjes është edhe shpër-

fillja e salavateve për Pejgamberin a.s.: “Çdo lutje anashkalohet pa dërgimin e salavateve për të Dërguarin a.s.”¹²

Lutja të bëhet me zemër, me vendosmëri dhe me bindje në pranimin e saj

Njeriu, lutjen e tij duhet ta shoqërojë me zemër dhe me mendje, e të mos lutet vetëm me gjuhë. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Lutuni Allahut duke qenë të bindur në pranimin e lutjes dhe dijeni se Allahu nuk i përgjigjet lutjes që del nga zemra e shkujdesur.”¹³ Përveç pranisë së mendjes dhe zemrës në lutje, besimtari duhet të ketë vendosmëri dhe mos të dyshojë në lutjen e tij, sepse për këtë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Askush të mos thotë: “O Zoti im, falmë mua nëse do: o Zoti im, më mëshiro mua nëse do: o Zoti im, më furnizo mua nëse do! Por, le të jetë i vendosur në lutjen dhe kërkesën, sepse Ai bën çfarë të dojë, Atë nuk ka kush që e detyron.”¹⁴ Zoti në Kuranin fisnik ka thënë: “Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, (thuaju) Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së lutësit, kur ai më lutet.” (El-Bekare, 186), ky duhet të jetë motivi ynë dhe bindja jonë e pa luhatur për përgjigjen e Zotit për lutjet tona, ngase ne jemi të bindur se Allahu i Madhërisëm nuk e thyen premtimin e tij.

Mos të lutemi kundër vetes, familjes, për gjynahe dhe për ndonjë fatkeqësi – s'ka dyshim se lutjet e tilla janë të refuzuara.

Njeriu duhet të ketë kujdes nga lutja për të keqen ose për gjynahun, sepse shpeshherë kur njeriu është i zemëruar mund të bëjë dua, e që mund të jetë momenti kur edhe pranohet duaja. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mos bëni lutje kundër vetvetes, kundër fëmijëve tuaj dhe mos bëni lutje kundër pasurisë, se ndoshta bëni lutje në kohën kur prej Allahut kërkohen gjërat, e Ai u përgjigjet atyre.”

Lutja me emrin madhështor të Allahut

Pejgamberi a.s. e dëgjoi një njeri duke thënë: “O Zoti im! Të lutem me atë që Ti je Allahu, i Vetmi, Një dhe Ai, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim, Ti je që nuk lind e as ke lindur dhe askush nuk është i barabartë me ty.” Atëherë, i Dërguari a.s. tha: “E ka lutur Allahun me emrin e Tij më të madh, që nëse me të i kërkohet, Ai jep, e nëse i lutet Ai i përgjigjet (lutjes).”¹⁵

Kërkimi i të shumtës dhe lutja gjithëpërfshirëse

Pejgamberi a.s. na ka mësuar që kur të kërkohet të kërkohet të shumtën. Ai ka thënë: “Kur dikush



“Çdo peygamber ka pasur një dua të veçantë e të plotësuar (nga Allahu), të cilën ai e thoshte. Unë dua ta ruaj duanë time për të ndërmjetësuar për pasuesit e mi në jetën e pastajme.”

(Peygamberi a.s.)

nga ju kërkon nga Allahu, le të kërkojë shumë, sepse Ai është duke i kërkuar Zotit të tij.”¹⁶ Lutjet tona duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe në pajtueshmëri të plotë me thëniet e Peygamberit a.s., si dhe duhet t'i përfshijnë të mirat e dynjasë dhe të Ahiretit.

Largimi nga gjërat që e pengojnë lutjen

Janë disa gjëra të cilat e pengojnë pranimin e lutjes, siç i cekëm edhe më lartë, e për të cilat: “I Dërguari a.s. e përmend personin që kishte marrë rrugë të gjatë, i pakrehur, që i kishte shtrirë duart lart në qiell, (duke thënë): O Zot! O Zot! Ndërsa ushqimi i tij ishte haram, pija e tij ishte haram, veshmbathja haram, po edhe të ushqyerit e tij haram, e si pra t'i përgjigjet atij?”¹⁷

Lutjet e veçanta të peygamberëve

Që të gjithë peygamberët, përveç Muhamedit a.s., i cili u dërgua i dërguar për të gjithë njerëzit “Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Sebe, 28), ishin të dërguar për një popull dhe

për një kohë dhe vend të caktuar. Pavarësisht faktit se ishin të zgjedhurit e Zotit, ata shpeshherë i janë drejtuar Atij me lutje e dua për nevojat e tyre. Transmeton Ebu Hurejra r.a., se Peygamberi a.s. ka thënë: “Çdo peygamber ka pasur një dua të veçantë e të plotësuar (nga Allahu), të cilën ai e thoshte. Unë dua ta ruaj duanë time për të ndërmjetësuar për pasuesit e mi në jetën e pastajme.”¹⁸

Në Kuranin fisnik janë përmendur disa nga peygamberët, të cilët në kohë të caktuara i qenë drejtuar Allahut me lutje. Për gabimin që kishin bërë, Ademi a.s. së bashku me gruan e tij iu drejtuan Allahut me lutjen: “O Zoti ynë, thanë ata, ne i kemi bërë dëm vetvetes, prandaj nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi të humbur.” (El-Araf, 23).

Populli i Nuhut a.s., kishte kundërshtuar gjatë thirrjen që Nuhu ua kishte bërë atyre për besimin në Zotin Një. Ndonëse thirrja e tij hasi në vesh të shurdhër, ai prapëseprapë, me një rast i qe lutur Zotit: “Dhe Nuhu tha: Zoti im, më fal mua dhe prindërit e mu, dhe ata që hynë në shtëpinë time duke qenë besimtarë, fali edhe besimtarët e besimtarët...” (Nuh, 28).

Edhe pse prindi i Ibrahimit a.s. qe thëlluar aq shumë në adhurimin e idhujve, ai, asnjëherë nuk e ndërpreu lutjen për udhëzimin e tij, ngase respekti dhe dashuria për prindin qe mbjellë në zemrën e tij. Ai ishte lutur: “... O Zoti im, më bëj mua, e edhe pasardhësit e mi nga ata që e falin namazin, dhe pranoje lutjen time, o Zoti ynë! Zoti ynë, më fal mua, edhe prindërit e mi, fali edhe gjithë besimtarët ditën kur jepet llogaria.” (Ibrahim, 40-41).

Për shkak të mërziisë dhe pikëllimit të madh që ndjente për të birin e tij, Jusufin a.s., Jakubi a.s. i ishte lutur Zotit kështu: “Jakubi tha: “Unë, hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut...” (Jusuf, 86). Ndërkaq, i biri i tij, Jusufi a.s. qe lutur gjithnjë me këtë dua: “Krijues i qiejve e i tokës, Ti je kujdestari im në

dynja dhe Ahiret, andaj më bëj të vdes mysli man dhe më bashko me të mirët.” (Jusuf, 101).

Sinonimi i durimit nga peygamberët e Allahut, Ejubi a.s. lutej kështu: “... Mua, vërtet, më zuri belaja, e Ti o Zot je më Mëshiruesi i mëshiruesve.” (El-Enbija, 83). Lutja e Musait a.s. që t'i zgjerohej kraharori dhe t'iu lehtësoheshin punët dhe që t'i shtohesh përkrahja, duke ia bërë edhe vëllain e tij peygamber, qe pranuar nga Allahu xh.sh.: “Ai (Musai) tha: Zoti im, zgjeroma gjoksin tim, lehtësoma detyrën time, zgjidh ma nyjën e gjuhës sime që ta kuptojnë fjalën time, si dhe caktoma një ndihmëtar nga familja ime. Caktoma Harunin, tim vëlla.” (Ta Ha, 25-28). E Sylejmani a.s. lutej kështu: “Zoti im, më fal mua dhe më dhuro aso pushteti që askush pos meje nuk do ta ketë. Ti, vërtet, je Dhuruesi i madh.” (Sad, 35).

Junusi a.s., duke qenë i struktur në errësirën e peshkut, i ishte lutur Allahut me fjalët: “... Nuk ka Zot tjetër pos Teje. Qofsh madhëruar! Unë i bëra padrejtësi vetes...” (El-Enbija, 87). Zekerija a.s. lutej kështu: “O Zoti im, mos më lër të vetmuar (pa fëmijë) se Ti je trashëguesi më i mirë.” (El-Enbija, 89). Ndër duatë e shumta të Peygamberit a.s., e të cilën e përmend edhe Kurani fisnik është edhe kjo: “Zoti ynë, jepna neve mirësi në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit.” (El-Bekare, 201).

Peygamberi a.s. u lut për...

Lutjet e Peygamberit a.s. ishin të veçanta dhe përbëheshin nga pak fjalë, por përqafonin një numër shpërblimesh dhe bekimesh. Ndër lutjet më gjithëpërfshirëse që i Dërguari a.s. na e mësoi është: “O Allah, na jep të mira në këtë botë dhe të mira në botën tjetër dhe na mbroj nga zjarri i Xhehenemit.”¹⁹

Jam lutja
e babait tim, Ibrahimit a.s.

Zoti në Kuran na rrëfen tregimin e Ibrahimit a.s., për ndërtimin e Qabesë, kur ai u lut: “Zoti im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoji me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në jetën tjetër.” (El-Bekare, 126). Kur Pejgamberi a.s. u pyet për origjinën e tij, ai tha: “Unë jam lutja e babait tim, Ibrahimit a.s., përgëzimi i Isait, birit të Merjmes.”

Lutja e veçantë
e Pejgamberit a.s.

Enes ibën Maliku transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Për çdo të dërguar ka pasur nga një lutje me të cilën është lutur dhe i është pranuar, ndërsa unë e ruajta lutjen time si shefat për ymetin tim në Ditën e Gjykimit.”²⁰ Për këtë është i njohur hadithi i gjatë për hallet e njerëzve në Ditën e Gjykimit, kur banorët do të kërkojnë ndërmjetësim te pejgamberët e Allahut, derisa do të vinë tek i Dërguari, i cili do ta lut Allahun dhe ajo dua do t'i pranohet.

“O Allah! Dhuroi Ibën Abasit
të kuptuarit e fesë!”

Imam Buhariu shënon nga Ibën Abasi të ketë thënë: “Njëherë hyri Pejgamberi a.s. për t'u larë, e unë e përgatita ujin për abdesin e tij.”... E informuan se kush e përgatiti ujin dhe ai a.s. tha: “O Allahu im! Dhuroi (Ibën Abasit) fikh – të kuptuarit e fesë.”²¹

Pejgamberi a.s. u lut
për Enes ibën Malikon

Transmetohet nga Katade të ketë thënë se: “Ummu Sulejme i tha të Dërguarit a.s.: Enesi është shërbëtori yt. I Dërguari a.s. tha: “O Allahu im! Jepi atij shëndet të mirë dhe shumë pasardhës! Bekoji të gjitha që ke për t'ia dhënë.” Është shënuar se Enesi ka pasur përafërsisht njëqind djem dhe vajza. Përveç kësaj, ai ka pasur edhe pemishten, në të cilën frutat piqeshin dy herë në vjet.²²

Lutja e të Dërguarit a.s.
në Bedër

Kur sahabët dolën në Bedër, Pejgamberi a.s. bëri tri lutje të bukura dhe mbresëlënëse: “O Allah! Ata janë në këmbë, siguroju kafshë kalëruese! O Allah, ata nuk kanë rroba, vishi ata! O Allah, ata janë të uritur, siguroju ushqim!” Allahu i pranoi këto tri lutje të Pejgamberit a.s., dhe iu dha fitore atyre në këtë luftë.²³

I Dërguari a.s. u lut
për Omer ibën Hatabin

Njëherë Pejgamberi a.s. e preku kokën e Omer ibën Hatabin me dorën e tij dhe u lut për të: “O Allah, bëje atë të bukur!” Me bekimin e lutjes së tij, atij iu dha një bukuri e rrallë dhe përkundër moshës së shtyrë, flokët i kishte ende të zeza.

“O Allah! Unë jam i kënaqur
me Othmanin, Ji i kënaqur
edhe Ti!”

Pas betejës së Tebukut, i Dërguari a.s. kërkoi nga sabahët që t'i ndihmonin në përgatitjen e ushtrisë. Të gjithë sahabët u përpoqën të ndihmonin, por ishte Othmani ai që ua kaloi të gjithëve. Duke qenë mirënjohës ndaj kësaj bujarie, i Dërguari a.s. i ngriti duart dhe u lut tri herë me lutjen: “O Allah! Unë jam i kënaqur me Othmanin, Ji i kënaqur edhe Ti me Othmanin.”

I përgëzuarit me Xhenet

Pejgamberi a.s. ka thënë: “70,000 njerëz prej ymetit tim do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari.” Shoku i tij, Ukashe ibën Muhsini, i tha Pejgamberit: “Lute Allahun që të më përfshijë në mesin e atyre që do të hynë në Xhenet pa llogari.” I Dërguari a.s. u përgjigj: “Ti je prej tyre.” Një sahabi tjetër u ngrit dhe tha: “Lute edhe për mua.” I Dërguari a.s. u përgjigj: “Ukasheja ta ka kaluar.”

Një gruajë iu premtua Xheneti

Ibën Abasi njëherë i tha nxënësit të tij, Ataut: “A të tregoj për një grua, të cilës i është premtuar

Xheneti?” Ai iu përgjigj: “Po.” Atëherë Ibën Abasi bëri me shenjë nga një grua, e cila kishte ardhur te Pejgamberi a.s. dhe i kishte thënë: “Unë vuaj nga alivanosjet epileptike, gjatë të cilave më humb vetëdija dhe më zbulohet trupi. A mund ta lusësh Allahun të më shërojë nga kjo sëmundje?” Pejgamberi a.s. i tha: “Nëse tregon durim, Allahu do t'ua japë Xhenetin dhe nëse dëshiron, unë do t'i lutem që t'ju shërojë.” Gruaja tha: “Do të bëj sabër, por lutu që të mos më zbulohet trupi kur të alivanozem.” Kështu që Pejgamberi a.s. u lut për të.

Dhembshuria e Pejgamberit a.s.
për ymetin e tij

Transmetohet nga Aisheja r.a. se ka thënë: “Kur njëherë e pash Pejgamberin a.s. në qejf, i thashë: O i Dërguari i Allahut! Lute Allahun për mua.” Ai tha: “O Allah! Falja Aishes mëkatet e saj të kaluara dhe ato të ardhshmet, të fshehtat dhe të dukshmet!” Aisheja r.a. qeshi, derisa prej të qeshurës koka e saj i ra në prehrin e të Dërguarit a.s.. Pejgamberi a.s. e pyeti: “A të gëzoi lutja ime o Aishe?” Ajo ia ktheu: “E si të mos më pëlqej lutja jote!” Ai tha: “Për Zotin, kjo është lutja ime që unë e bëj për ymetin tim në çdo namaz.”

1. Ahmed Ferid, *Deti i kthjellët i devotshmërisë*, fq. 129, Shkup, 2012. 2. Transmeton Tirmidhiu. 3. *Transmetojnë Buhariu (658) dhe Tirmidhiu (3373)*. 4. *Aid el-Karni, Muhamedi a.s. sikur ta shihnit*, fq. 53, Prishtinë, 2009. 5. *Transmetojnë Ahmedi (17888, 17919), Ebu Davudi (1479) dhe Tirmidhiu (2969, 3247)*. 6. *Resul Rexhepi, Dua – lutje të jetës*, fq. 31, Prishtinë, 2019. 7. *Abdulaziz en-Neda, Enciklopedia e sjelljeve dhe rregullave islame*, fq. 311, Shkup, 2010. 8. *Muhtesar Sahib el-Buhari, nr. 1, fq. 23*. 9. *Transmetojnë Ahmedi (2/362), Tirmidhiu (337) dhe Hakimi (1/490)*. 10. *Transmetohet nga Ibën Abasi*. 11. *Buhariu dhe Muslimi*. 12. *Sahibu el-Xhami (4523)*. 13. *Transmetojnë Tirmidhiu (3479) dhe Hakimi (1/493)*. 14. *Transmetojnë Buhariu (6339) dhe Muslimi (2679)*. 15. *Transmetojnë Ebu Davudi (1495), Ibën Maxhe (3858)*. 16. *Ibën Hibani (866)*. 17. *Muslimi (1015)*. 18. *Muhtesar Sahib el-Buhari, nr. 6304, fq. 782*. 19. *Transmetojnë Buhariu (4522) dhe Muslimi (2688)*. 20. *Buhariu dhe Muslimi*. 21. *E shënon Imam Buhariu në kapitullin “Abdesi”*. 22. *Ibën Kethiri, Muchbizet e Resulullahut*, fq. 91, Shkup, 2009. 23. *Abdul Malik Muchhadith, Lutje të pranuar, Prishtinë, 2016*.

M.sc Artan S. Mehmeti

Kontributi i El-Ferganit (Alfraganus) (798 – 865) në zhvillimin e shkencës

Ebul-Abbas Ahmad ibën Muhamad ibën Kasir El-Fergani, në botën perëndimore njihet më emrin Alfraganus. Ai lindi në qytetin persian Farghana, qyteti në kohën moderne i takon Uzbekistanit. Ai dha një kontribut të madh në astronomi, astrologji, kozmologji dhe gjeografi.

El-Fergani, së bashku me El-Hvarizmin punuan në Shtëpinë e Urtësisë në Bagdad. Kjo shtëpi ishte një qendër shkencore e cila merrej me përkthimet dhe hulumtimet e teorive shkencore dhe filozofike, e në veçanti të atyre greke. El-Fergani mori pjesë në matjen e shkallës së një meridiani në shkretëtirën Sanjar në Irak.

Në vitin 861, El-Fergani ndërtoi një Nilometër të ri (shkallë që mat nivelin e ujit të Nilit) në ishullin e Raudës pranë Kajros, i cili funksiononte deri në vitin 1971.

Deri në kohet moderne, janë të ruajtura rreth 11 vepra të El-Ferganit, të gjitha të shkruara në gjuhën arabe. Disa nga këta libra janë: “Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Harakat el Samavija”,¹ “Bab fi ma’rifat el-vakt el-lati jakuni el-kamar fiha fa-vka el-erd av tahtakha”, “Hisab el-akalim as-sab’a”, “el- Kamil fi el’a el-usturlab ash-shimali ve-l-xhanubi bi-l handasa ve-l-hisab”, “Kitab amal ar-ruhamat”, dhe shumë të tjerë.

Në librin “Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Harakat el Samavija”, të cilën e ka shkruar në vitin 833, El-Fergani bëri një përmbledhje përshkruese për “Almagestet” e Ptolemeut, duke i përdorur zbulimet dhe vlerat e

Pas përkthimit, ishte libri më i njohur në fushën e astronomisë si në botën perëndimore ashtu edhe në atë lindore deri në shekullin XV, duke i sjellë njëkohësisht edhe famë të madhe El-Ferganit.

korrigjuara të astronomëve të më hershëm myslimanë, si dhe një studim të plotë mbi shkencën e yjeve. Në këtë libër, ai llogariti gjatësinë gjeografike tokësore dhe zbuloi i pari se Dielli dhe planetët përshkruajnë orbitën në kahun e kundërt të lëvizjes ditore, si dhe na jep prova për formën sferike të Tokës dhe të dhëna mbi madhësinë e planetit, gjë që nxiti Ch. Columbun (K. Kolumbon), F. Magellanin, si dhe udhëtarët e tjerë për të bërë zbulime gjeografike. El-Fergani gjithashtu zbuloi që forma oblike e eklipsit (d.m.th. këndi i pjerrësisë që orbita e dukshme e Diellit krijon me ekuatorin qiellor) ulët shumë gradualisht. Libri është krejtësisht libër përshkrues dhe jo matematiko-astronomik.

Në gjuhën latine “Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Harakat el

Samavija”, është përkthyer në vitin 1137, nga Xhoni i Seviljes nën titullin “Differentia Scientie Astrorum”. Pas përkthimit, ishte libri më i njohur në fushën e astronomisë si në botën perëndimore ashtu edhe në atë lindore deri në shekullin XV-të, duke i sjellë njëkohësisht edhe famë të madhe El-Ferganit. Ky libër është përdorur si libër mësimi si në institucionet arsimore lindore ashtu edhe ato perëndimore duke u kthyer në burimin kryesor si për shkencëtarët, ashtu edhe për njerëzit e zakonshëm të cilit ishin të interesuar që të fitonin njohuri rreth astronomisë. Libri pati një ndikim të madh në astronomi evropiane deri në kohën e publikimit të veprave të astronomit gjerman Johannes Müller von Königsberg (Regiomontanus). Shumë shkrime të astronomisë, gjatë kohës së mesjetës i janë referuar “Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Harakat el Samavija”, dhe nuk ka dyshim se ky libër ishte përgjegjës kryesor për përhapjen e astronomisë Ptolemaike, të paktën derisa ky rol të ishte marrë nga vepra tjetër astronomike “Sphaera” e Johannes de Sacrobosco.² Edhe pas botimit të kësaj vepre, “Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Harakat el Samavija”, vazhdoi të përdoret gjerësisht deri në shekullin XV-të.

“Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Harakat el Samavija” përbëhet nga tridhjetë kapituj. Kapitulli 1, nuk korrespondon me “Almagestet” e Ptolemeut. Në këtë kapitull El-Fergani i analizon vitet e arabëve, sirianëve, romakëve, persëve

dhe egjiptianëve, duke u dhënë emra muajve dhe ditëve të tyre, si dhe tregon dallimet në mes këtyre kalendarëve. Tek Almagesti i Ptolomeut, nuk ka informacione të këtilla. Kapitujt 2, 3 dhe 4, kanë të bëjnë me parimet themelore të astronomisë së Ptolomeut. Në kapitullin 5, El-Fergani e jep vlerën e këndit më të madh në mes ekuatorit dhe ekliptikës, në $23^{\circ}35'$. Këtë kënd Ptolomeu e vlerëson në $23^{\circ}51'$. Të dhënat moderne tregojnë se vlerësimi i El-Ferganit është më i saktë se vlera e dhënë në “Almagest” nga Ptolomeu. Po ashtu El-Fergani dha distancën për shkallë në ekuator, dhe në kapitullin e 8, ai e përcaktoi diametrin e tokës të jetë 6500 milje, kurse perimetrin e tokës El-Fergani e vlerësoi të jetë 24.000 milje.

Megjithatë ideja e dhënë nga ai se toka ka formën e një sferë nuk ishte diçka e re. Grekët, sferën e tokës e ndan në 360 shkallë, por burimet e ndryshme japin informacione të ndryshme rreth gjatësisë së një shkalle. Nga matjet e kohëve moderne, ne e dimë se gjatësia e një shkalle në ekuator është rreth 111 km. Në shekullin e tretë, Eratosteni,³ shkallën ekuatoriale e llogariti në vlerë prej 110 km, kurse Ptolomeu këtë shkallë e llogariti në 93 km. El-Fergani të njëjtën shkallë e llogariti në 111 km. Në këtë rast, vlera e tij ishte më e saktë se ajo e Ptolomeut.

Në kapitullin e 21, El-Fergani jep distancat më të mëdha në mes planetëve nga toka, si dhe diametrin e çdo planeti. Ai e pranoi teorinë e Ptolomeut dhe vlerën e precesionit, por mendoi se kjo ndikoi jo vetëm me yjet, por edhe me planetët gjatë periudhës së apogjenës. Ptolomeu thotë se teoria e precesionit ndikon në të gjithë planetët përveç diellit. Sipas Ptolomeut, bazat e orbitave të diellit janë konstante. Nga ana tjetër, sipas El-Fergani, apogjena e diellit lëviz nga yjet fikse, kështu që sipas tij, dielli ka dy lëvizje: a) lëvizjen ekscentrik (jashtë qendrore) dhe b) lëvizjen apogjene.

Disa vlera që i dha El-Fergani për lëvizjet e planetëve, nuk ishin të njëjta me të dhënat e Ptolomeut. Lëvizjen anormal të Saturnit, Ptolomeu e vlerësoi si $57^{\circ}7'$, ndërsa të njëjtën lëvizje El-Fergani e vlerëson si 59° . Sipas Ptolomeut, ekscentriciteti i Hënës ishte $10;19^{\circ}$. Në anën tjetër, El-Fergani tha se ai ishte $12;30^{\circ}$. Diametri i epiciklit të Hënës në “Almagest” ishte $5;15^{\circ}$; anasjelltas, në “Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Harakat el Samavija” ajo ishte $6;20^{\circ}$. Nga Ptolomeu gjerësia ekstreme e Venusit u dha si $6;22^{\circ}$. Megjithatë, El-Fergani të njëjtën gjerësi e dha si 9° . Vlera e dhënë nga El-Fergani për shtrirjen e Marsit dhe Venusit, ishte e ndryshme nga vlera e Ptolomeut. Sipas El-Ferganit, shtrirja ishte 17° për Marsin dhe 7° për Venusin. Në “Almagest”, këto vlera ishin $14^{\circ}33'$ për Marsin dhe $5^{\circ}36'$ për Venusin. Ptolomeu tha se parallaxi i Hënës ishte mes $0;10^{\circ} - 0;25^{\circ}$. Nga ana tjetër parallaxi i Hënës nga El-Fergani u dha si $1^{\circ}44^{\circ}$.

El-Fergani nuk i përsëriti disa gabime të cilat ndodheshin në



“Almgastet” e Ptolomeut. Për shembull, nëse i shikojmë distancat në mes planetëve nga toka të dhëna nga Ptolomeu, mund të shohim se ka hapësirë boshe midis Venusit dhe Diellit. Kjo është në kundërshtim me kosmologjinë aristoteliane. Nga ana tjetër, El-Fergani nuk bën një gabim të tillë. Duke përmbledhur dhe thjeshtuar “Almgastet” e Ptolomeut, El-Fergani kishte një ndikim të madh në astronomi islamike. Astronomët myslimanë pranuan idetë e tij, veçanërisht vlerën e precesionit që ishte ndryshe nga vlera e Ptolomeut, si dhe distancat dhe diametrat e planetëve, të gjendura në librat e tij.

Megjithëse “Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Harakat el Samavija” ishin një përmbledhje e “Almagestit” të Ptolomeut, pikëpamjet e Ptolomeut janë vënë në pikëpyetje, sepse ekzistojnë disa dallime ndërmjet këtyre dy veprave.

Ndarja në 30 kapituj e “Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Harakat el Samavija” është si më poshtë:

Kapitulli 1 është për vitet arabe dhe persiane, emrat e muajve dhe të ditëve të tyre dhe dallimet ndërmjet tyre. Në këtë kapitull El-Fergani i përshkruan vitet e arabëve, sirianëve, romakëve, persëve dhe egjiptianëve, duke u dhënë emrat e muajve dhe të ditëve të tyre dhe dallimet mes kalendarëve të tyre.

Kapitulli 2 ka të bëjë me ngjashmërinë e qiejve në një sferë.

Kapitulli 3 ka të bëjë me ngjashmërinë e Tokës me të gjithë brendësinë e saj, të cilat janë toka dhe deti në një sferë.

Kapitulli 4 është rreth pozicionit qendror të Tokës.

Kapitulli 5 është për dy lëvizjet kryesore të qiejve; lëvizja ditore dhe vjetore. Këto janë konceptet bazë të Ptolomeut në “Almagest”.

Kapitulli 6 është për zonat e banuara dhe mbi ditën e natën.

Kapitulli 7 është për pjesët e zonave të banuara.

Kapitulli 8 është për rreth shtatë llojeve të klimave.



Kapitulli 9 është për emrat e tokave dhe qyteteve të mirënjohura në të gjitha zonat klimatike.

Kapitulli 10 diskuton për ngjitjet e shenjave të zodiakut në sferat e drejtpërdrejta dhe sferat jo të drejtpërdrejta.

Kapitulli 11 përmend orët e njëjta dhe jo të njëjta.

Kapitulli 12 është për sferat e çdo planeti dhe distancat e tyre nga toka.

Kapitulli 13 përshkruan lëvizjet e Diellit, Hënës dhe yjeve në gjatësinë e tyre.

Kapitulli 14 flet për lëvizjet e pesë planetëve në gjatësi.

Kapitulli 15 flet për lëvizjet tërheqëse të planetëve.

Kapitulli 16 është në lidhje me madhësinë e ekscentricitetit dhe të epikiklit.

Kapitulli 17 është rreth revolucioneve të planetit në orbitën e tyre.

Kapitulli 18 flet për lëvizjen e Hënës dhe të planetëve në gjerësi.

Kapitulli 19 ka të bëjë me rendin e madhësisë së yjeve fikse dhe pozicionet e më të shquarit mes tyre.

Kapitulli 20 është për stacionin hënor.

Kapitulli 21 është rreth distancave të planetëve nga toka.

Kapitulli 22 është rreth madhësive të planetëve në krahasim me madhësinë e Tokës.

Kapitulli 23 është për kalimet në meridian.

Kapitulli 24 flet për ngritjen dhe vendosjen, ngjitjet, përluljet dhe fshehjen.

Kapitulli 25 flet për fazat e Hënës.

Kapitulli 26 është rreth shfaqjes së pesë planeve.

Kapitulli 27 është rreth paralaksit.

Kapitulli 28 është rreth eklipseve hënore.

Kapitulli 29 është rreth eklipseve diellore.

Kapitulli 30 është rreth intervaleve të eklipseve.

Të dy librat si “El- Kamil fi el’a el-usturlab ash-shimali ve-l-xhanubi bi-l handasa ve-l-hisab”, po ashtu edhe “Kitab amal ar-ruhamat”, përmbajnë udhëzime për hartimin, bërjen dhe zbatimin e veglave astronomike-astrolabesë⁴ dhe sundialeve (orëve diellore).⁵

Në librin “Kitab amal ar-ruhamat”, El-Fergani provoi teoremën e Ptolemeut në projeksion stereografik,⁶ e cila njihet si teoria kryesore e astrolabit - instrumentit më popullor në astronomi e mesjetës.

El-Fergani me veprat e tij, ndikoi te poeti italian Dante Alighieri (1261-1321), burimi kryesor i të cilit ishte njohurit astronomike. Dante e studionte “Kitab fi usul ilm an-nuxhum” në përkthimin latin. Kozmologjia e Dantes në “Il convivio” dhe “Commedia Divina”, u adoptua nga “Kitab Xhavami Ilm an-nuxhum vel usul Haraqat el Samavija”. Dante citoi El-Fergani, ose librin e tij vetëm dy herë në “Il convivio”. Djali i Dantes, i quajtur Jacopo di Dante Alighieri gjithashtu i përdorte librat El-Ferganit.

Gjithashtu ai ndikoi shume edhe te Kristofor Kolombi, i cili i përdoret vlerat e El-Ferganit gjatë matjes së Tokës. Kolombi pohoi se udhëtimet e tij e kishin konfirmuar kozmografinë e “Imago Mundi”, si dhe llogaritjet e El-Ferganit. Vetë Kolombi mendonte se po lundronte sipas vlerës së El-Ferganit.

Burimet

- Prof. dr. Fuat Sezgin, *Epoka e madhe e panjohur. Nga historia e shkencës dhe e teknologjisë Islame, përktheu nga turqishtja: Altin Qefalio, LOGOS-A, Shkup 2015*
- HALIMA AL-GHRARI, ARKITEKTËT E MENDIMIT SHKENCOR NË QYTETËRIMIN ISLAM *Vula nga biografitë e dijetarëve myslimanë në periudha të ndryshme, nga arabishtja në anglisht e përktheu: Abdulaziz HAUARIA, Përktheu nga gjuha angleze: Ermal BEGA, Botoi: Qendra Shqiptare për Studime Orientale – A.C.F.O.S. B.O.O-K-S, (botimi i dytë) Tiranë 2020.*
- KONTRIBUTET MUSLIMANE NË QYTETËRIMIN BOTËROR, përgatitën për botim: M. Basheer Ahmed, Md; Ambasador Syed A. Ahsani; Dihanawaz A. Siddiqui, Phd, përktheu: Festime Mehdii Gashi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), Tiranë 2019.
- Sigrud Hunke, *DIELLI I ALLAHUT SHKËLQEN MBI PERËNDIMIN* Trashëgimia jonë arabe, Shqiptëroi nga frëngjishtja Ornella Ademovi, Tiranë 2007.
- Sami Frashëri, *Qytetërimi Islam, LOGOS-A, Shkup 2009.*
- Dr W. Hazmy C.H. Dr Zaimurashid Z. Dr Hussaini R., *BIOGRAPHY Muslim Scholars and Scientists, Published by: Islamic Medical Association of Malaysia N. Sembilan, (https://docs.google.com/file/d/0B-eGqHP6xSdNd1oxMUVCVG82a0Eledit).*
- Assoc. Prof. Yavuz Unat, *Alfraganus and the Elements of Astronomy, (http://www.muslimheritage.com/uploads/Alfraganus2.pdf).*
- [https://en.wikipedia.org/wiki/Ahmad_ibn_Muhammad_ibn_Kathir_al-Farghani.](https://en.wikipedia.org/wiki/Ahmad_ibn_Muhammad_ibn_Kathir_al-Farghani)
- [https://www.uzbekistan.de/en/nachrichten/nachrichten/abul-abbas-ahmad-ibn-muhammad-ibn-kasir-al-farghani-about-798-865.](https://www.uzbekistan.de/en/nachrichten/nachrichten/abul-abbas-ahmad-ibn-muhammad-ibn-kasir-al-farghani-about-798-865)
- [http://www.islamicity.com/Science/Scientists/Al-Farghani.htm.](http://www.islamicity.com/Science/Scientists/Al-Farghani.htm)
- [https://nomad4now.com/cairos-street-art-la-lunar-crater-named-alfraganus/.](https://nomad4now.com/cairos-street-art-la-lunar-crater-named-alfraganus/)
- http://www.ismaili.net/mirrors/57_sina/farghani.htm
- <https://www.wdl.org/en/item/10687/> Fusnotat: 1. Të njëjtin libër të shkruar nga El-Fergani në gjuhën arabe e hasim më tutuj të ndryshëm si: “Kitab fi usul ilm an-nuxhum” dhe “Kitab el-haj’a fi fusul el-thalathin”. 2. Johannes de Sacrobosco, gjithashtu i njohur edhe si Ioannis de Sacro Bosco (rreth 1195 - 1256), ishte një studiues, murg dhe astronom i cili ishte mësues në Universitetin e Parisit. 3. Eratosteni, (276-194 p.e.s.) ishte matematikan grek, gjeograf, poet, astronom dhe teoriancien i muzikës. Ai ishte një njeri i shkolluar, dhe ishte bërë shefi i bibliotekës në Bibliotekën e Aleksandrisë. 4. Një instrument planar astronomik, i bërë nga bakri, bronzi ose lidhjeve të tjera të ngjashme, të cilat përdoren për përcaktimin e koordinatave të trupave qiellore. 5. Është një pajisje që tregon kohën e ditës kur nga rrezet e diellit përcaktohet pozicioni i dukshëm i Diellit në qiell. 6. Projeksioni stereografik - projektimi i pikave në sipërfaqen e sferës qiellore imagjinare nga një pol në plan-rrafsh që kalon përmes polit tjetër të tij, ose në plan-rrafsh që përmban ekuatorin.

Harun Shabanaj

Pagëzim a vdekje (2)

Përveç historianit të shquar, dr. Zekeria Canës, i cili është marrë me hulumtimin dhe studimin e gjenocidit që është kryer ndaj shqiptarëve më 1912-1913, një tjetër historian, dr. Isa Bicaj i ka kushtuar vëmendje këtij problemi.

Dr. Bicaj, kur flet për shkaqet që ndërmori Mali i Zi për konvertimin e shqiptarëve me dhunë në ortodoks, vë në pah këto arsye kryesore:

a) Me ndërrimin e shpejtë të fesë, Mali i Zi synonte të bindte opinionin ndërkombëtar se popullsia në këto vise ishte islamizuar me dhunë nga Porta e Lartë sepse kjo ishte me origjinë sllave;

b) Me dhunën e përdorur ndaj kësaj popullate do të nxirrnin njerëz labil të cilët do t'ia lehtësonin realizimin e qëllimeve pushtuese, dhe

c) Qeveria e Malit të Zi ishte e vetëdijshme se shqiptarët do ta kundërshtonin ndërrimin e fesë së tyre, por këtë e bënë për të ushtruar dhunë represive nga e cila shqiptarët do të detyroheshin të shpërnguleshin në Turqi.¹

Është me interes të cekim se përveç studiuesve shqiptarë, me këtë problematik janë marrë edhe shumë studiues të tjerë, të cilët i kanë kushtuar vëmendje të veçantë problematikës së konvertimit me dhunë të shqiptarëve në ortodoksë.

Në kontekstin e lartpërmendur veçojmë antropologjen dhe studiuesen e njohur angleze, Edith Durham, e cila duke u marrë me problematikën e Gadishullit të Ballkanit, studimet e saj ia kushtoi luftëravedhe ngatërresave në Ballkan, duke sjellë fakte, informacione, dëshmi e argumente të shumë ngjarjeve nga historia e kësaj ane të Evropës.

Njani komandant ia nisi me fol, dhe tha: krajli ka urdhnu me shku në Kishë në Deçan me ba kryqin e me ndrru fenë. A ka kush që e then këtë urdhën. Kuku për neve, thanë i madh e i vogël, na zuni hataje tan ja nisën vajit qysh me ndrru fenë.

Edith Durham, kur flet për konvertimin me dhunë të shqiptarëve në ortodoksë, thotë: “Nga krahinat e pushtuara vinin njoftime të dhunshme për mizoritë e egra që bënin serbët dhe malazezët ndaj shqiptarëve. Dhe pushtuesi jo vetëm që nuk i fshihte të bëmat, por përkundrazi ata mburreshin me to. Një oficer serb desh u mbyt me birrë nga e qeshura, kur më tregoi se si ushtarët e tij kishin therur me bajoneta gratë dhe fëmijët e Lumës. Bile njëri nga Petroviqët u ngrëfos si gjel dhe më tregoi se për dy vjet asnjë njeri në tokat e pushtuara nuk do të guxonte të fliste më atë ‘gjuhë të ndyrë’ [shqip].”²

Pra, ishte e kuptueshme se sllavët ishin të bindur që të vijonin rrugën e tyre, qoftë edhe me dhunë për të zhdukur nga faja e dheut racën shqiptare, dhe posaçërisht shqiptarët

të cilët nuk i bindeshin besimit të tyre.

Një ngjarje e dhimbshme e konvertimit me dhunë të shqiptarëve në ortodoksë, është ajo në fshatin Carrabreg të Deçanit.

Në lokacionin e njohur Bahqja e Qorrajve në Carrabreg, komandanti famëkeq Sava Lazareviq, i cili për shkak të krimeve të kryera ndaj popullsisë shqiptare të kësaj ane, edhe sot e asaj dite, kujtohet nga populli i kësaj krahine, si Savë Batarja.

Savë Batarja, kishte urdhëruar që aty te Bahqja e Qorrajt të mblidhej i gjithë fshati Carrabreg, për të zbatuar urdhrin e Mbretit Nikolla për konvertimin në fenë ortodokse të popullsisë së Carrabregut.

Kam pasur fatin që gjatë mbledhjes dhe hulumtimit të materialeve për hartimin e kësaj vepre studimore, të takoj edhe Zepe Bardhoshja - Binakaj, e cila ishte vajza e Ali Bardhoshit të Carrabregut, që në atë kohë ishte vetëm trembëdhjetë vjeçe. Në bisedë me Zepe Bardhoshen - Binakaj, ajo fillon rrëfimin e saj duke kujtuar skenat trishtuese të asaj dite: “Na kan urdhnu me dal në Bahqe të Qorrajt, aty na kan bashkue krejt katunin, i madh e i vogël. Ushtria na ka rrethue në katër anët.

Kanë ardhur dy komandantë hipun në kuaj, ishin me pushkë në krah e në dorë kishin kamxhik në maje të kamxhikut ia kishin ngjit ka një plum, sillshin sa q'mujshin nëpër popull, kan mujshin me kapë e përgjakshin. Njani komandant ia nisi me fol, dhe tha: krajli ka urdhnu me shku në Kishë në Deçan me ba kryqin e me ndrru fenë. A ka kush që e then këtë urdhën. Kuku për neve, thanë i madh e i vogël, na zuni hataje tan ja nisën vajit qysh me ndrru fenë.



Zepe Bardhoshja - Binakaj, nga Carrabregu, e martuar në Drenoc të Deçanit, e cila i ka mbijetuar kohës së ndërrimit të fesë me dhunë në ortodoksë, fushatë kjo endërmarrë nga pushteti serbo-malazez.

Përpara tyne në istikam dolën dy burra dhe iu kapën frejte ekuajve. Ata ishin Ali Shabani i Loshaj dhe Osë Qorri. Aliu i tha, nuk e ndrroj fenë për s'gjalli. Ai urdhëroi ushtrinë që të lidhën të dytë.³

Po ashtu kam pasur fatin që të takoj edhe dëshmitarin tjetër të kësaj vepre gjenocidiale që kreu Mali i Zindaj shqiptarëve, Zeqë (Rexhë) Loshajn nga Carrabregu, i cili në atë kohë ishte dymbëdhjetë (12) vjeç. Ai gjatë dëshmisë së tij, ndër të tjera, kujton se: "Ali Loshi kur dëgjoj se po i kryqëzon Carragorja tri herë ka shku në xhaminë e Deçanit te Haxhi Mania, që ka qenë hoxhë shumë i knushëm ka pyet qysh me ia ba se ju ka hy rend tanë po u kryqëzon Savë Batarja. Hoxha i kishte thanë së nkoftë se ju rudhë puna bane kryqin me dorë po thune shehadetin me zemër. Alia i thot, o pash Allahun kurr nuk muj me ba inqarë fenë e Muhamedit. Sava urdhëroj që ata të lidhen për trupa të mollës me dur përpjetë. Ushtria e kan prue edhe Hasan Hulën e Prejlepit. Hasanin e kish spiunue një shka i Lloqanit, të tre, Alin, Osën e Hasanin i lidhin e i lan tanë natën lidh në Bahqë të Qorraj. Neve na kan than shkoni nëpër shpija e nesër ju thrrasim me



Zeqë (Rexhë) Loshaj, nga Carrabregu i Deçanit, i cili ishte i mbijetuar i kohës së ndërrimit të fesë me dhunë në ortodoksë, fushatë kjo e ndërmarrë nga pushteti serbo-malazez.

dal apet ktu. Mos gabo kush me i ndeze dritën natën e as mu la, i caktoi do njerz që ta përcjellin baxhat (banjot) e katunit a mos po lahet kush a mos po merr avdes dhe po zbritin me i fal namazet e me lexue Kuran. Të nesërmen kur na kan çu aty ata të tre ishin gjithë me dur të lidhur përpjetë. Alia i tha një ushtari a ban me mi lëshu pak dur të se i kam të mpime e spo e di që janë duert e mia. Ai ja lëshoj pak dur të teposhtë. Alia i tha, euu të martë Zoti shpirtin musliman po që më ke shlirue.

Ka ardh Savë Batarja, i ka zgjidh ju ka dhanë tarrnakipta dhe i ka thanë, merrni maroni varret vet, ja kan nis e i kan ba varret vet të tretë. Kuri çelën varret, Ali Shaban Loshi e thirri vllaun e vet, Rexhen e i tha, o Rexh kqyri edhe fmine e me u kujdesu për ta, e masanej ju drejtu ka Sava, e i tha Savës a ban mem la me e thirr ezanin para se mem pushkatue, po thirre i tha Sava. E ka thirre ezanin me za shumë të madh sa që e kan ndie deri në Beleg. Kur e ka kry ezanin e kan çue gishtin tregues përpjetë dhe ia ka nisë me ra shahadet sa ka pas za. Ashte afru Sava e ja ka kput gishtin me thik dhe e ka gjue në tokë. Atë gisht e kam pa me syt e mi që edhe mbasi a kput e a gjue në tokë ka

livrit. Osë Qorraj ja ka nis me za të ultë me tha ikametin edhe Hasan Hula ka ra shahadet me za të naltë. Savë Batarja i ka dhanë urdhën ushtrisë dhe i kan pushkatue. Secilin i kan shti të përgjakur në varr të veta e i kan urdhnu popullin me i mlu me dhe.

Neve na ka nisë për në kishën e Deçanit për me na ndrrue fenë⁴, thekson ndër të tjera në dëshminë e tij, Zeqë (Rexhë) Loshaj. Më tej ai vazhdon: "Hasan Hulën nga Prejlepi e kishte denoncuar një serb nga Lloqani me të cilin më parë kishte një konflikt. Atë ushtria malazeze e kishte arrestuar në shtëpinë e tij në Prejlep. Duke dalë nga shtëpia një fëmijë i cili kishte qenë në djep duke fjetur, Hasani ulet dhe e puth fëmijën dhe i thotë, nuk po më dhimbset jeta që po e jap, por po më dhimbesh ti që po të la ndër shka."⁵

Dëshmitë e dytë sipërpërmendurve, Zepë Bardhoshja – Binakaj dhe Zeqë (Rexhë) Loshaj, siç e kam cekur edhe më parë, të cilët kam pasur fatin t'i takoj dhe intervistoj personalisht, janë vetëm një përqindje e vogël e gjithë atij gjenocidi të pashembullt që ka kryer Mali i Zindaj shqiptarëve të Rrafshit të Dukagjinit.

Duhet sqaruar se nga të dhënat e shumë dëshmitarëve mësojmë se gjatë vrasjeve dhe torturave që ka pësuar popullsia e kësaj ane, shpeshherë trupat e vdekur të shqiptarëve muslimanë, gjymtoheshin në mënyrat më barbare, duke iu prerë hundën, veshin, gishtërinjtë e duarve dhe këmbëve. Kishte raste kur trupat i ndanin përgjysmë dhe pjesë të prera të trupit i merrnin me vete për t'u krenuar para popullit të vet dhe liderëve të tyre politik dhe fetar për vrasjet e gjymtimet e kryera.

1. Dr. Isa Bicaç, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze, 1881-1914, Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 2003, f. 179.* 2. *Durban, Brenga...*, f.385. 3. *Deklaratë e Zepe Bardhoshja - Binakaj (1900-2003) dhënë autorit, më 15 maj 2001 në Drenoc të Deçanit.* 4. *Deklaratë e Zeqë (Rexhë) Loshajt (1900-2002) dhënë autorit në Carrabreg të Deçanit, në tetor të vitit 2001.* 5. *Po aty.*

Intervistë me mësimdhënësen Qesere Fazliu¹, me rastin e 1 Shkurtit, Ditës Botërore të Mbulesës

Një Shkurti - Dita Botërore e Mbulesës

Kam pasur diskriminim, nënçmim, fjalë jo të mira e shumëçka nga të ashtuquajturit intelektualë e demokratë. Reagimi im ishte me durim, duke treguar edukatë islame, familjare, dhe e dija që është një sprovë që me ndihmën e Allahut do t'ia dal, por kuptohet edhe me vullnet e shumë punë.

E nderuar, a mund ta bëni një prezantim të shkurtër për veten?

Jam Qesere Fazliu-Musa, e lindur në Prishtinë, jam nënë e tre fëmijëve, rrjedh nga një familje me tradita islame. Kam të përfunduar Fakultetin e Edukimit, dega Programi Fillor, dhe aktualisht punoj mësuese në shkollën fillore Isa Boletini në fshatin Busi.

Si është të ushtrosh profesionin e mësueses në Kosovë?

Profesioni mësuese është më shumë një mision në vete, sepse bart një barrë të rëndë mbi supe, e sidomos ne, që jemi me mbulesë, jemi në shënjestër, dhe shikohemi edhe në detaje, që nënkupton që ne duhet të punojmë më shumë se të tjerat, edhe

për profesionin, por edhe për mbulesën që ne e bartim.

Qe sa kohë jeni duke ushtruar këtë profesion?

Jam në arsim që nga viti 2002, kuptohet me një shkëputje nga viti 2005 deri më 2013, kur kam qenë e suspenduar për shkak të mbulesës, dhe pas një viti që me është pranuar kërkesa, fillova sërish punën, pra, gjithsej 9 vjet suspendim.

Cilat janë sfidat që keni hasur për t'u pranuar në punë dhe sfidat pasi që keni filluar punën?

Në pranim të punës nuk kam pas sfida, sepse isha pa mbulesë.

A keni pasur mirësjellje nga kolegët e punës, drejtorja dhe nxënësit e shkollës ku punoni?

Vitet e para të punës sime në arsim isha pa mbulesë, dhe në momentin që unë u mbulova ndërruan paksa raportet kolegjiale, disa më uronin e disa më ngushëllonin për mbulesën time. Sa u përket nxënësve, ata janë sjell njëjtë, madje shprehnin pakënaqësinë ndaj atyre që donin të më largonin, duke protestuar me fjalë të ndryshme mbështetëse ndaj meje.

A keni hasur në diskriminim për shkak të mbulesës, dhe si keni reaguar në ato raste?

Kam pasur diskriminim, nënçmim, fjalë jo të mira e shumëçka nga të ashtuquajturit intelektualë e demokratë. Reagimi im ishte me durim, duke treguar edukatë islame, familjare, dhe e dija që është një sprovë që me ndihmën e Allahut do



Vazhdova me ankesë në KMDLNj, edhe nga aty ma refuzuan kërkesën, më pas tek Ombudsperson, por, fatkeqësisht edhe nga aty ma refuzuan lëndën time. Pastaj, për rastin tim lajmërova edhe mediat e shkruara edhe ato elektronike.



t'ia dal, por kuptohet edhe me vullnet e shumë punë.

Pasi që jeni rasti i parë në Kosovë, që pas diskriminimit në vendin e punës keni fituar vendin e punës me gjyq dhe po ashtu keni marrë dëmshpërblim, na trego si keni arritur këtë dhe sa ka zgjatur ky proces?

Kam arritur me mund e sakrificë të madhe. Ky proces ka zgjatur nëntë vjet. Kur u paraqita me mbulesë në shkollë, drejtori më thirri në zyrë dhe më tha që nuk lejohet të punosh me mbulesë, por unë prapë vazhdova punën, dhe pas një jave më dha fletë suspendimin. Unë menjëherë bëra ankesë në Drejtorinë e Arsimit, në Komunën e Prishtinës, por ata ma refuzuan kërkesën time, më pas vazhdova në Ministri të Arsimit. E dërgova një ankesë, por edhe atje e refuzuan. Vazhdova me ankesë në KMDLNj, edhe nga aty ma refuzuan kërkesën, më pas tek Ombudsperson, por, fatkeqësisht edhe nga aty ma refuzuan lëndën time. Pastaj, për rastin tim lajmërova edhe mediat e shkruara edhe ato elektronike. Dhe

më s'më mbeti hap tjetër, përveçse lëndën time ta dorëzojë edhe në Gjykatën Komunale, por edhe nga aty, Komuna e Prishtinës, gjegjësisht Drejtoria e Arsimit e refuzoi kërkesën e Gjykatës. Lënda ime kaloi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, ku më 29.07.2013 u lëshua Aktvendimi që unë të kthehem në vendin e punës nga ku isha dëbuar. Komuna e Prishtinës e ekzekutoi vendimin dhe unë u ktheva në punë në shtator të vitit 2013. Pas një kohe, mora edhe kompensimin e dëmit që më ishte bërë.

Nga kush keni pasur mbështetjen më së shumti gjatë procesit të gjyqit?

Mbështetja ime më e madhe ishte nga Zoti Fuqiptotë, e më pas nga familja, e në veçanti nga bashkëshorti im, që i jam shumë mirënjohëse.

Si e kanë përjetuar familja juaj diskriminimin dhe pastaj rikthimin e të drejtës së kryerjes së profesionit tuaj me gjyq?

Familja ime u mërzi shumë, por njëkohësisht e kuptonin se ishte një sprovë për mua dhe për ata. Kurse,

kthimi im ishte një gëzim jo vetëm për mua, por edhe për të tjerat që do të vijnë pas meje.

Cili është mesazhi që mund t'i jepni të gjitha vajzave me mbulesë në Kosovë?

Mesazhi im është shkollohuni dhe jini të zonja në profesionet tuaja, kini ambicie dhe këmbëngulni të punësoheni aty ku ju dëshironi dhe jo ku të tjerët ju dërgojnë. Mos u dorëzoni para sfidave që ju dalin para, sepse ashtu si të tjerët që po arrijnë qëllimet e tyre kur po duan diçka, duke bërë të gjitha përpjekjet pa u dorëzuar asnjëherë, ashtu të bëjmë edhe ne, duke u përpjekur fort për t'i fituar të drejtat tona.

Intervistoi: Mr. Muzaqete Kosumi

1. Qefsere Fazliu është një mësuese në shkollën "Isa Boletini" në fshatin Busi, të rrethit të Prishtinës. Ajo u përjashtua nga puna në vitin 2005 pasi vendosi të mbulohej. Në një betejë ligjore 8 vjeçare dhe pas një vendimi të Gjykatës Themelore, Fazliu fitoi të drejtën legale në korrik të vitit 2013, për t'u rikthyer në punë një vit më pas. Ky rast shënon njërin nga rastet e para ku gratë me mbulesë fitojnë të drejtën me vendim gjykatë, të jenë pjesë e institucioneve. Rasti i Fazliut ka ndryshuar edhe politikën e rekrutimeve në arsim, pasi pas këtij vendimi në shkollë ka disa mësimitëse të mbuluara.

Sahiba Goga-Daciq

Mbulesa ime, paqja ime

Gruaja në Islam është një qenie shumë e vlefshme që jeton një jetë të dinjitetshme, duke respektuar të gjitha urdhrat që kanë ardhur në Kuran. Islami e çmon atë dhe ngrit në piedestalin më të lartë moral.

Efilloj këtë temë duke e lutur të Madhin Zot që të na e hapë rrugën e njohjes së të vërtetës, sepse me të vërtetë vetëm Ai (Zoti) është që e udhëzon robin e Tij. Zoti xh.sh. në Kuranin fisnik thotë: “Kjo është rruga (feja) ime e drejtë, (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajë nga rruga e Tij, këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni.”¹

Krijuesi Suprem edhe ujin edhe ajrin edhe tokën në të cilën ecim ua jep të gjithëve, por imanin dhe përlujtjen ndaj Tij ua jep vetëm atyre që Ai i do. Ne jemi të krijuar me një qëllim në këtë botë, që ta jetojmë fenë tonë në mënyrë praktike e jo vetëm teorike. Nuk mjafton vetëm t’i përkasim fesë, por atë e konkretizojmë atëherë kur atë e praktikojmë në jetën tonë.

Mendja e shëndoshë, menjëherë pas njohjes teorike ndjek qëllimin praktik. Kështu është edhe me mbulesën. Mbulesa është një reflektim i mendimeve tona, është ajo që ne mendojmë, ndiejmë dhe ashtu siç ne dëshirojmë të sillemi. Kjo është liria jonë, jeta jonë, e drejta jonë, identiteti ynë dhe njëkohësisht edhe manifestim i imanit tonë.

Që të jemi ambasadore të së vërtetës, duhet ta kemi qëllimin që ta arrijmë kënaqësinë e Atij, i cili e zbriti të vërtetën dhe na i dha të gjitha këto begati dhe të mira që na rrethojnë. Mbulesa është respektim ndaj urdhrave të Allahut dhe të Pejgamberit a.s.. Allahu i Lartësuar

Që të jemi ambasadore të së vërtetës, duhet ta kemi qëllimin që ta arrijmë kënaqësinë e Atij, i cili e zbriti të vërtetën dhe na i dha të gjitha këto begati dhe të mira që na rrethojnë.

na ka obliguar t’i dëgjojmë dhe t’i respektojmë urdhrat e Tij dhe të Dërguarit të tij. Ai thotë: “Kur Allahu ka vendosur për një çështje ose i Dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohej) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër. E kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës.”²

Gruaja në Islam është një qenie shumë e vlefshme që jeton një jetë të dinjitetshme, duke respektuar të gjitha urdhrat që kanë ardhur në Kuran. Islami e çmon atë dhe ngrit në piedestalin më të lartë moral. Zoti i ka urdhëruar besimtarët që të mbulohen: “Thuaju edhe besimtareve



të ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le ta venë shaminë mbi kraharorin e tyre.”³

Është bukur të jetosh me islam, por është edhe më bukur të jetosh duke e bartur mbulesën. Femra me mbulesën e bukur islame është njëzetekatër orë e përlur ndaj Krijuesit të Gjithësisë, njëzetekatër orë ka shpërblime nga i Madhi Zot.

Për mua, mbulesa ka qenë vendimi im. Kam vendosur ta mbaj mbulesën e bukur islame me vetëdëshirë dhe me vetëzgjedhje. Kjo është diçka që më ka sjell mua liri, më ka privilegjuar dhe përmbushur në shumë aspekte jetësore. Mbulesa asnjëherë nuk më ka penguar në jetën time, sepse unë atë e kam përjetuar dhe e përjetoj si pjesë të jetës sime. Është identiteti im, kënaqësia dhe krenaria ime.

Mbulesa asnjëherë nuk më ka penguar në jetën time, sepse unë atë e kam përjetuar dhe e përjetoj si pjesë të jetës sime. Është identiteti im, kënaqësia dhe krenaria ime.

që e ushqejmë trurin me dituri, trupin me ushqime dhe pije, edhe shpirti ka nevojë për ushqim, e besimi është i tillë për shpirtin. Megjithatë, qysh në moshën adoleshente, isha në dijeni se jemi të

obliguar me faljen e namazit, agjërimin e Ramazanit, dhe se femra është e obliguar t'u përmbahet urdhrave të Allahut xh.sh.. Mendimi që më së tepërmi më ka munduar dhe më ka shqetësuar ishte se çka do t'i them unë Zotit, mbasi që i lexova dhe i kuptova ajetet që flasin për mbulesën. Pse nuk e kam vendosur? Nuk kam mundur të vije deri te përgjigjja. E kështu kam filluar bisedat me prindërit e mi rreth kësaj teme. Edhe pse një vajzë shumë e re, mendonin se si do të më pranonte shoqëria dhe rrethi, duke e pasur parasysh se isha vajza e parë me shami në qytetin tim. Mbajtja e mbulesës zgjoi ndjenjën e kënaqësisë, përmbushjes dhe mbrojtjes.

Ditë e bukur xhumaje, në muajin e përzgjedhur Ramazan, unë vendosa mbulesën e bukur islame. Të gjithë ma uruan mbulesën. Më kujtohet shumë mirë kur babai dhe nëna më përqaftuan dhe më pëshpëritën: “Për hair bija jonë kjo veshje e bukur, ti vazhdo rrugën e drejtë me plot krenari. Jemi krenarë për këtë vepër kaq madhështore që veprave.” Për mua ishte momenti, dita, java dhe muaji me një rëndësi të posaçme.

Kam hasur edhe të atillë që e pëlqenin dhe e përkrahnin këtë veprim, por edhe të atillë të cilët mendonin ndryshe. Të gjitha to ide dhe mendime pa fakte janë paragjykime. Paragjykimet vijnë si rezultat i shumë informacioneve dhe i pak dijeve.

Jam shumë e bindur se rruga me një qëllim të sinqertë të çon drejt suksesit, përparimit dhe mbarësisë. Shamia nuk është pengesë por inspirim, nuk është zili por dashuri, nuk është hidhërim por gëzim, nuk është prapambeturi por avancim.

Mbulesa për mua është diçka më shumë se një copë material në kokë. Mbulesa është identiteti im dhe mendoj se ajo është e drejta ime. Mbulesa është stili, paqja, dëlirësia dhe pastërtia ime.

1. *El-En'am*, 153. 2. *El-Ahzab*, 36. 3. *En-Nur*, 31.



PhD (C) Melihate Zeqiri

Bilinguizmi gjuhësor në Ballkan (1)

“Derisa njerëzit të kuptojnë se shumëgjuhësia është një pasuri, atëherë nuk do të ketë asnjë problem në bashkëjetesën mes tyre” – Victor Friedman

Edrejta për gjuhën amtare në përdorimin zyrtar hyn në korpusin e të drejtave themelore të njeriut dhe të kolektivitetit. Qysh mendimtarët e lashtësisë, këtu e dy mijë vjet më parë, përdorimin e gjuhës e formuluan si rregullator të jetës politike. Në pajtim me këtë parim universal për të drejtën e gjuhës amtare, kombet e qytetëruara evropiane kanë miratuar dokumentin e tyre të përbashkët – Kartën evropiane për gjuhët rajonale dhe minoritare (Vjenë, 1993); sipas së cilës gjuhëve të kombësive ose pakicave u jepet një prestigj më i lartë në shoqëritë demokratike dhe u caktohet një përdorim më i gjerë në jetën praktike në të gjitha nivelet: në arsim (në të gjitha shkallët), në administratë, në gjyqësi, në masmedie etj.

Në Maqedoninë më ballkanike të Ballkanit, ku ka një mozaik ylberor e një paralelizëm të fortë natyror gjuhësh, kulturash e religjionesh, e ku fliten të gjitha gjuhët që mund të merren me mend: shqipja, maqedonishtja, turqishtja, bullgarishtja, serbishtja, arumanishtja, greqishtja, romishtja, sefardishtja etj., sipas Kornizës Kushtetuese të Ohrit (2001), gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe shqipja, kjo e dyta vetëm në ato komuna ku shqiptarët përbëjnë mbi 20 për qind të popullsisë, pra jo në gjithë territorin. Statusi i ri i përdorimit të gjuhës shqipe në Maqedoni e përcakton këtë gjuhë jo si gjuhë zyrtare, por si gjuhë të rendit

E drejta për “gjuhën e tjetrit” mbetet ende një problem në Maqedoni, një paranojë dhe frustrim maqedonas se “gjuha e tjetrit” e rrezi-kuaka maqedonishten

të dytë (e pabarabartë me maqedonishten).

Zgjidhja kushtetuese për përdorimin e gjuhës shqipe në Maqedoni, me të cilën shqipja zyrtarizohet si “gjuhë e dytë zyrtare” në bashkësitë lokale ku e flasin mbi 20 për qind, dhe jo si gjuhë bashkëzyrtare, e bara-

bartë me maqedonishten, siç që propozuar fillimisht nga ndërmjetësit ndërkombëtarë të BE-së dhe ShBA-së, tregon se Republika e Maqedonisë është ende larg Evropës demokratike: praktika evropiane nuk njeh vetëm një gjuhë zyrtare. Njohësi i mirë i politikës gjuhësore, Dubravko Skiljan, shprehet: “Realistët nuk duhet të harrojnë se çdo krizë shoqërore është njëkohësisht dhe krizë e komunikimit dhe krizë e gjuhës, dhe ajo mund të përballohet vetëm me ndihmën e komunikimit efikas të shumëgjuhësisë funksionale.”

E drejta për “gjuhën e tjetrit” mbetet ende një problem në Maqedoni, një paranojë dhe frustrim maqedonas se “gjuha e tjetrit” e rrezi-kuaka maqedonishten, që është krejt e kundërt me qasjet ndaj këtij problem në Evropë, ku mëton të hyjë dhe Maqedonia si shtet. Maqedonia është vendi me pasurinë më të madhe të gjuhëve dhe të bashkësive etnike në Evropë dhe, njëkohësisht, është



Kur mbrohen me ligj 19 speciet e peshqve në liqenin e Ohrit dhe të Prespës nga zhdukja e tyre, atëherë si të mos mbrohen me ligj dhe 23 gjuhët e tjera që fliten në Maqedoni!?

vendi me demokraci më të pazhvilluar linguistike në Evropë, ku e drejta për përdorimin zyrtar të gjuhës së tjetrit ende shikohet me racizëm dhe primitivizëm.

Sikurse pohon sllavisti i njohur Volf Oshlis: “Në Maqedoni, përveç maqedonasve, jetojnë dhe 23 bashkësi të tjera etnike”. Fakti që në një vend kaq të vogël fliten kaq shumë gjuhë, përbën një dukuri të rrallë në Evropë. Pluraliteti i etnive, i gjuhëve, i kulturave dhe i religjioneve përbën pasurinë më të madhe të këtij vendi të quajtur Maqedoni, kështu që

maqedonasit duhet të jenë të aftë t'i shmangin rreziqet e njëgjuhësisë. Kur mbrohen me ligj 19 speciet e peshqve në liqenin e Ohrit dhe të Prespës nga zhdukja e tyre, atëherë si të mos mbrohen me ligj dhe 23 gjuhët e tjera që fliten në Maqedoni por të mbrohet me ligj vetëm një gjuhë – maqedonishtja?! Kjo i bie njësoj sikur në Liqenin e Ohrit dhe të Prespës të mbrohej vetëm një specie e peshkut.

Në prag të miratimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, gjuha e tjetrit në Maqedoni ende shikohet si “dimër” (Me gjuhën shqipe “dimrin” e kemi prapa – shprehej një e përditshme maqedonase “Spic”), e jo si një e drejtë themelore shoqërore. Pra, në mënyrë të figurshme, gjuha maqedonase na qenka “pranverë”, diçka si lule, kurse gjuha shqipe na qenka “dimër”, diçka e ftohtë, e padurueshme. Farkuesit e kësaj ideje idiotike, me ngushtësi mendore, duhet ta kenë të qartë se rruga për në Evropën demokratike e shumëkulturnore nuk kalon vetëm përmes ndërrimit të emrit mitik Maqedoni, që u kushtëzua nga fqinji grek, por në radhë të parë përmes divesitetit linguistik, jo të dominancës së një gjuhe zyrtare në një shoqëri shumë-etnike sikundër është Maqedonia.

Njohësi i mirë i gjuhëve, por dhe i mentalitetit, historisë dhe rrjedhave shoqërore në Ballkan, sociolinguisti dhe ballkanologu i shquar amerikan Viktor Friedman, shprehet: “Nga pikëpamja gjuhësore, konstatohet se popujt mund të jetojnë mirë së bashku, pasi vetë ngjashmëritë gramatikore të gjuhëve në Ballkan, apo edhe dasitë e tyre, tregojnë se popujt kanë jetuar së bashku dhe mund të vazhdojnë bashkëjetesën. Mua më duket se shumëgjuhësia është pasuri. Në vendet ku njerëzit e etniteteve të ndryshme jetojnë së bashku, ata mësojnë gjuhët e njëri-tjetrit, për shembull Dibra, ku maqedonasit dhe shqiptarët i flasin gjuhët e njëri-tjetrit. Kur njerëzit të kuptojnë se shumëgjuhësia është një pasuri, atëherë nuk do të ketë asnjë problem në bashkëjetesën mes tyre”.

Shqiptarët si popull i vogël i ka mbajtur gjallë gjuha e madhe shqipe. Kjo gjuhë është kryeshenja e identitetit shqiptar, e me veçantitë e saj është gjithashtu dhe një nga kryeshenjat e identitetit evropian dhe identitetit linguistik në Maqedoni, paçka se klasa politike maqedonase, me mundësi mesjetare, nuk denjon as ta njohë me këtë emër – por me një emër të përcudnuar si “gjuhë që flitet nga 20 për qind e popullsisë”.



Sot të gjithë flasim mbi identitetin e Evropës. Baza e idesë evropiane mbështetet në dy kërkesa themelore dhe të pandashme: universalitetin e vlerave morale të përbashkëta dhe diversitetin e shprehive kulturore dhe veçanërisht, diversitetin gjuhësor. Ky i fundit, për arsye historike përbën një mjet të mrekullueshëm integrimi dhe harmonizimi, i cili ka ndikim mbi jetën e qytetarëve, mbi cilësinë e raporteve mes kombeve evropiane, mbi marrëdhëniet e kontinentit me pjesën tjetër të botës, bashkëzistencën harmonike të kulturave në gjirin e shoqërive tona, me qëllim mirëfunksionimin e institucioneve dhe ecjen përpara në drejtim të konsolidimit të ndërtimit evropian. Të gjithë duhet të kemi parasysh që Evropa është ndërtuar pas shumë shekujsh konfliktesh midis kombeve, e sidomos, mes fqinjëve. Të mësoh gjuhën e një partneri të sotëm, por njëkohësisht armikut të dikurshëm, është një akt i rëndësishëm me domethënie simbolike dhe dobi praktike – thotë publicistja Ivana Tomço në një shkrim të saj me titull “Gjuha e tjetrit”.

E kundërta e idesë evropiane është ideja ballkanike, e përtej kësaj dhe ideja maqedonase, kur gjuha e tjetrit (maq. jazikot na drugiot, ang. the language of the other) perceptohet edhe sot jo si një vlerë, por si “gjuhë e armikut”, si antivlerë. Në shtetet ballkanike, në Greqi dhe në Bullgari p.sh. nuk njihen pakicat kombëtare me kushtetutë, e rrjedhimisht nuk njihen as gjuhët e pakicave etnike. Domethënë këto dy shtete “nuk kanë problem gjuhësorë” sepse i kanë zgjidhur me mohimin e tyre në zanafillë! Ndërkaq, në Maqedoni, gjuha e tjetrit shihet si një referencë që prish kohezionin e Maqedonisë! P.sh. gjuha shqipe që flitet këtu në terrenin e saj autokton zyrtarisht nga 25 për qind e popullsisë, në përdorimin zyrtar a publik jo vetëm që nuk e ka statusin e barabartë me maqedonishten, por në Kushtetutë as nuk emërohet me emrin e saj të vërtetë si “gjuha shqipe” (sepse kjo i frikëson

maqedonasit!), por si “gjuha që e flasin 20 për qind e popullsisë”. Në përdorimin publik, gjuhët kanë status të barabartë me standarde linguistike demokratike evropiane vetëm në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Malit të Zi. Në këtë pikëpamje, Kosova dhe Mali i Zi mund të thuhet se linguistikisht janë pjesë e Evropës linguistike demokratike, me qytetërimin gjuhësor perëndimor, kurse shtetet e tjera të

Gjuha shqipe në truallin e saj në Maqedoni është një pasuri e madhe jo vetëm për shqiptarët, por edhe për maqedonasit; ashtu sikurse dhe maqedonishtja që është një pasuri e madhe edhe për shqiptarët e jo vetëm për maqedonasit.

rajonit janë ende me qytetërimin ballkanik, që mohojnë gjuhën e tjetrit.

Sikurse thotë gjenerali i letërsisë Ismail Kadare: “Në Ballkan tragjedia e gjuhës ka vazhduar deri në ditët tona. Në qytetërimin tonë ballkanik, racizmi fillestar rrjedh nga gjuha dhe jo nga ndryshimi i ngjyrës së lëkurës, as nga dallimet midis zakoneve, as nga mizoritë”. Kjo lojë vazhdon të luhet edhe deri në ditët tona. Shqiptarët fatmirësisht nuk kanë pasur urrejtje ndaj gjuhës së tjetrit. Ballkanasit sot, si dhe në të kaluarën,

kanë nevojë për më shumë gjuhë, jo për më pak gjuhë. Sepse shuma është pasuri, paka është varfëri.

Gjuha shqipe në truallin e saj në Maqedoni është një pasuri e madhe jo vetëm për shqiptarët, por edhe për maqedonasit; ashtu sikurse dhe maqedonishtja që është një pasuri e madhe edhe për shqiptarët e jo vetëm për maqedonasit. Vetëm se bartësit e gjuhëve respektive duhet të zhvishen sa më parë nga patriotizmi lokal primitive që i sundon paradoksalisht edhe sot. Sidomos elitat politike dhe ato akademike. Linguistët, letrarët, intelektualët dhe publicistët maqedonas edhe sot sikur nuk kanë guxim të shprehen publikisht se e drejta e përdorimit të gjuhës shqipe në Maqedoni është një e drejtë universale, që nuk i dëmton aspak maqedonasit dhe gjuhën e tyre maqedonishten; kjo sepse druajnë se nga pala e tyre e orientuar në pozicionin “antishqipe” do të etiketoheshin për “tradhti kombëtare”, mendja e tyre se Maqedonia u takon vetëm atyre. E rrjedhimisht në Maqedoni duhet të përdoret vetëm një gjuhë zyrtare – maqedonishtja! Me çfarë mendësie përpiqen të ndërtojnë të tashmen dhe të ardhmen linguistike të shoqërisë multietnike e multigjuhësore në Maqedoni, me një ideologji regresiste që e ka zbatuar vetëm fashizmi!

Për ndjesinë ndaj gjuhës së tyre që kanë kombet evropiane mjafton të sjellim këtë fakt relevant: Konfederata zvicerane në aspektin e politikave linguistike është një “aparati i çuditshëm”: shtatë milionë banorë flasin 4 gjuhë të ndryshme, me status të barabartë zyrtar: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retoromanisht. Madje, dhe për emërtimin e vendit përdoret latinishtja Confoederatio Helvetica, në mënyrë që t’i iket favorizimit të njëres prej katër gjuhëve zyrtare të Zvicrës. Nga kjo zgjidhje linguistike, Zvicra e vogël asgjë nuk humbet ngaqë nuk ka një gjuhë zyrtare të vetme.

Dr.Sci Agron M. Rexhepi

Nevojat energjetike të organizmit (2)

Sa më shumë që një person të jetë fizikisht aktiv, aq më të mëdha do të jenë nevojat e tij energjetike, si dhe sa më e madhe të jetë masa muskulore, aq më e madhe do të jetë energjia dalëse.

I. Energjia e shpenzuar gjatë aktiviteteve fizike

Ruga e dytë e shpenzimit të energjisë hyrëse, e që ka rën-dësi në caktimin e raportit ndërmjet energjisë hyrëse dhe energjisë dalëse (me rastin e përpilimit të programit nutritiv), është aktiviteti ynë fizik brenda ditës. Aktivitetet fizike ndikojnë 20 – 30% në shpenzimin e energjisë së përgjithshme trupore.

Çdo punë apo aktivitet fizik rrit shpenzimin e energjisë në organizëm. ^(1,2,4) Ndërkaq, sasia e energjisë, që do të shpenzohet gjatë aktivitetit fizik, varet nga intensiteti dhe kohëzgjatja e

aktivitetit, respektivisht e punës fizike. ^(1, 3, 4, 5)

Sa më shumë që një person të jetë fizikisht aktiv, aq më të mëdha do të jenë nevojat e tij energjetike, si dhe sa më e madhe të jetë masa muskulore, aq më e madhe do të jetë energjia dalëse.

II. Tretja e ushqimit (efekti termik)

Forma e tretë e energjisë dalëse, respektivisht e shpenzimit të ener-gjisë, është sasia e energjisë, e nevojshme për tretjen e ushqimit (efekti termik i ushqimit). Sasia e kësaj energjie mendohet se është e barabartë me 10 % të energjisë hyrëse, respektivisht 10% të

sasisë së energjisë që merret përmes ushqimit. ^(4,6) P.sh., nëse një person konsumon ushqim në sasi 2500 kcal, energjia e nevojshme për tretjen e kësaj sasive të ushqimit do të jetë 250 kcal (efekti termik = 250 kcal).

Nevojat ditore energjetike (NDE)

Metodë e kalkulimit të nevojave ditore energjetike të një entiteti është kur kalkulohet së pari metabolizmi bazal i tij duke pasur parasysh shumë faktorë që kanë ndikim në të (lartësia trupore, pesha trupore, mosha dhe gjinia). Më pastaj, kjo vlerë e metabolizmit bazal shumëzohet me koeficientin e nivelit të aktivitetit fizik që bën entiteti dhe fitohet vlera e nevojave ditore energjetike. Kjo mënyrë e vlerësimit të NDE-së bëhet duke u shërbyer me ekuacionin e Harris-Benedictit.

Pra, llogaritja e NDE-së, sipas ekuacionit të Harris-Benedictit, bazohet në prodhimin ndërmjet metabolizmit bazal (MB) dhe koeficientit të aktivitetit fizik që bën një entitet (kAF). Faktori i vetëm që është lënë anash këtij ekuacioni është masa pa dhjamë e trupit, e cila masë kërkon më tepër kalori krahasuar me masën dhjamore. Për këtë shkak, ky ekuacion mund të përdoret tek të gjitha entitetet, përjashtuar ato me masë të madhe muskulore (do të nënvlerësohen kaloritet e nevojshme), dhe tek entitetet me masë të tepërt dhjamore (do të mbivlerësohet sasia e kalorive të nevojshme). ⁽⁶⁾

$$NDE = MB \times kAF$$

Lloji i sportit	Shpenzimi i energjisë
Skijimi	600 kcal
Basketbolli	600 kcal
Vrapimi (8.5 km/h)	570 kcal
Kërcimi	550 kcal
Noti	500 kcal
Alpinizmi	500 kcal
Gjimnastika	450 kcal
Çiklizmi	410 kcal
Ecje e shpejtë (6 km/h)	300 kcal
Ecje e lehtë (4.2 km/h)	200 kcal

Tabela 2. Shpenzimi i energjisë (kcal) gjatë 30 minutave të aktiviteteve e caktuara fizike

Lloji i punës fizike	Shpenzimi i energjisë kilokalori/minutë
Larja e enëve	1.4 kcal/min
Larja e rrobave	1.8 kcal/min
Pastrimi i dyshemesë	3.5 kcal/min
Punët administrative	1.2-1.9 kcal/min
Gjumi-pushimi në shtrat	0.7-1.2 kcal/min
Ulur-dëgjim muzike	1.2 kcal/min
Noti	9.7 kcal/min
Skijimi	14.5-17.9 kcal/min

Tabela 3. Paraqitja tabelore e shpenzimit të energjisë gjatë disa aktiviteteve fizike

MB për meshkuj = $66 + (13.7 \times Pt) + (5 \times Lt) - (6.8 \times \text{mosha})$;

MB për femra = $655 + (9.6 \times Pt) + (1.8 \times Lt) - (4.7 \times \text{mosha})$;

Sipas Harris-Benedictit, vlera e koeficientit të aktivitetit fizik (kAF) ndryshon varësisht nga niveli i aktivitetit fizik që bën entiteti:

- Të ndenjurit ulur (aktivitete fizike shumë të pakta, apo mungojnë fare – puna në tavolinë) = 1.2;
- Aktivitete fizike të lehta (stërvitje apo sport i lehtë 1 - 3 ditë në javë) = 1.375;
- Aktivitete fizike mesatare (stërvitje apo sport mesatar 3 – 5 ditë në javë) = 1.55;
- Aktivitete fizike intensive (stërvitje apo sport i rëndë 6 – 7 herë në javë) = 1.725;
- Aktivitete fizike tejet intensive (punë fizike, stërvitje apo sport tejet i rëndë që bëhet 2 herë në ditë, apo maratona) = 1.9.

Shembulli 5:

Të llogaritet NDE-ja për mashkullin N.N., të moshës 20 vjeçare, me lartësi trupore 170 cm, peshë trupore 65 kg, dhe që bën aktivitet fizik mesatar.

Së pari, duhet të kalkulojmë vlerën e metabolizmit bazal (MB):

MB për meshkuj = $66 + (13.7 \times Pt) + (5 \times Lt) - (6.8 \times \text{mosha})$

MB = $66 + (13.7 \times 65) + (5 \times 170) - (6.8 \times 20) = 66 + 890.5 + 850 - 136 = 1670.5$ kcal

Në bazë të ekuacionit të Harris-Benedictit, koeficienti për aktivitetet fizike (kAF) të nivelit mesatar është 1.55.

Tani, pasi që e kemi kalkuluar vlerën e MB-së dhe e dimë vlerën e kAF, do ta kalkulojmë nevojën ditore energjetike të entitetit në fjalë:

NDE = MB x kAF = $1670.5 \times 1.55 = 2589.3$ kcal

Si përfundim, mund të nxjerrim se për entitetin e gjinisë mashkullore, të moshës 20 vjeçare, me lartësi trupore 170 cm, peshë trupore 65 kg, dhe që bën aktivitet fizik të nivelit mesatar, nevojat ditore energjetike janë 2589.3 kcal. Me fjalë të tjera, energjia hyrëse ditore, që merret përmes gjërave ushqimore për të ruajtur kompozicionin

momental trupor të entitetit, duhet të jetë 2589.3 kcal.

Humbja e peshës

Në rast se dëshirohet të arrihet humbje e peshës trupore, atëherë duhet që NDE-të të zvogëlohen për 500 – 1000 kcal (varësisht nga pesha momentale që ka). Ky deficit i kalorive ditore do të favorizonte djegien e yndyrave të deponuara, ndërsa arrihet përmes dietës në ushqim, aktiviteteve fizike, apo kombinimit të të dyjave. Preferohet që për fillim të fillohet me zbritje të NDE-së për 15-20%. Nëse brenda një jave sasia e përgjithshme energjetike zvogëlohet për 3500 kcal, do të kemi humbje të peshës trupore për 450-500 gramë për një javë. Nëse deficit i sasisë së përgjithshme energjetike, për një javë, arrin në 7000 kcal, atëherë do të humbet afërsisht 1 kg peshë trupore. Sipas ACSM-së (American College of Sports Medicine) kurrë nuk duhet që NDE-të për femra të zvogëlohen ndër 1200 kcal, respektivisht për meshkuj ndër 1800 kcal. ^(10, 40, 5)

Shembulli 6

humbja e peshës:

Personi N.N. me peshë trupore 65 kg dhe me nevoja ditore energjetike NDE=2589.3 kcal;

Deficiti kalorik = 20% të NDE = $2589.3 \text{ kcal} \times 20\% = 517.86$ kcal;

Për të zvogëluar peshën trupore, personi N.N. me NDE=2589.3 kcal duhet të zvogëlojë NDE në 2071.44kcal (NDE-20% = $2589.3 \text{ kcal} - 517.86 \text{ kcal} = 2071.44$ kcal).

Pra, sasia maksimale e kalorive ditore, që duhet të merren, është 2071.44 kcal/ditë.

Shtimi i peshës

Për të rritur peshën trupore duhet të veprohet ngjashëm si në rastin e zvogëlimit të peshës trupore, por në drejtim të kundërt - me fjalë të tjera, duhet të prishet ekuilibri i energjisë hyrëse dhe i energjisë dalëse në kuptimin pozitiv. Sasisë së përgjithshme të NDE-ve duhet t'u shtohen afërsisht 300 – 500 kcal, apo NDE-të të rriten për 15 – 20%.

Shembulli 7

shtim i peshës trupore:

Personi N.N. me peshë trupore 65 kg dhe me NDE = 2589.3 kcal;

Suficiti kalorik = 20% të NDE = $2589.3 \times 20\% = 517.86$ kcal;

Për të shtuar peshën, personi N.N. me NDE = 2589.3 kcal duhet të shtojë NDE në 3107.16 kcal ($2589.3 \text{ kcal} + 517.86 \text{ kcal} = 3107.16 \text{ kcal}$).

Në përgjithësi, nuk këshillohet që të bëhen ndryshime drastike, të përnjëhershme, në dietë. P.sh., nëse për një kohë të gjatë një person ka pasur NDE të vogla, nuk duhet të praktikohet marrja e përnjëhershme dhe e lartë e kalorive ditore. Kjo ka rëndësi pasi që një person me NDE të ulëta e ka nivelin e ulët të metabolizmit, dhe nëse përnjëherë zbatohet rritja e kalorive hyrëse, atëherë e tërë pesha e shtuar do të shkojë në favor të rritjes së indit dhjamor. Në këto raste, preferohet që për disa javë rritja e kalorive ditore, të marra, të bëhet në mënyrë graduale, krejt kjo me qëllim të adaptimit të metabolizmit. Mënyra më e mirë për të shtuar peshën trupore është që kaloritë e tepërta të merren përmes karbohidrateve komplekse, perimeve të gjelbra dhe pemëve, si dhe të bëhen aktivitete të rregullta fizike dhe stërvitje të forcës (me qëllim të moslejimit që pesha e shtuar trupore të shkojë në favor të shtimit të masës dhjamore). Më së miri është që shtimi i peshës trupore të bëhet gradualisht, duke shtuar masën muskulore, e jo masën dhjamore, madje jo më shumë se 250-300 gramë në javë. Preferohet që ushqimi, brenda ditës, të merret në sasi të vogla dhe në racione të shpeshta, të mos pihen kafeja dhe alkooli, të mos hahen ushqimi i përpunuar, sheqeri i bardhë, mish i kuq dhe yndyrat shtazore, si dhe të mos pihet duhani dhe të shmangen vendet e mbyllura ku pihet duhani.

REFERENCA

1. Burke L. Deakin V. *Clinical sports nutrition*, 2000. 2.
- Clark N. *Sportska Prehrana*. Zagreb, 2000. 3. Rexhepi A. *Mjekësia Sportive*. Prishtinë, 2009. 4. Rexhepi A. *Nutricioni dhe Sportistët*, Prishtinë, 2010. 5. http://sportsmedicine.about.com/od/fitnessavalandassessment/a/Body_Fat_Comp.htm. 6. <http://www.onlinestudy.oxfordcollege.ac/coursehome.aspx?cid=67>. 7. <http://en.wikipedia.org/wiki/Malnutrition>. 8. <http://www.who.int/topics/obesity/en/>.

Deklarata përmbyllëse e Forumit të Tetë Ndërkombëtar për Promovimin e Paqes

Nën patronazhin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, shejh Abdullah bin Zajed al-Nahjan, nga data 5-7 dhjetor 2021, në Abu Dhabi u mbajt Forumi i Tetë Ndërkombëtar për Promovimin e Paqes me temë kryesore “Qytetaria gjithëpërfshirëse nga ekzistenca e përbashkët në ndërgjegjen e përbashkët”.

Forumi filloi punimet në mëngjesin e datës 05 dhjetor në Abu Dhabi, ndërsa ceremonia inauguruese zyrtare u mbajt në mbrëmje në ambientet e EXPO¹ 2020 në Dubai.²

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë ministrja për Bashkëpunim Ndërkombëtar, njëherësh drejtoresha e përgjithshme e zyrës “Expo 2020” znj. Reem bint Ibrahim al-Hashemi, sekretari i përgjithshëm i Lidhjes Botërore Islame “RABITA”, dr. Muhamed bin Abdul Kerim al-Isa, ministri federal për Çështjet Fetare dhe Harmoninë Ndërfetare në Republikën e Pakistanit, shejh Noor al-Hak Kadri, kryetari i Këshillit të Emirateve për Fetva të Sheriatit, shejh Abdullah bin Bayah, shefi i Departamentit të Zhvillimit të Komunitetit në Abu Dabi, dr. Mugher Khamis al-Khalili, si dhe ministra, përfaqësues të qeverisë, liderë fetarë të besimeve dhe sektete të ndryshme, personalitete të nivelit të lartë, mendimtarë, akademikë, studiues nga e mbarë bota.

Në këtë forum, mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga shefi i kabinetit të tij, mr. Besim ef. Mehmeti.

Sesionet e forumit trajtuan qasje të ndryshme, më të rëndësishmet prej të cilave ishin:

Përcaktimi i konceptit të "qytetarisë gjithëpërfshirëse" përmes një diskutimi të konteksteve të fillimit të saj dhe rrugëve të zhvillimit;

Shtirirja e urgjencës dhe nevojës për "qytetari gjithëpërfshirëse", duke iu përgjigjur pyetjeve të komponentëve të vlerave të qytetarisë, si dhe duke krijuar hapësirë për rrënjësje legjitime;

Roli pozitiv i fesë në ndërtimin e qytetarisë;

Diskutimi rreth sfidave me të cilat përballen njerëzit si qytetarë të planetit Tokë.

Pjesëmarrësit studiuuan modele pozitive të bashkëjetesës, tolerancës dhe qytetarisë gjithëpërfshirëse në Emiratet e Bashkuara Arabe, Finlandë, Singapor dhe Egjipt.

Sesioni i fundit shkencor iu kushtua diskutimit të mundësive për të bërë një botë më të mirë, duke shikuar se si kartat dhe deklaratat mund të kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë.

Forumi i këtij viti ishte një mundësi për të paraqitur modele të suksesshme për realizimin e konceptit të shtetësisë, duke rishikuar dokumentet, deklaratat dhe statutet që kontribuuan në formimin e një kuptimi të ri të shtetësisë, siç janë: Deklarata e Marrakeshit (2016), Dokumenti i Vëllazërisë Njerëzore (2019), Dokumenti i Mekës Al-Mukarramah (2019), Aleanca e re e Virtyteve (2019) si dhe Wilton Park Dialogët mbi Shtetësinë Gjithëpërfshirëse (2018-2021).

Forumi aspironte të dalë me një dokument gjithëpërfshirës që merr frymëzim nga të përbashkëtat fetare dhe njerëzore, dhe kontekstet bashkëkohore qytetëruese për një botë më të mirë, në të cilën mbi-zotërojnë virtytet dhe vlerat e bashkëjetesës, solidaritetit dhe ndërgjegjes së përbashkët.

Andaj pas punimeve dhe diskutimeve, në sesionin përmbyllës pjesëmarrësit në këtë forum ndërkombëtar nxorën Deklaratën përmbyllëse siç vijon:

Deklarata përmbyllëse e Forumit të Tetë Ndërkombëtar për Promovimin e Paqes

Abu Dhabi, 30 Rabi' al-Thani deri në 2 Xhumada el-Evvel 1443 H / 04-07 dhjetor 2021.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, dhe lutjet dhe paqja qofshin mbi zotërinë tonë, Muhamedin, i cili u dërgua si mëshirë për botët, dhe për vëllezërit e tij nga profetët dhe të dërguarit, dhe për të gjithë familjen dhe shokët e tij; Duke u nisur nga ajetet kuranore :

“A nuk e sheh se Allahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme, e edhe nga malet ka të bardha e të kuqe, ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe nga



njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Allahut, i frikësohen vërtet nga robërit e Tij vetëm dijetarët, Allahu është Fuqplotë dhe Falës.”³

Dhe në përgjigje të sfidave ekzistenciale me të cilat përballet njerëzimi në tërësi, si pasojë e epidemisë së re Covid-19 “Korona”, e cila ndryshoi programet dhe planet e njerëzimit, riorganizoi prioritetet e tij dhe vuri në dyshim orientimet e vlerave.

Të ndërgjegjshëm se realiteti i ri e ka ngritur qytetarin në nivelin e të gjitha kohërave, gjë që kërkon kërkime më sistematike për të arritur në një formulë model, që paraqet koncepte të reja të qytetarisë gjithëpërfshirëse, të nxjerra nga tekstet fetare dhe duke marrë parasysh kontekstin bashkëkohor qytetëruar të përfaqësuar në kushtetutat kombëtare dhe konventat ndërkombëtare.

Takimi i tetë vjetor i Forumit për Promovimin e Paqes në Shoqëritë Myslimane me temë "Shtetësia Gjithëpërfshirëse: Nga Ekzistenca e Përbashkët në Ndërgjegjen e Përbashkët" u mbajt në Abu Dhabi nga 30 Rabi' al-Thani deri në 2 Xhumada el-Euval 1443 h., që korrespondon me datat 04 deri në 07 dhjetor 2021, nën sponsorizimin e vazhdueshëm bujar të shkëlqesisë së tij, sheikh Abdullah bin Zajed al-Nahjan, ministër i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara

Arabe – (Zoti e ruajte) - dhe nën mbikëqyrjen dhe ndjekjen e shkëlqesisë së tij, sheikh Nahjan bin Mubarak al-Nahjan, ministër i Tolerancës dhe Bashkëjetesës në Emiratet e Bashkuara Arabe, dhe i kryesuar nga shkëlqesia e tij, sheikh Abdullah bin Beja, kryetar i Forumit për Promovimin e Paqes në Shoqëritë Muslimane dhe kryetar i Këshillit të Emirateve për Fetva të Sheriatit.

Forumi priti qindra pjesëmarrës, duke përfshirë ministra, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, zyrtarë të organizatave islame, ambasadorë, përfaqësues të organeve qeveritare, qendrave dhe organizatave ndërkombëtare, myfti, studiues, gjyqtarë, udhëheqës fetarë, intelektualë, figura akademike, parlamentare e të tjerë.

Sesionet dhe punimet e Forumit u ndoqën gjithashtu nga mijëra ndjekës përmes platformave elektronike dhe faqeve të rrjeteve sociale. Konferenca u hap në ambientet të Expo 2020 në Dubai, me një fjalim nga shkëlqesia e tij, sheikh Nahjan bin Mubarak al-Nahjan, anëtar i Kabinetit Qeveritar, ministër i Tolerancës dhe Bashkëjetesës dhe komisioneri i Përgjithshëm i Expo 2020 Dubai, në të cilin ai deklaroi: “Teksa shteti i Emirateve të Bashkuara Arabe, feston pesëdhjetëvjetorin e themelimit të tij, i ka vendosur vetes një synim madhor në pesëdhjetë vitet e ardhshme, që do të mbetet gjithmonë ky shtet, një shtet që merr vlerat dhe parimet

njerëzore si bazë të fortë në rrugëtimin e tij, dhe në atë mënyrë që në të, të theksohen gjithmonë vlerat e tolerancës, bashkëjetesës, ndërvlerësive dhe drejtësisë, dhe të ketë përpjekje për të arritur të mirën për të gjithë, pa dallim apo diskriminim.”

Sesioni i fundit shkencor iu kushtua diskutimit të mundësive për të bërë një botë më të mirë, duke analizuar se si mund konventat dhe deklaratat të kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë.

Pjesëmarrësit në forumin e tetë të Forumit për Promovimin e Paqes, pasi shkëmbyen mendime mbi çështjet e studiuara, duke u thirrur në specifikën e situatës globale dhe hapjen e perspektivave të shoqërisë njerëzore ndaj të gjitha mundësive të dëshiruara, por dhe të atyre që paraqesin rrezik dhe kërcënim, përfunduan si në vijim:

Së pari - Rezultatet:

Shtetësia në konceptin historik bazohej në racën, fenë, kujtesën e përbashkët ose elementin e pastërtisë së prejardhjes, gjë që çon në ndarjen e qytetarëve në shkallë, siç ishte rasti me romakët apo arabët në epokën paraislamike.

Në kohët moderne, dhe në kontekstin e asaj që njerëzimi ka avancuar duke kontaktuar dhe komunikuar, dhe mbizotërimit të veçorisë së diversitetit në të gjitha

vendet e botës, shtetësia është bërë një zgjedhje vullnetare në mënyrë kontraktuale, që i garanton qytetarit më të ri, të njëjtat të drejta që kishte anëtari më i vjetër. Nuk ka dallim mes të parit, të fundit, vendasit apo ardhacakut.

Koncepti i nënshtetësisë është vendosur si një lidhje ose lidhje fakultative e mbajtur në një horizont kombëtar të qeverisur nga kushtetuta, që kapërcen fraksionizmin dhe ndarjen në baza fisnore, por jo domosdoshmërisht i shfaqur, por ajo që kërkohet është përshtatja dhe bashkëjetesa me ata në një bashkëjetesë të lumtur.

Globalizimi bashkëkohor ka sjellë një ndërgjegjësim të thellë të shkallës së ndërthurjes midis fateve të njerëzve dhe situatave të tyre, si dhe shkaqeve të reja në botën e globalizuar të përzierjes kulturore dhe të jetesës së ndërlidhur, gjërat që kërkonin të menduarit për qytetarinë lokale në horizontin e qytetarisë globale.

Realiteti ka vërtetuar se parimi i qytetarisë ka nevojë për një hulumtim më sistematik për të arritur në një formulë model që paraqet koncepte të reja të qytetarisë gjithëpërfshirëse, të nxjerra nga tekstet fetare dhe duke marrë parasysh kontekstin bashkë-kohor qytetëruar.

Koncepti i qytetarisë gjithëpërfshirëse bazohet në transcendencën mbi pranimin e thjeshtë në njohje të ndërsjellët, me anë të së cilës ngush-tësia e vetvetes kapërcehet në hapësirën e së përbashkëtës dhe kalon nga identitetet kritike në unitetin e gjerë, unitetin e bashkësisë së madhe të njerëzimit.

Koncepti i qytetarisë gjithëpërfshirëse është i lidhur me shpirtin e pasagjerëve të së njëjtës anije, siguron që frytet e mendjes të përdoren për të mirën e të gjithëve, dhe krijon konkurrencë pozitive midis përbërësve të familjes njerëzore në ofrimin e mikpritjes Abrahamike mbi dinjitetin njerëzor.

Koncepti i qytetarisë gjithëpërfshirëse bazohet në rrënjosjen - thellimin e parimit të qytetarisë që përfaqëson diversitetin, përmes një kuptimi dhe vlerësimi të duhur të trashëgimisë fetare dhe praktikave historike duke akomoduar ndryshimet që kanë ndodhur në botë.

Feja nuk kundërshton atë që ka arritur përvoja njerëzore në konceptin e saj

modern të qytetarisë, por e ngrit dhe e rrit atë me frymën morale me të cilën e formëson.

Ne duhet të tejkalojmë këndvështrimin përjashtues të kontributit fetar në ndërtimin e një modeli kreativ të qytetarisë, në përputhje me natyrën e mjedisëve për të cilat synohet, në dritën e ndryshimeve në strukturën shoqërore në botë dhe asaj që është bërë e njohur si rikthimi i fesë.

Identiteti kombëtar është një mjet që shpreh partneritetin njerëzor dhe interesin e përbashkët mes njerëzve të të njëjtit komb. Ndërsa për të gjitha përkatësitë e tjera, si feja, etnia dhe familja, ato janë përkatësi që shprehin një partneritet ndërmjet anëtarëve të të njëjtit grup, por nuk e justifikojnë klasifikimin e tyre në kategori konfliktuale, veçanërisht kur bëhet fjalë për përkatësinë fetare.

Fetë nuk bëjnë thirrje për solidaritet ekstremist të verbër me anëtarët e së njëjtës fe, në kurriz të solidaritetit me anëtarët e shoqërisë "me të afërmit dhe me fqinjët", por ato bëjnë thirrje për solidaritet me qeniet e tjera njerëzore për të arritur universalitetin e besimit dhe vëllazërinë njerëzore.

Gjuha e fesë duhet të përkthehet në gjuhën e hapësirës publike gjithëpërfshirëse, në gjuhën e jetës civile dhe të së drejtës, dhe të huazohet nga tekstet e historisë për t'i zbritur - praktikuar ato në epokën e sotme, duke ruajtur gjuhën e çdo epoke, kohën e saj, dhe mjedisin hapësinor. Leximi i teksteve dhe mbledhja e të ndryshmeve të tyre, si dhe krahasimi i tyre me mendimet dhe parimet që ka arritur njerëzimi, i shërbejnë interesave njerëzore.

Të gjitha përpjekjet themelore duhet të drejtohen për ta bërë përkatësinë fetare një nxitje për mishërimin e qytetarisë dhe për të neutralizuar ndikimin negativ të faktorit të dallimit fetar mbi të.

Pajtimi ndërmjet identitetit fetar dhe atij kombëtar varet nga evidentimi i referencës reciproke ndërmjet fesë dhe laikes në fe, pra ndërmjet interesave njerëzore dhe vlerave fetare.

Shteti kombëtar që përfaqëson diversitetin në format dhe imazhet e tij të ndryshme, ka të njëjtin legjitimitet që ekzistonte në historinë e shtetit perando-

rak, bazuar në ligjin e sjelljes së interesave dhe largimit të këqijave.

Qytetaria gjithëpërfshirëse është përgjigja e duhur ndaj politikës së identiteteve kontradiktore dhe konfliktuale, dhe përfaqëson një model të dyfishtë besimi të hapur ndaj pafundësisë së mëshirës gjithëpërfshirëse të Zotit për të gjitha krijesat e Tij, dhe ndaj një angazhimi kombëtar që synon të mirën e të gjithë njerëzimit.

Të drejtat që iu jepen të gjithëve nga shtetësia, në mënyrë që ato të vendosen në mënyrë të qëndrueshme, duhet të paraqiten në kuadrin e një kontrate shoqërore të bazuar në arritjen e një sërë ekuilibrash, jo vetëm nga pikëpamja juridike, por nga pikëpamja shpirtërore, si dhe nga pikëpamja psikologjike.

Qytetaria - shtetësia është më shumë se një njohuri dhe parime që mësohen, ajo është një sjellje dhe një praktikë që fitohet përmes edukimit, e cila ka të bëjë me rafinimin e sjelljeve, korigjimin e sjelljeve dhe përmirësimin e moralit. Njëpërmjet edukimit, njeriu fiton mënyra të jetesës në komunitet dhe vlerat e qytetarisë janë të rrënjësura në personalitetin e tij.

Aktivizimi i qytetarisë gjithëpërfshirëse kërkon një qasje të kujdesshme të bazuar në një kërkim të plotë për përshtatshmërinë dhe harmonizimin midis kërkesave të realitetit të ri, realitetit të globalizimit dhe vlerave, realitetit të përzierjes civilizuese dhe të jetesës së lidhur, dhe midis kërkesave të privatësisë dhe kërkesat e lokalitetit.

Çdo qasje që garanton drejtësinë e zbatimit të parimit të qytetarisë gjithëpërfshirëse duhet të vendos një ekuilibër midis tre përcaktuesve: kontekstit global dhe normativitetit global, kontekstit lokal, si dhe strategjisë së paqes si kornizë në të cilën duhet të zhvillohet çdo arritje e qytetarisë.

Në epokën e përzierjes civilizuese, është i nevojshëm një ndërgjegjësim i thellë rreth gjithë epokës së re, i cili favorizon qasjet pjesëmarrëse bashkuese dhe imponon një shkëputje nga këndvështrimi konfrontues i cili fokusohet në të veçantat dhe i cili përjashton rrathët e të përbashkëtave midis qenieve njerëzore.

Pandemia Korona ka treguar se shteti kombëtar është streha e natyrshme dhe

e nevojshme në kriza, pasi është vija e parë në vënien e kornizave të përshtatshme për t'u përballur me këto sfida.

Ndërgjegjësimi për natyrën e globalizuar të botës bashkëkohore duhet të akomodojë dhe tejkalojë dallimet shoqërore, historike, kulturore dhe veçoritë lokale, por duke mos i anuluar ose shpërfillur ato.

Ne nuk mund të krijojmë një qytetari solide të rrënjësuar në struk-turën e saj shoqërore, përveçse duke u siguruar që të lidhim konceptet e saj me kulturën e saj të trashëguar, në mënyrë që njerëzit të mos largohen nga trashëgimia e tyre dhe mos t'i ngatërrojnë ato me koncepte, të cilat mund të jenë pretekst për ta cenuar paqen civile.

Të drejtat e vlerësuar të qytetarisë, gjatë zbatimit të tyre, duhet të kenë parasysh kontekstin e tyre hapësinor dhe kohor dhe pasojat e tyre, në mënyrë që të jenë të prira për të arritur një ekuilibër midis të drejtave kolektive dhe të drejtave individuale, për ta ruajtur rendin publik.

Nuk ka asnjë mënyrë për të arritur një qytetari gjithëpërfshirëse, që përputhet me absolutitetin e parimit dhe relativitetin e praktikimit, për-veçse nëpërmjet një strategjie paqeje, sepse pa paqe nuk ka të drejtë.

Si kulm i këtij rrugëtimi, takimi ynë i këtij viti nxori "Deklaratën e Abu Dhabit për Shtetësinë Gjithëpërfshirëse", një deklaratë e bazuar në dokumentet kryesore të tolerancës, si Deklarata e Marrakeshit për të Drejtat e Minoriteteve, Deklaratat e Abu Dhabit për Paqe, Dokumenti i Vëllazërisë Njerëzore, Dokumenti i Mekës Al-Mukarramah dhe dokumenti i Paktit të Ri të Virtyteve, si dhe dialogët e shumtë me institucionet vendase dhe ndërkombëtare me përkatësi të shumta fetare dhe kulturore, organizata ndërkombëtare, personalitete të shquara dhe ekspertë mbështetës në panelet periodike të diskutimit të moderuara nga Agjencia Wilton Park në periudhën 2018 dhe 2021.

Se dyti — Rekomandimet:

Pjesëmarrësit e konferencës vlerë-suan modelin e Emirateve të Bashkuara Arabe në mishërimin e qytetarisë gjithëpërfshirëse. Në tokën e këtij vendi të bekuar, dhjetëra fe, kultura, raca dhe qindra kombësi të ndryshme bashkëjetojnë në siguri, qetësi, dashuri dhe respekt.

Pjesëmarrësit e konferencës thek-sojnë rëndësinë e studimit dhe analizimit të modelit të Emirateve, pasi ky model përfaqëson një hapësirë të gjerë për humanizëm, tolerancë dhe qytetari gjithëpërfshirëse.

Formimi i komisioneve të eks-pertëve për studimin, rishikimin dhe zhvillimin e kurrikulave të edukimit fetar dhe qytetar, duke marrë para-sysh dimensionin njerëzor dhe moral në fushën e edukimit për qytetarinë gjithëpërfshirëse.

Krijimi i një platforme elektronike për të ndjekur rekomandimet dhe sugjerimet, si dhe për të zhvilluar ide.

Krijimi i një dege të Forumit për Promovimin e Paqes që ka të bëjë me promovimin e paqes dhe përhapjen e vlerave të qytetarisë gjithëpërfshirëse në disa rajone të botës, si Afrika Sub-Sahariane.⁴

Inkurajimi dhe intensifikimi i takimeve të liderëve fetarë për të theksuar se feja ndërton ura ndërmjet kultu-rave dhe mund të jetë një forcë për paqe dhe pajtim.

Formimi i komisioneve arsimore për përgatitjen e programeve arsimo-re për edukimin qytetar.

Krijimi i një qendre kërkimore brenda Forumit të Paqes në Abu Dhabi që është e specializuar në çështjet e qytetarisë dhe identitetit në përputhje me vizionin e forumit për pluralizmin dhe diversitetin.

Lëshimi i një reviste akademike të referuar mbi çështjet e qytetarisë që ndërthur disiplinat fetare dhe humanitare, dhe ngritja e urave midis specialistëve të fesë dhe filozofisë.

Krijimi i partneriteteve ndërmjet Forumit dhe institucioneve fetare e universitare qeveritare dhe private, vendore dhe ndërkombëtare, për të aktivizuar përmbajtjen e Deklaratës së Marra-keshit, Aleancës së re të

Virtyteve, Konventës së Qytetarisë Gjithëpërfshirëse.

Pjesëmarrësit në këtë takim uruan gjithashtu Forumin për shpalljen e identitetit të tij të ri dhe që mban emrin e kryeqytetit të paqes, tolerancës dhe hapësirës për bashkëjetesë dhe dashuri, në mënyrë që emri i tij të jetë "Forum i Abu Dhabit për Paqe", i cili do të jetë i ndërtuar mbi sukseset e mëparshme, dhe do të kalojë në hapësirat e larta të krijimtarisë, me ndihmën e Allahut xh.sh.. Pjesëmarrësit në takimin e tetë të "Forumit për Promovimin e Paqes në Sho-qëritë Myslimane" dëshirojnë t'i shprehin urimet e tyre të sinqerta Emirateve të Bashkuara Arabe, me rastin e jubileut të artë të vitit të pesëdhjetë të themelimit të Unionit dhe shprehin falënderim dhe mirënjohje të lartë për Emiratet e Bashkuara Arabe për lehtësimin e mbledhjes së këtij forumi në kohën e tij të zakonshme dhe në nivelin e tij të zakonshëm me mjetet më të mira të disponueshme në këto rrethana të jashtëzakonshme.

Ata shprehën ndjenjat më të larta të mirënjohjes ndaj shkëlqesisë së tij, sheikh Khalifa bin Zajed al-Nahjan, president i Shtetit, (Allahu e ruajt!) dhe e bekoftë jetën e tij, dhe shkëlqesisë së tij, sheikh Mohammed bin Rashid al-Maktoum, zëvendës presidentit dhe krye-ministrit të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Sundimtar i Dubait, dhe shkëlqesisë së tij, sheikh Mohammed bin Zajed al-Nahjan, Princi i Kurorës së Abu Dhabit, zëvendës Komandanti Suprem i Forcave të Armatosura, kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Emiratit të Abu Dhabit, dhe shkëlqesisë së tyre, sundimtarët e Emirateve, (Allahu i bekoftë të gjithë!), gjithashtu dhe sponsorit të forumit, shkëlqesisë së tij, sheikh Abdullah bin Zajed al-Nahjan, ministër i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndër-kombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe (Allahu e ruajt!).

Këtu përfundon deklarata e miratuar nga pjesëmarrësit në takimin e tetë Ndërkombëtar për Promovimin e Paqes.

Përgatiti: Mr. Besim Mehmeti

1. Për 170 vjet, World Expos kanë ofruar një platformë për të shfaqur rritje më të mëdha që kanë formësuar botën në të cilën jetojmë sot. Expo 2020 do të vazhdojë atë traditë me teknologjinë më të fundit nga e gjithë bota. 2. <https://www.expo2020dubai.com/en/understanding-expo/world-expos-history>. 3. Sure El Fatir 27-28. 4. Afrika Sub-Sahariane është gjeografikisht zona e kontinentit të Afrikës që shtrihet në jug të Saharës. Sipas Kombeve të Bashkuara, ajo përbëhet nga të gjitha vendet dhe territoret afrikane që janë plotësisht ose pjesërisht në jug të Saharës.

Myftiu Tërnavë priti në takim kryetarin e Meshihatit të Kroacisë, Myftiun Aziz Hasanoviç

Më 1 shkurt, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Meshihatit të Kroacisë, myftiun Aziz ef. Hasanoviç, i cili shoqërohej nga kryetari i Kuvendit të Bashkësisë Islame në Kroaci, dr. Mirza Sabiç, zv.myftiu, njëherësh drejtori i Medresesë “Dr. Ahmed Smajlovic”, Mevlud ef. Arslani dhe nga sekretari i Meshihatit të Kroacisë, Nermin ef. Botonjiç.

Myftiu Tërnavë, fillimisht iu uroi mirëseardhje mysafirëve në selinë e BIK-ut, e më pas i falënderoi ata për vizitën, duke theksuar se janë vëllezër dhe se do të punojnë së bashku për të mirën e besimtarëve të dy vendeve.

Myftiu më pas i njohu mysafirët mbi angazhimet dhe punën e BIK-ut, si dhe për projektet të cilat synon t'i realizojë. “E falënderova myftiun e Kroacisë për të gjithë atë që ka bërë për Kosovën dhe shqiptarët në Kroaci. Për ne është një ditë e veçantë, kur një njeri të tillë e kemi ndër ne dhe lusim Zotin t'i falë shëndet dhe mirëqenie. Ne shpresojmë që lidhjet tona ndërmjet dy bashkësive fetare të lidhen edhe më fortë rreth vetës dhe të shtojmë edhe më bashkëpunimin ndërmjet nesh, por edhe ndërmjet medreseve në Kosovë dhe Kroaci. Dora e tij gjithnjë ka qenë e zgjatur



për bashkëpunim dhe për këtë e falënderoj shumë. Si shkak i kësaj, shqiptarët që janë në Kroaci gëzojnë të gjitha të drejtat e barabarta si në Bashkësinë Islame të Kroacisë, ashtu dhe në jetën publike”- tha Myftiu Tërnavë.

Ai tha se BIK-u vazhdimisht ka kontribuar që Kosova të jetë një vend i qetë, vend i bashkëjetesës, tolerancës ndërfetare dhe ndëretnike.

Ndërsa, nga ana e tij, kryetari i Meshihatit të Kroacisë, myftiu Aziz ef. Hasanoviç, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen e ngrohtë dhe vëllazërore, duke theksuar rolin historik që ka luajtur Myftiu Tërnavë dhe BIK-u në proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova, si para, gjatë dhe

pas luftës, si dhe në ndërtimin e paqes dhe organizimin e jetës fetare në vend.

Ai më pas tha se mbetem i mahnitur me atë që shoh në Kosovë në çdo segment të jetës, ne shohim përparimin dhe zhvillimin në të gjitha portet e jetës dhe infrastrukturës. Ne si BI e Kroacisë mund të mësojmë shumë nga puna juaj në këtë ambient. Në fund, ai kërkoi që Myftiu Tërnavë në një të ardhme sa më të afërt ta vizitojë shtetin e Kroacisë.

Në fund të takimit edhe njëherë u theksua nevoja që dy institucionet të thellojnë edhe më shumë bashkëpunimin në të mirë të dy popujve dhe ardhmërinë e Islamit në dy vendet respektive. (R.S)

Myftiu Tërnavë mori pjesë në ceremoninë e Menshurës së reisit të Bashkësisë Islame të Mali të Zi, Rifat ef. Fejziq

Më 6 shkurt 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në ceremoninë e Menshurës së reisit të Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Rifat ef. Fejziq, e cila u mbajt në xhaminë “Osmangazi” në Podgoricë. Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të bashkësive islame dhe xhamive nga vende të ndryshme të Ballkanit, si nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Turqia, Bosnja dhe Hercegovina, Sllovenia etj.

Myftiu Tërnavë në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, uroi dhe përgëzoi reisin Fejziq, duke shprehur gatishmërinë e tij dhe të institucionit



të Bashkësisë Islame të Kosovës për një vazhdim të mëtutjeshëm të

bashkëpunimit. “Ne si bashkësimotër e juaja i gëzohemi çdo të

arriture tuaj dhe atë e konsiderojmë edhe si të arritur të përbashkët. I nderuar reis, deri tash kemi pas një bashkëpunim vëllazëror, shpresoj që edhe tani e tutëj vetëm sa do e forcojmë dhe do e rrisim bashkëpunimin, jemi të hapur që të bashkëpunojmë si edhe deri tani në çdo aspekt aty ku është e mundur. E them me përgjegjësi se dy bashkësitë tonë kanë historinë, rrugën që kanë kaluar deri këtu, sfidat e vështirësitë e njëjta, andaj si edhe deri tash shpreh gatishmërinë tonë që t'i koordinojmë

punët e aktiviteteve në të mirë të besimtarëve tanë” – tha ndër tjerë Myftiu Tërnavë.

Ai në fjalën e tij përmendi edhe rolin dhe rëndësinë e detyrës së reisit, si dhe për rolin historik që ka luajtur institucioni i Bashkësisë Islame në vendet e Ballkanit. Ai u shpreh se “detyrën e Reisit apo të Myftiut e kuptoj si një nder e privilegj të madh, por në të njëjtën kohë edhe një përgjegjësi me barrë të madhe, qoftë në botëkuptimin islam, qoftë edhe brenda institucionit të Bashkësisë

Islame. S’ka dyshim se institucioni i Bashkësisë Islame është i rrënjësor në vetëdijen e besimtarëve tanë gjithandë nëpër vendet e Ballkanit, prandaj edhe i ka mbijetuar sistemeve të ndryshme politike, dhe ka mbetur i aftë për të ruajtur, transmetuar dhe interpretuar Islamin deri në ditët tona, dhe besoj fuqishëm se kështu do të vazhdoj deri në Kiamet me ndihmën e Zotit.”

Rifat ef. Fejziqi e udhëheq institucionin e Bashkësisë Islame të Malit të Zi që nga viti 2003. (R.S ef. B.Z.)

Vihet gurthemeli i xhamisë së re në Gjilan



Më 10 shkurt, nën këndimin e tekbireve, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe kryetari i Këshillit të BI-së në Gjilan, Naim ef. Aliu, kanë vënë gurthemelin e xhamisë së re në hyrje të këtij qyteti.

Nevoja për ndërtimin e një xhamie ishte kërkesë e kamotshme e banorëve të kësaj lagje, teksa po jetësohet falë bashkëpunimit mes Bashkësisë Islame të Kosovës dhe mërgimtarëve.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, potencoi se ndërtimi i xhamive në Kosovë fuqizon të gjithë besimtarët dhe në veçanti brezat e rinj.

“Kjo xhami edhe më shumë na kthen në ndërrijen tonë se brezat që po vijnë do të jenë edhe më frymëdhënës në këtë drejtim, sepse ky brez që tash po jeton, është ai që po kontribuon në ngritjen e infrastrukturës së Bashkësisë Islame të Kosovës. Ne e kemi për detyrë

haptazi t’i falënderojmë që po kontribuojnë në këtë drejtim, duhet t’i falënderojmë edhe në ligjëratat tona, në emisione, të shkruhet për ta, për shkak se këta janë më meritoret që edhe më shumë po forcohet dini Islam në këto troje”, deklaroi Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Kryetari i Këshillit në Gjilan, Naim ef. Aliu e quajti ditë me rëndësi të veçantë këtë ditë të vënies së gurthemelit. “Bashkësia Islame e Kosovës në bashkëpunim me bashkatdhetarët që jetojnë dhe veprojnë në Zvicër, për shkak se ata janë mbështetja më e madhe, kanë siguruar këtë vend dhe me anë të financimit të tyre po ndërtohet kjo xhami. Pa dyshim se jemi falënderues të gjithëve sepse është një ditë e madhe për neve”, ka deklaruar Naim ef. Aliu.

Bashkësia Islame e Kosovës është duke bërë përpjekje maksimale për ndërtimin e infrastrukturës për t’i përmbushur kërkesat e besimtarëve anë e kënd Kosovës. Aktualisht janë vënë 13 gurthemet e xhamive që po ndërtohen në të gjithë territorin e Kosovës.

Fakulteti i Studimeve Islame promovoi vëllimin e tretë të epitafëve me mbishkrime në gjuhën osmane – regjioni i Gjilanit

Më 10 shkurt, Fakulteti i Studimeve Islame promovoi projektin hulumtues me titull “Epitafet në gjuhën osmane – deshifrimi dhe përkthimi i tyre, regjioni i Gjilanit”.

Promovimi i epitafëve u realizua në bashkëpunim me Komunën e Gjilanit. Në këtë promovim, përveç stafit

të FSI-së, morën pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, nënkryetarja e Komunës së Gjilanit, znj. Leonora Morina-Bunjaku, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, z. Sabri Bajgora, drejtori i Institutit

Y u n u s

Emre, dr. Mehmet Ülker, profesorë, studiues, intelektualë, dashamirë të librit e të kulturës, si dhe shumë të ftuar të tjerë.

Në cilësinë e nikoqirit, të pranishmëve iu drejtua dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, ku ndër tjerë tha: “Botimi që kemi në dorë me



titull: “Epitafet në gjuhën osmane, deshifrimi dhe përkthimi i tyre, Regjioni i Gjilanit” përfshinë rreth 180 gurë varrezorë të deshifruar. Ky botim jep informacione për personalitete të ndryshme që kanë jetuar në këto treva gjatë periudhës së sundimit osman si myderriz të njohur, në mesin e tyre myderriz Adem Efendi, myderriz Abdurrahim Efendi, i biri i Hysejn Efendiu nga Llashtica, Mulla Junuzi etj. Në disa gur varrezor të varrezave të Gjilanit hasim të skalitur emrat e disa fisnikëve të familjes së Gjinollëve, si ai i Ahmet Bahtiar Begut, i biri i Isref Begut nga fisnikët e Gjinollëve, Gjinzade (bijtë e Gjinajve)”

Të pranishmëve me një fjalë përshëndetëse iu drejtua edhe nënkryetarja e Komunës së Gjilanit, znj. Leonora Morina-Bunjaku, ku ndër të tjera tha: “Komuna e Gjilanit dhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë kanë një bashkëpunim të vazhdueshëm, andaj promovimi i këtij projektit hulumtues është i

mirëseardhur dhe një vlerë e shtuar për Komunën e Gjilanit dhe regionin e Anamoravës”

Myftiu Naim ef. Tërnavë, në fjalimin e tij tha: “Vepra që po promovojmë sot këtu në Gjilan, ka një rëndësi shumë të veçantë për njohjen e së kaluarës së kësaj ane, dhe sigurisht se do të ndikojë që të ndriçohen e plotësohen me të dhëna edhe më biografite të shumë personaliteteve të kësaj ane që për shkaqe të ndryshme nuk janë ndriçuar e zbardhur deri më tash...”

Për këtë veprë hulumtuese me një referat u paraqit mr. sc. Blerim Haziri, njëherësh edhe këshilltar i kryetarit të Komunës së Gjilanit, i cili ndër tjera tha: “Nga konteksti historik, duke u bazuar tek të dhënat që japin autorët, epitafet në regionin e Gjilanit në të kaluarën nuk janë trajtuar e deshifruar fare, edhe pse në aspektin monumental janë të një rëndësie të veçantë. Konsiderojmë se në këtë botim është bërë një hulumtim i rrallë dhe i nevojshëm, sepse gjendja e epitafeve

edhe tani nuk është në kujdesin e duhur. Kjo është një veprë e padiskutueshme dhe është jo vetëm për t’u konsideruar e vlerësuar, por edhe për t’u marrë seriozisht nga historianët bashkëkohorë”, tha ndër të tjera z. Haziri.

Në emër të autorëve, të pranishmëve iu drejtua dr. Selimi Selimi, i cili pasi falënderoi të gjithë ata të cilët kanë kontribuar për realizimin e këtij projekti, tha: “Epitafet në shikim të parë mund të duken vetëm gurë varresh, mirëpo në fakt ato njëherësh janë edhe dëshmi – burime të dorës së parë, ku ndriçojnë një pjesë të kaluarës tonë, të trashëgimisë kulturore. Por që edhe praktikatat e dëshmuar këtu se, përmes epitafeve të shkruajnë edhe një pjesë biografie e historie të personaliteteve, sikur fjala vjen me familjen e vjetër gjilanasë, Gjinollajt, siç shkruhet në dy epitafe që gjenden në oborrin e muzeut të qytetit të Gjilanit..., apo edhe emrat e prindërve të heroit kombëtar Idriz Seferi”. (Mr. Vedat Shabani).

Kryesia e Bashkësisë Islame mbajti mbledhjen e radhës

Më 12 shkurt, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e radhës, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Në këtë mbledhje pikë kryesore e rendit të ditës ishte parapërgatitja për muajin e bekuar Ramazan, por krahas kësaj, Kryesia lexoi dhe miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar, si dhe shqyrtoi dhe mori vendime nga kompetencat e kësaj Kryesie. Pas shqyrtimit, Kryesia e BIK-ut miratoi platformën e Kryesisë për aktivitetet dhe organizimet për muajin Ramazan.



Përrurohet objekti i morgut të Këshillit të BI të Prishtinës

Më 16 shkurt, në mënyrë solemne është përruar objekti i morgut i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prishtinës. Në këtë solemnitet mori pjesë kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, kryetari i Këshillit të BI-së së Prishtinës, Hetem ef. Sopjani me bashkëpunëtorë, dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi me bashkëpunëtorë dhe shumë të pranishëm të tjerë.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë falënderoi të gjithë ata që kanë ndihmuar në finalizimin e këtij objekti dhe shpreh tejet i kënaqur me punët që janë kryer dhe vlerësoi se ky objekt është i standardit më të lartë dhe bashkëkohorë, i cili do të jetë në shfrytëzim të nevojave të besimtarëve tanë duke ofruar kështu kushtet ideale dhe shërbimet më kualitative.

Kryetari KBI-së së Prishtinës, Hetem ef. Sopjani, me këtë rast



falënderoi Myftiun Tërnavë për pjesëmarrje dhe tha se tani besimtarët tanë mund të drejtohen në këtë objekt për kryerjen e shërbimeve, si dhe falënderoi organet komunale të Prishtinës, të cilat na e ka dhënë në shfrytëzim këtë parcelë për 99 vjet, ndërsa pjesën tjetër ne e kemi investuar me xhematlinjë tanë, të cilët shfrytëzoj rastin t'i falënderoj për

ndihmën që kanë ofruar. "Ky objekt i plotëson të gjithë kushtet për rastet e vdekjes, ku në të bëhet pastrimi i kufomave, përcjellja e rasteve për te varrezat etj. Ky objekt do të shfrytëzohet edhe për të pame dhe do të jetë në shfrytëzim të xhematit dhe në funksion të qytetarëve të Prishtinës që nga sot" - tha Sopjani. (R.S)

KBI në Lipjan organizoi manifestim për nder të përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës



Më 15 shkurt, Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan ka organizuar manifestimin për përvjetorin e 14 të Pavarësisë së Kosovës.

Në këtë organizim u çmua dhe u vlerësua lart kontributi i të rënëve për

liri, atyre që luftuan për çlirimin e vendit dhe të gjithë atyre që kontribuan në forma të ndryshme në shtetndërtimin e Kosovës.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë,

tha se populli i Kosovës që nga viti 1912 ka sakrifikuar shumë për të arritur këtë liri që kemi sot, andaj tha se duhet të bëjmë të pamundurën të përmirësojmë edhe më shumë Kosovën tonë.

Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, Zaim Baftiu, në fjalën e tij në këtë manifestim potencoi se kultura, tradita fetare e kombëtare janë pjesë të besimit, andaj vetëm duke ruajtur njëra tjetrën do ta forcojë vendin tonë.

Në anën tjetër, kryetari i Komunës së Lipjani, Imri Ahmeti, kujtoi të rënët për liri duke bërë thirrje që të punohet çdoherë e më shumë për vendin tonë.

Në fund të këtij organizimi, Myftiu Tërnavë shpërndau mirënjohje në shenjë falënderimi për kontributin e vazhdueshëm në ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Myftiu Tërnavë priti në takim shefen e re të UNMIK-ut, znj. Caroline Ziadeh

Më 22 shkurt, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim përfaqësuesen e re të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së në Kosovë, njëherësh shefen e re të UNMIK-ut, znj. Caroline Ziadeh.

Myftiu Tërnavë fillimisht i dëshiroi mirëseardhje znj. Ziadeh në institucionin e BIK-ut, si dhe e uroi atë për marrjen e detyrës së re si shefe e UNMIK-ut, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin që ajo e udhëheq.

Ai më pas e njohu mysafirin me funksionimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion. Myftiu Tërnavë vlerësoi lart bashkëpunimin e deri tanishëm ndërmjet BIK-ut dhe UNMIK-ut, si dhe shprehu gatishmërinë që një

bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ndërkaq, znj. Caroline Ziadeh, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për punën që ai dhe institucioni i BIK-ut po bëjnë për mbarëvajtjen e jetës fetare në vend.

Ajo vlerësoi lart rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës për kultivimin e dialogut ndërfetar e ndëretnik, si dhe për promovimin e vlerave të tolerancës dhe të bashkëjetesës në Kosovë.



Myftiu Tërnavë priti në takim përfaqësuesit e qendrës “King Salman Humanitarian Aid & Relief Centre”

Më 22 shkurt, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim përfaqësuesit e qendrës “King Salman Humanitarian Aid & Relief Centre” (Qendra Mbreti Selman për Humanizëm), z. Basheer Saleem al-Sharari dhe Abdulaziz Muhamed al-Teeq, të

cilët shoqëroheshin nga përfaqësuesi i ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Najef al Mudhejan.

Myftiu Tërnavë fillimisht iu dëshiroi mirëseardhje mysafirëve në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas i njohu ata me funksionimin dhe me të arriturat e

institucionit të BIK-ut. Fokus të veçantë në këtë takim, Myftiu Tërnavë i dha anës humanitare, më konkretisht, mysafirët i njohu me punët dhe angazhimet e Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, e cila funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Myftiu Tërnavë falënderoi mysafirët dhe nëpërmes tyre shtetin e Arabisë Saudite, për përkrahjen e dhënë për popullin e Kosovës në të gjitha fushat, e me theks të veçantë në fushën e bamirësisë.

Nga ana e tyre, mysafirët shprehën gatishmërinë e tyre, por edhe të qendrës ku veprojnë që ta ndihmojnë popullin e Kosovës dhe ta përkrahin institucionin e Bashkësisë Islame, më konkretisht Shoqatën “Bereqeti” në projektet e tyre humanitare.



Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Komunës së Mitrovicës z. Bedri Hamza

Më 23 shkurt, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga zv. kryeimami Fatmir ef. Iljazi dhe nga kryetari i Këshillit të BI-së së Mitrovicës, Enis ef. Rama, kanë takuar kryetarin e Komunës së Mitrovicës, Bedri Hamzën, me të cilin kanë biseduar për bashkërendimin e punëve në shërbim të qytetarëve, duke vënë në spikamë vlerën e madhe të kombit shqiptar për tolerancën ndërfaqetare.

Myftiu Tërnavë fillimisht uroi kryetarin Hamza për detyrën e re, duke shprehur se, përveç që është privilegj që të jesh në shërbim të qytetarëve është një përgjegjësi shumë e madhe. Ai vlerësoi vullnetin e Komunës për një bashkëpunim të mirë me Bashkësinë Islame.



Ndërkaq, kryetari Hamza, tha se bashkëpunimi me Bashkësinë Islame, me imamët dhe me xhematin e Mitrovicës do të jetë në nivelin më të lartë. Ai tha se së bashku do të

kontribuojmë për mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim, për kultivimin e harmonisë dhe tolerancës ndërfaqetare.

Deklaratë e përbashkët e prijësve fetarë kundër nismës së institucioneve të vendit për ndryshimin e projektligjit për Kodin Civil



Më 23 shkurt, Bashkësia Islame e Kosovës, Dioqeza Prizren-Prishtinë (Kisha Katolike), Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës dhe Bashkësia Hebraike e Kosovës, kanë nënshkruar deklaratë të përbashkët kundër nismës së institucioneve të vendit për ndryshimin e projektligjit për Kodin Civil. Kjo deklaratë është nënshkruar nga prijësit më të lartë të këtyre bashkësive fetare:

- Naim ef. Tërnavë, Myfti i Kosovës;
- Dodë Gjergji, Ipeshkëv i Kosovës;
- Femi Cakolli, Pastor i Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës;

- Votim Demiri, kryetar i Bashkësisë Hebraike të Kosovës.

Në vazhdim e gjeni tekstin integral të deklaratës:

Bashkësitë fetare të Kosovës, pas nismës për ndryshimin e kodit civil të Kosovës, pasi kanë shqyrtuar projektligjin në fjalë, pas konsultimeve dhe takimit të sotëm të prijësve tanë, duke u bazuar në mësimet dhe predikimet e besimeve tona si dhe në kodin e vlerat e popullit tonë, jemi dakorduar të shprehim qëndrimin dhe kundërshtimin tonë me këtë:

DEKLARATË

Bashkësia Islame e Kosovës, Dioqeza Prizren-Prishtinë (Kisha Katolike), Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës dhe Bashkësia Hebraike e Kosovës shprehim shqetësimin tonë lidhur me projektligjin për ndryshimin e Kodit Civil, pjesa e familjes, ku po rezultohet që të dobësohet përkufizimi dhe funksionimi i martesës në Kosovë, prandaj:

1. *Bashkësitë tona fetare mbesin të bashkuara për sa i takon mbrojtjes dhe promovimit të përditshëm të vlerave të familjes, vlerave dhe qëndrimeve projektës, mbrojtjes së vlerave tradicionale të bashkëshortësisë, mbrojtjen e së drejtës së jetës së fetusit prej ngjizjes e derisa ai lind, të drejtën e natyrshme gjinore si paracaktim për secilin qytetar.*

2. *Ta prekësh ripërkufizimin e martesës dhe të pjesëmarrësve në të, pra të burrit i lindur mashkull dhe të gruas e lindur femër, mendojmë se po cenohet drejtpërdrejt Fjala e vullneti i Zotit si dhe zbulësia e Tij e shenjtë për gjithë familjen njerëzore e cila ka nisur prej një burri e një gruaje me bekimin dhe urdhrin e shumëzimit të përgjeshëm.*

3. *Të lësh hapësirë ripërkufizimi në çfarëdo niveli e forme për martesën, në*

fakt, dikush po prek në njërin nga fundamentet e përgjithshme të shoqërisë sonë, e cila ka për trashëgimi gjatë mijëra vjetëve vlerën tradicionale, dhe e cila siguron funksionimin normal të shoqërisë pavarësisht bindjeve të ndryshme.

4. Bashkësitë fetare të Kosovës mbesin të bashkuara dhe me një zë të vetëm para ligjëvënësve të Kuvendit të Kosovës, para qeverisë dhe institucioneve të tjera, që të heqin dorë prej çdo ndryshimi, prej çdo ripërkufizimi, prej çdo riinterpretimi të neneve për familjen, martesën

dhe statusin e bashkëshortëve në vendin tonë.

5. Me bashkimin apo bashkëjetesën e dy personave me gini të njëjtë nuk mund të pajtohemi kurrsesi që ta quajmë as martesë e as kurorëzim, dhe jemi kundër orientimit që këta individë që lidhin bashkëjetesë të adaptojnë fëmijë.

6. Shoqëria kosovare ka rrënjë të thella të vlerave dhe të përcaktimeve konservatore, dhe si bashkësi fetare deklarojmë, se ndjehemi të lumtur me këtë realitet, dhe angazhimi ynë është që

t'ua pasojmë brezave këtë visar mbi familjen e martesën.

Ne mbesim me lutjet tona duke kërkuar urtësinë dhe dobinë e të gjithëve në Kosovë dhe jo vetëm selektimin dhe fragmentimin e dobive dhe lirive për individë a grupe që shohin vetëm vetët e tyre e jo interesin e përgjithshëm, sikur që lutemi edhe japim përpjekje maksimale që ta ruajmë vendin tonë nga çdo mosdurim!

Falënderojmë Zotin dhe prej Tij presim që të na ruajë e të na udhëzojë të gjithëve!

Prishtinë, 23 shkurt 2022

Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri



Më 24 shkurt, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka vizituar Komunën e Pejës, me ç'rast u prit nga i pari i kësaj komune, Gazmend Muhaxheri.

Në këtë takim, Myftiu Tërnavë fillimisht e uroi z. Muhaxherin për

mandatin e ri 4 vjeçar në krye të Komunës së Pejës, duke i dëshiruar suksese atij dhe gjithë qytetarëve të kësaj komune.

Rëndësi të veçantë në këtë takim iu kushtua bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet dy institucioneve, si dhe

mundësisë për të thelluar bashkëpunimin edhe më tej në fusha të përbashkëta, në interes të qytetarëve të kësaj komune.

Myftiun Tërnavë së bashku me kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Pejë, Musli ef. Arifaj njoftuan kryetarin e Komunës për mbarëvajtjen e jetës fetare si dhe planprogramin e KBI-së në Pejë për këtë vit.

Në anën tjetër, kryetari i Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri, falënderoi Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për kontributin e dhënë për shoqërinë kosovare. Z. Muhaxheri shprehi gatishmërinë për bashkëpunim në secilën fushë me Bashkësinë Islame të Kosovës në interes të qytetarëve të Pejës.

Përurohet kuzhina e re dhe dyqani humanitar i "Bereqetit" në Pejë

Më 24 shkurt, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me Këshillin e Bashkësisë Islame në Pejë, kanë përuar objektin e ri të kuzhinës popullore të Shoqatës Humanitare "Bereqeti".

Një kuzhinë e tillë është në shërbim të qytetarëve të Pejës tash e gjashtë vite, por që nga sot, do të jetë në kushte edhe më të favorshme, duke përfshirë këtu edhe dyqanin humanitar, ku nevojtarët mund të shër-

behen pa pagesë me produktet e nevojshme.

Myftiu tha se është jashtëzakonisht e rëndësishme t'u dilet në ndihmë kësaj pjesë të shoqërie, prandaj një punë të madhe është duke e bërë "Bereqeti" me donatorët e saj. "Dëshirojë të falënderoj shumë edhe donatorët, bizneset të shumta pa dashur të përmendi emra, të cilët në vazhdimësi ndihmojnë "Bereqetin" dhe që po mundësojnë të ushqehen 300 persona në çdo ditë. Sigurisht se

kjo është punë e madhe dhe e mundimshme. Këtu është edhe kuzhina që çdokush mund të ushqehet, por një pjesë tjetër mund të marrë edhe pako ushqimore me veti. Dëshiroj t'i përgëzoj këta djem tejet të vyeshëm që sot e hapën edhe këtë dyqan humanitar".

Koordinatori i "Bereqetit" në Pejë, Ermir ef. Gega, thotë se ka për synim që çdoherë të jetë afër familjeve nevojtare, veçanërisht tash me hapjen e dyqanit të ri.



“Këtu përafërsisht ushqehen deri në 300 veta, gjatë gjithë vitit dhurohen 100 mijë shujta, sivjet e kemi arritur kapacitetin edhe në disa fshatra. Përveç ushqimit shpërndajmë edhe pako ushqimore dhe dru për ngrohje, por tashmë me anë të dyqanit humanitar, kushdo që ka nevojë mund të marr produktet që i nevojitet”, ka deklaruar Gega.

Kryetari i Këshillit në Pejë, Musli ef. Arifaj, u shpreh falënderues ndaj qytetarëve të kësaj komune të cilët po ndihmojnë njëri-tjetrin me iniciativa të tilla të “Bereqetit”.

Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet BIK dhe qendrës “King Salman Humanitarian Aid & Relief Centre”

Më 25 shkurt, Bashkësia Islame e Kosovës ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën “King Salman Humanitarian Aid & Relief Centre”, për shpërndarjen e 2056 pakove ushqimore për familjet nevojtare në Kosovë. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje u bë nga shefi i kabinetit të kryetarit të BIK-ut, Besim ef. Mehmeti, ndërsa implementimin e kësaj marrëveshjeje pritet që ta realizoj Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, e cila funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Këto pako ushqimore do të shpërndahen në tërë Kosovën, në vigjilje të muajit të bekuar Ramazan. Përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të



Kosovës dhe të Shoqatës “Bereqeti” falënderuan përzemësisht Qendrën “King Salman Humanitarian Aid & Relief Centre”, për këto ndihma, si

dhe treguan gatishmërinë e tyre që një bashkëpunim i tillë të mbretërojë edhe në të ardhmen.

U mbajt manifestimi kushtuar Natës së Israsë dhe Miraxhit

Më 27 shkurt, në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, për nder të Natës së Israsë dhe Miraxhit, u mbajt program fetar, i organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Prishtinë.

Me këndim të Kuranit, ilahive dhe ligjëratës për këtë temë është manifestuar kjo ngjarje e rëndësishme.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në këtë program, në të cilin mbajti ligjëratën kryesore kushtuar kësaj nate.

Ai ndër të tjera përmendi historikun e Israsë dhe Miraxhit, ku potencoi:

“Udhëtimi i Israsë dhe Miraxhit ka ndodhur duke qenë Pejgamberi a.s. ende në Mekë. Israja dhe Miraxhi është një udhëtim dypjesësh i kryer në të njëjtën kohë: Israja është udhëtim tokësor nga Qabeja e bekuar në Meka në Mesxhidul Aksa ndërsa Miraxhi është udhëtimi qiellor nga Mesxhidul Aksa përmbi Sidretul Munteha. Allahu xh.sh thotë:

“Qoftë lavdëruar Ai (i pastër është nga të metat – Ai i cili), në një çast të një nate, e ka bartë robin e Tij (Muhamedin) nga Tempulli i shenjtë (Meka) në Tempullin e largët (Jerusemi), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, për t’ia dëftuar atij disa

nga argumentet Tona. Ai (Allahu), me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.” (El-Isra, 1)

Pejgamberi a.s. e ka përjetuar Isranë si udhëtim të vërtetë trupor, që ka filluar nga Qabeja në Mekë e ka mbaruar në Mesxhidi Aksa në Kudsi Sherif, ku është falur në xhami me gjithë Pejgamberët duke u bërë imam i tyre. Pas namazit, Xhibrili ia solli një enë me verë dhe një tjetër me qumësht, e Muhamedi a.s. zgjodhi qumështin, ndërsa Xhibrili i tha: E zgjodhe natyrshmërinë. Atë natë ndodhi ngritja e Pejgamberit a.s. nga mesxhidul Aksa në qiellin e parë, e nën udhëheqjen e Xhibrilit u shpie



në katet e hapësirës së qiejve. Aty takon Ademin a.s.,...Prej aty, Resullullahu a.s. ngritët në qiellin e dytë, ku takon Jahjanë a.s., të birin e Zekerijas a.s., dhe Isanë a.s., të birin e Merjemes...Pas kësaj, pason ngritja në qiellin e tretë ku takohet me Jusufin a.s.,...Pastaj ngrihet në qiellin e katërt, ku takohet me Idrisin a.s.,...Prej aty ngrihet në qiellin e pestë, ku takohet me Harunin a.s.,... Pastaj ngrihet në qiellin e gjashtë, ku

takohet me Musain a.s.,...Pastaj kalon në qiellin e shtatë. Aty takon Ibrahimin a.s.,...e prej aty në horizontin më të lartë të Allahut, ku Allahu i shpalli robit të vet atë që ia shpalli dhe aty caktohet falja prej pesëdhjetë namazesh ditore. Pastaj Resullullahu a.s. nisët të kthehet. Kur kalon pranë Musait, ky e pyet: “Çfarë të është urdhëruar nga Allahu?” Përgjigjet: “Pesëdhjetë namaze në ditë.” Musai a.s. i thotë: “Umeti yt

nuk mund ta zbatojë këtë. Kthehu te Zoti yt dhe lute Zotin që t’ia lehtësojë umetit tënd.” Resullullahu kthehet derisa numri i namazeve bie në pesë ndërsa shpërblimi ngelë në pesëdhjetë namaze...”

Për Isranë dhe Miraxhin, të premtën në gjitha xhamitë e Kosovës është mbajtur hytbeja me këtë temë. Në ndërkohë një nga porositë më të drejtpërdrejta të Israsë dhe Miraxhit është falja e namazit.

Myftiu Tërnavë priti në takim ambasadorën e Sllovenisë në Kosovë, znj. Minca Benedejçiç

Më 28 shkurt, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ambasadorën e Sllovenisë në Kosovë, znj. Minca Benedejçiç.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi ambasadores znj. Benedejçiç mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas e uroi atë për detyrën e re në krye të Ambasadës së Sllovenisë, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme.

Myftiu Tërnavë më pas e njohu mysafiren me funksionimin e institucionit të BIK-ut, si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet ai. Ai falënderoi ambasadorën dhe nëpërmes saj edhe shtetin e Sllovenisë për ndihmën dhe përkrahjen e ofruar për shtetin e Kosovës.

Nga ana e saj, ambasadorja Benedejçiç, falënderoi Myftiun Tërnavë



për pritjen, si dhe vlerësoi lart punën dhe angazhimin që ai dhe institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës po bëjnë për mbarëvajtjen e jetës fetare në Kosovë, si dhe për kontributin për paqe dhe harmoni ndërfaqetare. Ajo

çmoi diversitetin fetar dhe etnik, bashkëjetesën dhe tolerancën ndërfaqetare dhe ndëretnike që mbretëron në Kosovë, e për të cilat vlerësoi lart angazhimin dhe rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Myftiu Tërnavë pranoi telegram urimi për përvjetorin e Pavarësisë nga reisi i RMV-së, Shaqir ef. Fetaj



Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pranuar mesazh urimi për përvjetorin e 14 të Pavarësisë së Republikës së

Kosovës nga kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Reisul Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetaj.

Në këtë telegram urimi, Shaqir ef. Fetaj, në emër të tij personal dhe të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i ka uruar Myftiut Tërnavë 17 Shkurtin – Ditën e Pavarësisë së Kosovës.

Ai këtë ditë e ka cilësuar si ngjarje historike për tërë kombin tonë, duke shtuar se kjo ditë i jep kuptim jetës, dinjitetit, paqes, lirisë dhe përkushtimit ndaj vendit.

Departamenti i Gruas shënoi Ditën Ndërkombëtare të Mbulesës

Me rastin e 1 shkurtit, Ditës Ndërkombëtare të Mbulesës, Departamenti i Gruas në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës organizoi program dedikues me titull "Mbulesa-burim fuqizimi dhe dinjiteti".

Në këtë eveniment mori pjesë edhe Myftiu Naim ef. Tërnavë si dhe Myftiu i Kroacisë, Aziz ef. Hasanoviç, të cilët uruan gratë për këtë ditë të shënuar.

"Me këtë rast, unë, në emër të institucioneve të BIK-ut desha t'u uroj për këtë ditë ndërkombëtare të mbulesës, duke shpresuar që do të bëhet edhe më shumë për të mirën e përgjithshme të grave dhe vajzave. Falënderoj Myftiun e Kroacisë për vizitën dhe e cilësoi atë si mik të madh të shqiptarëve që na është gjetur në ditë më të vështira" – tha ndër tjerë Myftiu Tërnavë.

Në fjalën e tij, Myftiu i Kroacisë, Aziz ef. Hasanoviç, tha se kjo është

një ditë e madhe e cila manifestohet edhe në Kroaci dhe qëllimi është që hixhabi të manifestohet sa më shumë në shoqëritë tona. Ai më pas shpjegoi edhe përvojat e Kroacisë ku motrat myslimane kanë pasur problem me rregullimin e dokumenteve personale, por me një angazhim permanent dhe mos heshtje është zgjidhur edhe ky problem. Prezenca e saj në ambiente të ndryshme konsiderohet si ambasadore në ato ambiente ku punon ajo. Mbulesa është shenjë identitetit islam dhe gjithnjë bëjmë thirrje për afirmim të saj.

Përfaqësuesja e Departamentit të Gruas në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës znj. Vaxhide Bunjaku, pasi përshëndeti të pranishmit tha se përmes këtij programi synohet ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit që femrat me mbulesë të mos paragjykojnë edhe që ato të kenë të drejta të barabarta

me të gjitha femrat tjera, si për shkollim e punësim.

"Në këtë ditë, bëhet thirrje për ngritjen e ndërgjegjësimit të popullatës rreth mbulesës, për të kuptuar konceptin e saj, dhe për t'u promovuar dialogu ndërfetar, po ashtu përmes kësaj dite, njerëzit mësohen që t'i pranojnë të tjerët me ndryshimet e tyre. Mendoj se jemi të gjithë dakord se bartja e shamisë nuk cenon interesin e sigurisë publike, rendin publik, moralin e as nuk cenon të drejtat e të tjerëve, thjesht kemi nevojë për kulturën e modestisë si në veshje, sjellje, dhe fjalë" – tha Bunjaku.

Me këtë rast penaliste në këtë ngjarje ishin Besa Ismaili –ish deputete, dhe Rovena Tujani –Klinaku, avokate.

Për shkak të situatës me pandeminë në vend, organizimi ishte më i vogël dhe numri i të ftuarve i kufizuar. (R.S)



Sekretari i përgjithshëm i BIK-ut takoi sekretarët e këshillave të BI-së dhe të institucioneve të saj

Më 3 shkurt, sekretari i përgjithshëm i Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, ka takuar sekretarët e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të institucioneve të saj. Ai në këtë takim falënderoi sekretarët për punën dhe angazhimin e tyre që janë duke dhënë për zhvillimin e proceseve administrative të këshillave ku veprojnë. “Qëllimi i takimit të sotëm është diskutimi rreth avancimit të formës së komunikimit në raport Këshill-Kryesi, si në aspektin e përpilimit të shkresave, propozimeve, vendimeve dhe kërkesave të tjera, qoftë për administratën e Kryesisë, por edhe të këshillave të



BI-së në përgjithësi. Ky komunikim gjithnjë duhet të bazohet mbi aktet normative të Bashkësisë Islame, si

Kushtetuta dhe rregulloret e ndryshme” – tha ndër të tjera sekretari Sadriu. (R.S)

“Rëndësia e familjes në Islam”, hytbe me shkas në të gjitha xhamitë e vendit

Më 11 shkurt, me rekomandim të Kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, në të gjitha xhamitë e Kosovës u mbajt hytbe me të njëjten temë: “Rëndësia e familjes në Islam”.

Në mesazhin e hytbesë së kësaj të premteje, u shpjeguan argumentet e obligimit fetar, islam për krijimin dhe ruajtjen e familjes. Nga perspektiva islame, familja ka një rëndësi të shumanshme, ajo është strehë shpirtërore, është vend ku pushon shpirti dhe qetësohet mendja. Islami krijimin e bashkëshortes, si njërin prej dy themeluesve të familjes, e shih si tregues të ekzistimit të Zotit.

Martesa është dhe traditë e të gjithë pejgamberëve të Zotit. Pejgamberi Muhamed a.s., ka porositur: “Martesa është pjesë e traditës sime, e kush nuk vepron sipas traditës sime – nuk më përket mua...”

S’ka dyshim se ikja nga kjo traditë profetike nuk është rruga e duhur e myslimanit, sepse Islami ka ndaluar murgërinë dhe forma tjera të ngjashme për të ikur nga martesa, respektivisht nga themelimi i familjes, kësaj strehe morale.



Roli i familjes është i pazëvendësueshëm edhe në aspektin e edukimit. Vetëm në familje të shëndoshë e me vlera, pasardhësit edukohen në mënyrë të virtytshme e me dinjitet.

Në familje mësohet nderi, respekti, dashuria, mirësjellja e mikpritja. Aty orientohen për jetën. Se çfarë bindjesh e idesh do të kenë fëmijët, varet nga ajo çfarë kanë mësuar e marrë në familje.

Kohëve të fundit është diskutuar për Projektin e Kodit të ri Civil të Republikës së Kosovës, ku parashihet edhe lejimi i martesave të gjinisë së

njëjtë. Me këtë rast edhe njëherë Bashkësia Islame e Kosovës kërkon nga institucionet e vendit ta rishikojnë këtë draftligj i cili cenon themelet dhe shenjtërinë e familjes, si dhe atakon vlerat tona morale e familjare të popullit tonë. Nëse Kuvendi i Kosovës miraton Kodin e ri Civil si të tillë, duhet ta dinë se kështu po rrezikojnë familjen dhe vazhdimësinë e llojit njerëzor.

Ne si besimtarë, gjithmonë do të jemi në mbrojtje të parimeve tona fetare dhe vlerave të fesë tonë të pastër që familjen e konsiderojnë të shenjtë e të paprekshme. (R.S)

Departamenti i Gruas në Obiliq mbajti ligjëratë vetëdijësuese për kancerin

Më 15 shkurt, Departamenti i Gruas pranë Bashkësisë Islame në Obiliq në krye me mualimen Mihana Goga-Bektoshi, e në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në këtë komunë, organizuan ligjëratën "Thuaj stop kancerit të qafës së mitrës".

Në fjalën e saj, mualimja Mihana Goga-Bektoshi, tha se është e nevojshme të punohet më tepër në ndërgjegjësimin publik për këtë sëmundje.

"Një ndër mënyrat për të arritur progres në uljen e rasteve të sëmundjes dhe vdekshmërisë nga kanceri është përmirësimi i ndërgjegjësimit publik për simptomat e kancerëve të ndryshme dhe inkurajimi i njerëzve që të kërkojnë kujdesin shëndetësor kur paraqiten ato simptoma", tha ndër tjera Mihana Goga-Bektoshi.

Këtë organizim e përshëndeti edhe znj. Blerona Shabanaj, drejto-



reshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Obiliq, e cila falënderoi organizatoren dhe theksoi se bashkëpunimi me Departamentin e Gruas do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ndërkohë doktoresha Vjollca Kameraj - Hoti, kryesuese e departamentit të Mjekësisë Familjare në QKMF- Obiliq përgëzoi organizatoren, duke thënë se edukimi

shëndetësor është shumë i rëndësishëm.

Ajo tutje citoi se rreth 500 mijë gra sëmurën dhe rreth 280 mijë vdesin në vit nga ky lloj kanceri.

Kujtojmë që Departamenti i Gruas pranë Bashkësisë Islame në Obiliq vazhdimisht mbanë sesione informuese për këtë temë dhe aktivitete të tjera në interes të qytetarëve.

Kryeimami Sahiti mbajti mbledhje me kryeimamët e këshillave të BI-së

Më 16 shkurt, kryeimami i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mbajti mbledhjen e rregullt me kryeimamët e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës. Në fillim të takimit, kryeimami Sahiti i informoi se ky takim ka për qëllim paraqitjen e programit të Ramazanit që ka marrë edhe miratimin e Kryesisë së BIK-ut në mbledhjen e fundit të

saj, e që ka të bëjë me platformën e aktiviteteve fetare për muajin e bekuar Ramazan, si dhe për disa projekte vjetore që priten të realizohen në këtë vit.

Ai falënderoi kryeimamët për punën që janë duke bërë nëpër këshilla, që falë angazhimit të tyre, jeta fetare po zhvillohet mirë dhe ka shënuar progres të dukshëm dhe

rezultate pozitive që preken dhe shihen në çdo pore të jetës fetaro-arsimore.

Në vazhdim, pjesëmarrësit dhanë mendimet e tyre dhe diskutuan se si të pritet sa më mirë muaji Ramazan, si dhe për vazhdimësinë e projekteve të mësimit fetar nëpër xhami dhe aktivitete tjera fetare. (R.S)



Drejtori Simnica priti në takim nënkryetarin e KMSHZ-së, Fehim ef. Abazin

Më 21 shkurt, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim nënkryetarin e Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër, njëherësh imam i Qendrës Shqiptare për Integrim Kulturor dhe Religjion në Lozanë, Fehim ef. Abazin.

Drejtori Siminca falënderoi z. Abazin dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje.



Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i

mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje.

Drejtori Siminca priti në takim Sami Zogajn

Më 24 shkurt, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim kryetarin e Qendrës Islame Shqiptare në Renens të Zvicrës, z. Sami Zogajn, me të cilin bashkëbisedoi për një bashkëpunim të mëtutjeshëm ndërmjet BIK-ut dhe kësaj qendre.

Drejtori Simnica fillimisht i uroi mirëseardhje z. Zogajt, e më pas e falënderoi atë dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe

jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje.

Edhe z. Zogaj shprehu gatishmërinë e tij si kryetar i Qendrës Islame Shqip-

tare që të vazhdojnë bashkëpunimin e mirëfilltë me institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës për të mirën e bashkatdhetarëve tanë në Zvicër.



Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, ka pranuar disa nga librat e vjetra nga familje hoxhollarësh

Biblioteka e Mulla Musa Arifit

Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, gjatë këtij muaji pranoi një numër të konsiderueshëm të librave të vjetër me përmbajtje të ndryshme fetare, nga koleksioni i bibliotekave private të hoxhollarëve tanë. Kështu, më 08.02.2022, në selinë e Institutit u bë pranim dorëzimi i bibliotekës private të Mulla Musa Arifit, ish-kryetar dhe ish-sekretar shumëvjeçar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan.

Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Sabri ef. Bajgora,



falënderoi publikisht nipin e hoxhës së nderuar, Vesel Arifin, që jeton në Itali.

Biblioteka
e Mulla Halil ef. Krasniqit

Biblioteka e IHSI-së, është pasuruar me një pjesë të librave të vjetër të Mulla Halil ef. Krasniqit, i njohur në popull si Mulla Halil Grashtica. Këta libra janë dhuruar nga djali i tij, Kadri Krasniqi dhe stërnipi i hoxhës, prof. Jakup ef. Çunaku.

Biblioteka e Mulla Raif ef.
Ahmetajt

IHSI, ka pranuar për bibliotekën e tij librat dhe dorëshkrimet e Mulla Raif ef. Ahmetajt. Këta libra janë dorëzuar nga imami i fshatit Hogosht, Xhemush ef. Biçku.

Biblioteka e Remzi ef. Kastratit.

IHSI ka pranuar disa nga librat e vjetra të bibliotekës së Remzi ef. Kastratit. Këto libra u dhuruan nga djali i rahmetliut, Jeton Kastrati, i cili shoqërohej nga imami i fshatit Egzon ef. Kastrati.

Biblioteka e Nezir ef. Llugiqit

IHSI ka pranuar disa nga librat e vjetra të bibliotekës së Nezir ef. Llugiqit, i njohur në popull si Mulla Neza, të cilat i dorëzoi djali i tij, njëherësh sekretari i KBI-së në Lipjan, Muhamed ef. Neziri.



Këta libra janë një thesar i çmuar që tregojnë historinë e hoxhallarëve tanë të vjetër, dhe janë të fushave të ndryshme, si fikh, tefsir, hadith, por edhe dorëshkrime të vjetra të mevludeve, kasideve e ilahive të ndryshme.

Drejtori i Institutit, prof. Sabri ef. Bajgora, falënderoi të gjithë kontribuesit me dhurimin e këtyre librave,

duke porositur edhe njëherë të gjithë ata që kanë libra dhe dorëshkrime të hoxhallarëve të vjetër, që t'i sjellin ato në Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame, në mënyrë që të pasurohet biblioteka e këtij instituti dhe nëpërmes tyre të ndriçohet e kaluara e çmuar e hoxhallarëve tanë të vjetër.

Hil Group Sh.p.k. dhuroi veshmbathje për shoqatën "Bereqeti"

Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti" në kuadër të aktiviteteve të saj të shumta humanitare, ka pranuar një donacion me veshmbathje nga Hil Group Sh.p.k..

Drejtori i shoqatës Behxhet ef. Ajvazi, ka falënderuar përzemësisht pronarin e Hil Group, haxhi Ilmi Thaçin për këtë donacion. Ai tha se ndihma e Hil Group nuk është vetëm e tanishme, porse një ndihmë e tillë ka ardhur vazhdimisht nga ta, që nga paslufta. Përveç veshmbathjeve, Hil Group ka ndihmuar shoqatën edhe me donacione të tjera, siç janë pakot ushqimore, bursat për studentë etj.. Ky donacion përfshinë vlerën e 40.532 eurove, rroba të reja.



Profeti

Kur iu hap porta e profecisë,
injoranca kishte rritur shtat.

Në ballë të asaj kohe,
putat lenin gjurmë shenjtërie.

Kudo lexohej pabesi,
faqeve të pergamenës së verdhë.

Me shpatën e besimit,
heshtjes vrastare iu hoq koka.

Profeti hapi shtigje të reja,
udhëve të drejta të ardhmërisë.

U përgjakën lutjet

(Masakra në Xhaminë e Poshtme në Preshevë)

I hodhën hidhërimet e çartura,
brenda lutjeve (tani) të lagura.

Sa gjëmë e dhimbje dëgjoheshin,
nga (ai) lumë gjaku buçitës.

I hodhën të këqijat me dorë të zezë,
ata bombahedhës të tërbuar.

Lutjet para të Madhit ngelën në fyt,
u përgjak kultit nga dasmorët e Parajsës.

I hodhën pamëshirshëm të zezat,
mbi trupat e lutësve të Perëndisë.

Ajo kohë e keqe polli motin e zi,
bashkë me gjakpirësit e shekullit të ri.

Në shtëpinë e Zotit

Në shtëpinë e Zotit,
lutjet shkrihen
në kokrra rruzaresh.

Asgjë s'dëgohet,
heshtja i shtrihet qetësisë.

Veç tiktakeve të orës,
ngjitur në murin
luluar me arabeska.

Lutjet dalin si vetëtima
nga shpirti
në gjuhën e lumnuar.

Në shtëpinë e Zotit,
edhe portat e shpitrave
ruhen nga engjëjt.

Azrailit s'mund t'ia zëmë udhën

S'mund t'ia zëmë udhën Azrailit,
as të fshihemi
prapa perdes së fshehtësisë.

T'i ikim asnjëherë s'mundemi
këtij kasneci mortor,
në asnjë skutë as skaj të harruar.

Si hije të gjen edhe aty ku s'je,
ta merr më të shtrenjtën,
e të nis për në botën e përtejme.

(Jo) Azrailit s'i ik dot asnjë rast,
është në ballë të detyrës,
në çdo pikë e në çdo çast...

Bilall Maliqi

Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti"

PROJEKTET E REALIZUARA 2021

35.970

pako ushqimore dhe higjienike

91.296 kg miell

30.790 familje
nga 5 kg mish kurban

121.320 iftare

33.500
bukë të gatshme

430 ëmbëlsira

21.850
dhurata për festa

89.958
shujta të ngrohta ditore
nga kuzhinat humanitare

11,235 €
para të gatshme

2753
mjete shkollore

164 m³ dru për ngrohje

40 bursa mujore për studentë

36 mujore udhëtimi për nxënës

22.851 veshmbathje

12.000 kg rroba
për Inst. Spec. Shtime

1958 batanije



45 stufa (shporet)

11 pagesa të qirasë mujore

2 banesa të dhuruara

4 troje nga 5 ari për ndërtim

6 shtëpi në ndërtim e sipër

12 shtëpi të ndërtuara

32 shtëpi të renovuara

37 hapje të puseve

18 familje
furnizim me medikamente

3 aparate oksigjeni

21.970 kg grurë

22.405 copë
maska anti Covid

10 krerë dele

23 mjete për persona
me nevoja të veçanta

30 shtëpi të mobiluara

89 ndihma për jetimë

285 kurbanë "akika"

Projekti i vitit

hapja e marketit
humanitar
në Prizren

**BASHKËPUNIM
ME ORGANIZATA TË TJERA
BRENDA DHE JASHTË VENDIT**



Kontribuo edhe ti në xhirollogari: OJQ SHOQATA BEREQETI,
Banka Ekonomike Sh.a. • IBAN: XK051401000000813233 • SWIFT Code (BIC): EKOMXKPRXXX,

[Paypal.me/bislame](https://www.paypal.me/bislame)

Donacionet tuaja mund t'i dorëzoni edhe në këshillat e Bashkësisë Islame nëpër qytetet e Kosovës.

Shoqata Humanitare Bëmirëse Bereqeti +383 38 224 024 +383 49 733 678